

# PROGRAMI I ZONËS FUNKSIONALE KUKËS

dldp
decentralisation and local development programme

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development and Cooperation SDC

HELVETAS Swiss Intercooperation | ALBANIA

Prill 2015

Ky dokument është përgatitur nga Programi për Decentralizim dhe Zhvillim Lokal (dldp), me mbështetjen financiare të Agjensisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC).

Ky publikim reflekton mendimet e autorëve dhe jo detyrimisht të SDC

Zhvilluar nga:
Europartners Development

Publikuar nga:
Programi për Decentralizim dhe Zhvillim Lokal (dldp)

**HELVETAS Swiss Intercooperation** | Albania
Addresa: Rruga "Ibrahim Rugova",
Pallati i PLUS, kati i 2-të / Nr. 3. Tiranë | Shqipëri
www.dldp.al | www.km.dldp.al

# Tabela e Lëndës


1. Hyrje ..... 5

2. Territori i Zonës Funksionale të Kukësit ..... 8

*2.1 Pozita Gjeografike, Kufijtë, Përbërja e NJQV-ve ..... 8*

*2.2 Infrastruktura ..... 10*

*2.3 Klima dhe Mjedisi ..... 11*

*2.4 Historia, Kultura, Traditat dhe Atraksionet Kryesore ..... 12*

2.5 Tendencat Demografike ..... 13

*2.5.1 Popullsia, Tendenca e Lëvizjeve, Migrimi ..... 13*

*2.5.2 Struktura e Popullsisë ..... 14*

3. TIPARET KRYESORE TË ZONËS FUNKSIONALE ..... 16

3.1 Karakterisitkat e Zonës Funksionale ..... 18

*3.1.1 Të dhëna të përgjithshmë mbi ekonominë e ZFK ..... 18*

*3.1.2 Tregu i Punës dhe Struktura e tij ..... 21*

4. ANALIZË E THELLUAR E EKONOMISË SË ZONËS FUNKSIONALE ..... 24

*4.1 Analiza e sektorëve kryesorë të ekonomisë ..... 24*

*4.1.1 Sektori i Bujqësisë ..... 24*

*4.1.1.1 Aktiviteti Bujqësor ..... 24*

*4.1.1.2 Aktiviteti Blegtoral ..... 28*

*4.1.1.3 Bimët Aromatike dhe Medicinale dhe (BMA) ..... 31*

*4.1.2 Peshkimi ..... 32*

*4.2 Sektori i Turizmit ..... 35*

*4.2.1 Turizmi Kulturor ..... 35*

*4.2.1.1 Turizmi rural ..... 36*

*4.2.2 Turizmi Natyror -Dimëror ..... 37*

*4.2.2.1 Turizmi Liqenor ..... 37*

*4.2.3 Minierat ..... 42*

Konkluzione ..... 45

5. SHERBIMET PUBLIKE NE ZONEN FUNKSIONALE KUKËS ..... 46

*5.1 Infrastruktura ..... 46*

*5.2 Transporti ..... 51*

*5.3 Shërbimi i pastrimit dhe menaxhimit të mbetjeve* ... 54
*5.4 Shërbimi i Ujësjellës-Kanalizime* ... 58
6. Organizimi strukturor i Bashkisë së re në përputhje me konceptin e Zonës Funksionale Kukës ... 63
7. Vizioni ... 66
7.1 Objektivat kryesore të zhvillimit të Zonës Funksionale ... 67
8. Projekt – propozimet ... 67
1.1 Projekte ne fushen e Infrastruktures dhe Zhvillimit Urban ... 68
1.2 Projekt – propozime ne Fushen e Mbrojtjes se Ambjentit ... 75
1.3 Projekt – propozime ne fushen e Zhvillimit të Turizmit dhe Ekonomise Lokale ... 83
1.4 Projektet e fushes sociale ... 93

# 1. Hyrje

Hartimi i Programit të Zonës Funksionale të Kukësit u realizua nga ekipi i Europartners Development me një pjesëmarrje të gjerë të aktorëve lokalë. Procesi i hartimit filloi në muajin Gusht 2014 dhe përfundoi në muajin Prill 2015.

Me qëllim krijimin e partneriteteve dhe sigurimin e mbështetjes dhe dialogut të hapur në nivel lokal, u ndërmorën angazhime zyrtare fillimisht nga Bashkia e Kukësit, 2 Komuna, 2 Drejtori rajonale dhe 3 organizata. Bashkëpunimet u shtrinë edhe me mbështetjen e plotë dhe të vazhdueshme të Këshillit të Qarkut të Kukësit.

Në vijim, i gjithë procesi për përgatitjen e Programit të Zonës Funksionale përfshiu një pjesëmarrje të gjerë të përfaqësuesve të Zonës Funksionale të Kukësit dhe për këtë arsye bashkëpunimi u zgjerua me aktorë të tjerë lokalë përkatës që u organizuan në formatin e një

**Forumi i Aktorëve Lokalë**

Forumi u krijua si një strukturë konsultative me përbërje nga përfaqësues të nivelit të lartë nga Bashkia, Këshilli i Qarkut Kukës, Prefektura, komunat, drejtoritë e dekoncentruara, dhomat e tregtisë, organizatat e shoqërisë civile, bizneset dhe specialistët përkatës që kanë dhënë një kontribut të vlefshëm në përgatitjen e dokumentit të programit.

Forumi është mbledhur në Kukës tre herë me pjesëmarrjen e mëposhtme:

| Takimi | Data | Pjesemarres |
|---|---|---|
| **Forumi i 1rë i** | **4 Shtator 2014** | **20 pjesëmarrës** |
| **Gjatë Forumit të parë u bë prezantimi i parë i programit, zhvillimi dhe hapat që duhet të ndërmerren, koncepti i Zonave Funksionale, roli i Forumit në gjithë procesin, informacioni i parë mbi pritshmëritë nga aktorët lokalë, inputi lidhur me nevojat e tyre.**<br><br>**Forumi shërbeu si një shenjë e parë e angazhimit nga aktorët lokalë për tu bërë pjesë e procesit e për të siguruar kontributin e tyre, si dhe për të kuptuar më mirë procesin.** | | |
| **Forumi I 2të** | **25 Nëntor 2014** | **37 pjesemarres** |
| **Gjatë Forumit të dytë u prezantua Drafti i Dokumentit të Programit të Zonës Funksionale të Kukësit. Takimi u konceptua si një platformë e rëndësishme për të prezantuar dhe për të diskutuar gjerësisht me aktorët lokalë të Zonës Funksionale të Kukësit cështje të rëndësishme lidhur me situatën e zhvillimit social dhe ekonomik të zonës, e sfidat me të cilat përballen dhe mundësitë për zhvillim të mëtejshëm.**<br>**Të gjithë pjesëmarrësit i mbështetën plotësisht të tre prioritetet për zhvillimin ekonomik të zonës paraqitur në dokument – bujqësia, turizmi dhe minierat.** | | |

| Forumi i 3të | 5 Mars 2015 | 35 pjesemarres |
|---|---|---|
| **Forumit iu prezantuan shërbimet e Zonës Funksionale të Kukësit dhe projektet potenciale. Forumi shërbeu për të prezantuar dhe diskutuar aktivisht me përfaqësuesit lokalë mbi orientimet strategjike për përmirësimin e shërbimeve dhe projektet potenciale të Zonës Funksionale. Cështjet e infrastrukturës, shërbimeve publike dhe ndërhyrjeve në të ardhmen në drejtim të zhvillimit të tyre ishin ndër cështjet kryesore të ngritura gjatë takimit.** | | |

Në vijim të organizimit të Forumeve, të gjitha prezantimet e bëra gjatë takimeve iu shpërndanë gjerësisht të gjithë aktorëve me qëllim marrjen e inputeve konkrete prej tyre bazuar në diskutimet e përbashkëta dhe/ose materialet mbështetëse, por gjithashtu edhe për ta shpërndarë atë te aktorët e tjerë të interesuar.

Në lidhje me punën për analizën e zhvillimit ekonomik e social të zonës funksionale, ekipi i EPD ka punuar në drejtime të ndryshme, duke alternuar metoda te ndryshme sic paraqitet ne skemen e meposhteme

**Figura 1: Qasja ne punën përgatitore dhe kërkimore për hartimin e analizave**




***Anketimi****:* Ka qenë një instrument i rëndësishëm për të matur opinionin publik mbi situatën në zone. Ekipi i EuroPartners Development për të forcuar burimet e informacionit realizoi gjatë hartimit të Draft Analizës dhe një anketim të shpërndarë tek të gjitha Njësitë e Qeverisjes Vendore (Bashkia dhe 14 Komunat) me anë të një pyetësori për NjQV; dhe një anketim të targetuar për komunitetin e ZF, Shoqërisë Civile dhe Komunitett të Biznesit (50 pyetësorë të shpërndarë) me detajet si vijon:

a. Shpërndarë pyetësorë në të gjitha Komunat e Zonës Funksionale (14), Bashki (1), Qark (1), Agjensitë e Dekoncentruara (Bujqësisë, Arsimit, Punësimit, AKU, ALUIZNI, Shëndetësia)

b. Shpërndarë pyetësorë edhe në ofrues shërbimesh (UKT)

c. Janë shpërndarë pyetësorë të targetuar për Shoqërinë civile dhe bizneset (50)

*i. Shoqëri civile (20)*

*ii. Bizneset (30)*

**Desk research - analize e te dhenave**

Përvec analizes së të dhënave bazë për ZF të Kukësit, janë shfrytëzuar deri tani edhe disa strategji kombëtare si strategjia e turizmit, zhvillimit rural e bujqësisë, minierave, energjisë, për të vlerësuar nëse tipologjia e përgjithshme e problematikës e paraqitur në dokumentat e strategjive ishte gjerësisht relevante edhe me problematikën e hasur në Zonën Funksionale, apo nëse ishin karakteristikë vetëm e kësaj zone.

*Misionet në terren*: Janë organizuar 4 misione në terren me qëllim përftimin e informacionit drejtpërdrejt nga aktorët lokalë në ZF të Kukësit si dhe nga institucionet në nivel qëndror. Në datat 5-6 nëntor u organizuar një mission në Kukës ku u zhvilluan takime individuale me përfaqësues nga Këshilli i Qarkut të Kukësit, Drejtoria e Hartimit e Koordinimit të Politikave, Drejtoria e Gjendjes Civile, Zyra e INSTAT Kukës, Drejtoria Arsimore, Zyra e Punësimit, Drejtoria Rajonale e Bujqësisë dhe Blegtorisë, përfshirë edhe programe të tjera që zbatohen në kuadër të donatorëve të tjerë, komuniteti i biznesit e organizatat e shoqërisë civile. Gjithashtu takimet vijuan edhe në Tiranë me përfaqësues nga INSTAST Tiranë, si dhe ministri të tjera të linjës (Turizmi, Bujqësia, Minierat) e programme të tjera me qëllim analizimin e linjës së veprimit edhe në nivel kombëtar, rajonal e lokal për të identifikuar programet potenciale për ZF të Kukësit.

Gjatë periudhës *10-14 nëntor* u organizua edhe një mision në terren në Kukës për të përgatitur hartëzimin e shërbimeve lokale në ZF të Kukësit. Një element i rëndësishëm i këtij procesi ishte hulumtimi dhe bashkëpunimi me njësitë e dekoncentruara dhe NJQV-ve me qëllim hartëzimin e shërbimeve publike në nivelin më të mirë të inventarit të shërbimeve për secilën nga njësitë e qeverisjes vendore, duke krijuar kështu edhe hartat e shërbimit për zonën funksionale.

Janë organizuar 3 misione të tjera në terren gjatë periudhës *janar dhe shkurt 2015* në Kukës për të përfunduar me përgatitjen e hartëzimit të shërbimeve lokale.

Gjithashtu, është përdorur edhe sistemi GIS për zhvillimin e hartës së shërbimeve. Janë krijuar 19 harta bazuar në të dhënat e mbledhura që janë përdorur si informacion mbështetës në analizën e programit të zonës funksionale të Kukësit dhe hartëzimin e shërbimeve publike.

## 2. Territori i Zonës Funksionale të Kukësit

### *2.1 Pozita Gjeografike, Kufijtë, Përbërja e NJQV-ve*

Zona Funksionale e Kukësit (ZFK) me qendër qytetin e Kukësit ndodhet në Rajonin e Kukësit, si një nga tre zonat funksionale të këtij rajoni, së bashku me Hasin dhe Tropojën dhe mbulon një territor prej 932 km2.

Harta 1: Ndarja e Qarkut të Kukësit në Zona Funksionale




Burimi: Studimi i dldp për Zonat Funksionale.

Ajo shtrihet në pjesën veri-lindore të Shqipërisë dhe kufizohet nga Kosova (Prizreni) në lindje dhe verilindje, ZF e Hasit në Veri, Puka dhe Mirdita në perëndim dhe Dibra në jug. Në krahasim me zonat e tjera të vendit, në nivel territori ZF e Kukësit zë një sipërfaqe mjaft të vogël, rreth 3.2% e sipërfaqes totale të territorit të vendit. Ndërsa si numër popullsie ZF e Kukësit zë 56% të popullsisë së Qarkut të Kukësit[1].

Siç shihet edhe në hartën e mëposhtme, relievi i kësaj zone është kryesisht malor. Në këtë zonë shtrihet Mali i Gjallicës dhe Mali i Koritnin, të cilat janë pjesë e Vargmalit të Korabit si dhe Lugina e Drinit e cila dallohet për relievin shumë të ashpër dhe grykat e ngushta, në të cilat janë ndërtuar digat e hidrocentraleve të mëdha. Shtrirja e një pjese të Vargut të Korabit në këtë zonë thekson karakteristikën e saj si zonë malore, ku vendbanimet arrijnë deri në rreth 1400 m lartësi.

Në këtë zonë shtrihet një pjesë e liqenit te Fierzës, i cili është liqeni më i madh artificial në Shqipëri. Gryka e Morinit, nëpër të cilën kalon rruga për në Prizren, e bën këtë zonë një nyje lidhëse me Kosovën.

[1] Qark, 2014 ëëë.kqk.gov.al, Census 2011, INSTAT

Harta 2: Harta Fizike e Zonës Funksionale të Kukësit




ZF e Kukësit përfshin në administrimin e vet 15 Njësi të Qeverisjes Vendore (NJQV), nga 27 gjithsej që ka Rajoni i Kukësit, (1 Bashki dhe 14 komuna), duke e pozicionuar këtë zonë në vend të parë për numrin e NJQV-ve në krahasim me 2 zonat e tjera funksionale të Rajonit të Kukësit, edhe pse në raport me sipërfaqen kjo zonë zë rreth 39.5% të territorit që mbulon Qarku i Kukësit, në raport me popullsinë ajo zë më shumë se 56% të totalit të popullsisë duke mbetet qendra e ndërveprimeve dhe e institucioneve në nivel qarku.

Harta 3: Ndarja Administrative e Zonës Funksionale të Kukësit



Duke u bazuar në klasifikimin e ri të të zonave urbane dhe rurale, të realizuar mbas Censusit 2011, ZF Kukësit dallohet për karakterin e saj rural. Ajo përfshin 1 qendër urbane dhe 14 zona rurale[2].

Bashkia e Kukësit është qendra kryesore e ZF, dhe më e rëndësishme si në aspektin ekonomik, administrativ, dhe atë social. Qendra të tjera ekonomike përfshijnë Bicaj, Shtiqen, Shishtavec dhe Shemri (Malzi). Pavarësisht këtyre qendrave ekonomike, Kukësi është edhe vendi ku zhvillohet aktiviteti tregtar kryesor.

## *2.2 Infrastruktura*

Në këtë zonë kalon autostrada Durrës - Morinë e cila është pjesë e aksit rrugor kombëtar që lidh Shqipërinë me Kosovën. Akset kryesore që lidhin qendrën e kësaj zone, qytetin e Kukësit me zonat e tjera janë: aksi Kukës-Durrës (1.5 orë), aksi Kukës-Peshkopi (1.5-2 orë), aksi Kukës-Has (30-40 min), aksi Kukës-Shishtavec (30 min) dhe aksi Krumë-B.Curri (1 orë e 45 min).

Në këtë zonë ndodhet pika kufitare më e rëndësishme që lidh Shqipërinë më Kosovën, Morinë/Kukës dhe 4 (katër) pika kufitare të tjera (Shishtavec/Kukës, Orgjosë/Kukës, Borje/Kukës për këmbësorët dhe, Qafa Prush/Kukës për ngarkesa dhe mjete).

Megjithëse ngritja e autostradës Durrës-Kukës-Morinë ka krijuar një lirshmëri mjaft të madhe të aksesit të ZF nga brenda vendit e krijimit të urave lidhëse me vendet e tjera, infrastruktura e brendshme midis komunave e bashkisë ende ka punë për shkak edhe të terrenit mjaft të vështirë e kushteve të pafavorshme klimaterike.

Qyteti i Kukesit shërben si pikë lidhëse mes Shqipërisë, Kosovës dhe Maqedonisë. Gjithashtu aeroporti i Kukësit ndërtuar në 2004 është një favor me perspektivë për këtë zonë duke qenë aeroporti i dytë me i madh në Shqipëri.

Për sa i përket infrastrukturës rrugore në ZF të Kukësit ka 122.5 km akse rrugore rajonale dhe 181 km rrugë kombëtare, duke zënë përkatësisht 67% të të gjithë rrjetit rrugor rajonal të Qarkut të Kukësit dhe 55% të rrjetit rrugor kombëtar që shtrihet në këtë qark. Cilësia e infrastrukturës rrogore, edhe pse investimet kanë qenë të shumta, lë ende për të dëshiruar. Aktualisht, afërsisht 119 rrugë rurale në këtë zonë janë ende të paasfaltuara. Për të përshkuar rrugën nga komunat deri në Kukës si qendër administrative duhen mesatarisht rreth 47 min. Për sa i përket komunave që duan rreth 150 min (Arren, Ujmisht, Bushtrice, Gryke Cajë, Kalis), me zmadhimin e territorit do të mund të krijohen pika shërbimi komunale, në të cilat banorët e këtyre komunave të mund të marrin shërbimet e nevojshme në vendin e tyre të banimit. Me zmadhimin e NJQV-së do të mundësohet një investim më i madh për sa i përket infrastrukturës, gjithmonë duke marrë parasysh karakteristikat e relievit të zonës[3].

[2] Shih: "Një Klasifikim i Ri Urban - Rural i Popullsisë Shqiptare. Tipologjia Gjeografike e BE-së e Bazuar në të Dhënat e Rrjetit të Qelizave" INSAT Maj 2014 , fq 21-22

[3] Shih PNUD "Raporti i Zonave Funksionale" 2014

Harta 4: Infrastruktura Rrugore




Në qytetin e Kukësit, përdorimi i transportit publik nga qytetarët për lëvizje ndërmjet zonave të ndryshme është tepër minimal (0.6%). Niveli më i lartë i përdorimit të transportit publik rezulton në Shtiqën me 2.9%. Pjesa tjetër e shërbimeve të transportit ofrohet nga sektori privat nëpërmjet shërbimit të furgonave dhe shërbimit taksi. Aktualisht, infrastruktura e fragmentuar ndërmjet bashkive e komunave bën që aksesi ndaj këtij transporti të jetë i ulët. Në gjithë zonën mungojnë stacionet e udhëtarëve, c'ka bën që lëvizja e automjeteve dhe pikat e ndalimit të pasagjerëve të vendosen arbitrarisht edhe pa një plan të caktuar të pikave të transportit urban e ndërurban.

## 2.3 *Klima dhe Mjedisi*

Klima është tipike kontinentale. Vera është e nxehtë e me pak reshje dhe dimri i ftohtë me shumë dëborë e ngrica. Pellgu kryesor ujmbledhës i rajonit është ai i lumit Drin (Drini i Bardhë dhe Drini i Zi), të cilët në këtë pjesë formojnë liqenin e Fierzës i cili shfrytëzohet kryesisht për energji elektrike.

ZF e Kukësit ofron një biodiversitet dhe klimë të pasur duke përfshirë një natyrë me male të larta, kodra, pllaja, lumenj e liqene duke qenë kështu një zonë e pasur me burime hidrike. E veçantë është mbledhja e të gjitha derdhjeve, rrjedhave e lumenjve që derdhen në lumin Drin, e përfundojnë me bashkimin e Drinit me Bunën. Liqeni i Fierzës mbetet qendra e të gjitha rrjedhave dhe mjedisi ujor është mjaft i përshtatshëm për zhvillimin e peshkimit. Mbrojtja e ruajtja e mjedisit dhe biodiversitetit përbën një fokus të veçantë për ZFK duke e vendosur burimet e pasura kundrejt shfrytëzimit të tyre. Dëmtime të dukshme në mjedis kanë të bëjnë me pyjet (shpyllëzimi e mungesa e kujdesit), ndotjen e ujit për shkak të depozitimit të mbetjeve (menaxhimi jo i duhur i mbetjeve në përgjithësi e depozitimit të tyre) në Liqenin e Fierzës, vendosja e standardeve për bujqësinë e blegtorinë, etj.

Shtimi dhe përmirësimi i mjediseve të gjelbra është një tjetër element, i cili duhet të merret në konsideratë për krijimin e një mjedisi të shëndetshëm dhe estetik. Kjo në radhë të parë kërkon

përcaktimin konkret në terren të zonave të gjelbra, dhe specifikimin e instrumenteve për mbrojtjen dhe zhvillimin e tyre në të ardhmen. Ekzistenca e burimeve të shumta ujore duhet të shfrytëzohet nga autoritetet dhe banorët e zonës, si një potencial për krijimin dhe shtimin e zonave të gjelbra.

Pasuritë natyrore të ZF të Kukësit renditen nga malet[4], shpellat, kanionet, lumenj, liqene, burime të shumta ujore, pyje e kullota, flora, fauna. Në total në këtë zonë gjenden 41 zona të mbrojtura, një pjesë ë të cilave përmenden më poshtë.

## *2.4 Historia, Kultura, Traditat dhe Atraksionet Kryesore*

ZF Kukësit ka histori e kulturë të gjerë, tradita vendase, shumëllojshmëri e produkte bujqësore, kulinari, të cilat janë potenciale mjaft të vlefshme për zhvillimin e turizmit në vend (eko-turizmit, turizmit malor, etj). Ka një gamë të gjerë veprimtarish kuturore-artistike që zhvillohen në këtë zonë, kryesisht në qendrën e saj të Kukësit si manifestime, festivale, konkurse letrare, panaire, ekspozita, festa e ditë festive (si Festa e Gështenjës, Festa e Patates, Dita e Artizanatit, Dita e Bujarisë, Festat e Komunave, Ditë Peshkimi, Festa e Mjaltit, Pelegrinazh Pashtrik, Dita Rajonale e Arsimit, Kolonia Kombëtare e Piktorëve "ArtKukës"), konferenca, ditë mikërpritjeje, javë arti, kampionati i skive në Shistavec, peshkim e lundrim, alpinizëm, kampingje, përfshirë evenimente ndërkufitare me Kosovën të cilat e pasurojnë jetën artistike e sportive të zonës. ZF është e pasur në site kulturore, fetare, monumente e historike, si dhe tradita e folklori, të cilat janë bërë pjesë e trashëgimisë kulturore kombëtare: Banesa e Hasan Rexhepit, Kalaja e Lekes (Mal Zi), Gradishta e Bardhocit (Tërthore), Banesa e Asllan Fetahut, Banesa e Rustem Shahinit, "Hisari" ne Domaj, Keshtjella e Bushatit, Shkolla e Vjetër e Bicajve (Bicaj) dhe Kalaja e Vilës (Bushtricë). 4 nga keto monumente janë në pronësi të shtetit dhe 5 pronësi private.

*Tabela 1. Monumentet e Kulturës*

| Nr | Emer i Monumentit | Fshati |
|---|---|---|
| 1 | Banesa e Asllan Fetahut | Bicaj, |
| 2 | Banesa e Rustem Shahinit | Osmanaj |
| 3 | Hisari në Domaj | Domaj |
| 4 | Kështjella e Bushatit | Bushat |
| 5 | Shkolla e Vjetër e Bicajt | Bicaj |
| 6 | Banesa e Hasan Rexhepit | Shtan |
| 7 | Kalaja e Lekës | Vau-Spas |
| 8 | Kalaja e Vilës | Vile |
| 9 | Gradishta e Bardhocit | Bardhoc |

Në ZF ka një muze historik, Stadium i ri, këndi i lojrave me dorë, 2 biblioteka, salla koncertesh, 1 orkestër në Kukës, 1 qendër kulturore, fusha futbolli e volejbolli, ndërtesa fetare: 1 kishë dhe një xhami në Kukës, si dhe disa kisha e xhami të vogla nëpër fshatrat përreth. Atraksionet e tilla si male, lumenj, liqene, monumente, shpella, lugina, etj (të përmendura në detaj në seksionin për Mjedisin) i shtojnë potencialet për ta shndërruar Kukësin në një zonë të frekuentuar turistike.

Kjo Zonë ka asete të mjaftueshme për të tërhequr turistët, veçanërisht burimet e jashtëzakonshme natyrore në majat e maleve, kullotat alpine, luginat e thella, si dhe liqenet dhe

[4] Pasuritë natyrore të ZF të Kukësit renditen nga malet (Korab-Koritnik, Gjallica, Malet e Sharrit, Bjeshkët e Namuna), shpellat (Jezines, Mamëzit, Akullit, Pëllumbave, Dajcit, Skënderbeut, Përbregut, Sasatit, etj), kanioneve (Bicaj, Arni, Vana, Shoshan, Shtrenjti), lumenj (Kalimash, Srriqes, Goskes, Drini i Bardhë, i Zi, i Bashkuar, Luma, Bushtrica, Tërshena), liqene (Fierza, Novosejt), burime (Kroi i Kuq, i Bardhë, i Kinzës, i Tanzot, Gurra e Bostanjerës, Kolosjanit)

lumenjtë spektakolarë. Atraksionet që tërheqin më shumë turistë janë, Liqeni i Fierzës, Shishtaveci, kanionet e Gjallicës, etj.

Nga ana tjetër, sa përket shërbimeve, mungesa e aksesit social, kulturor, sportiv të komunave larg qendrës Kukës, përbën një mungesë të kushtëzuar nga fakti se shumica e qendrave sociale, kulturore, sportive dhe shëndetësore janë përqendruar vetëm në qendrën urbane të Kukësit. P.sh:. Komunat Arrën, Kalis, Surroj, Ujmisht, Grykë Çaje, etj.

## 2.5 Tendencat Demografike

### *2.5.1 Popullsia, Tendenca e Lëvizjeve, Migrimi*

Popullësia në Zonën Funksionale të Kukësit shënon (sipas Census 2011) 47,985 banorë. Popullësia e ZF të Kukësit përbën 56% të popullsisë totale të Rajonit të Kukësit (prej 85,292 banorë), ose më shumë se gjysmën e popullsisë së dy zonave të tjera funksionale, asaj të Tropojës (24%) dhe të Hasit (20%). Në nivel vendi, duke qenë se popullsia e Qarkut Kukës përbën më pak se 4% të popullsisë së vendit, dhe popullsia mesatare për njësi të qeverisjes vendore në këtë qark rezulton 3,159 banorë/NJQV, ose 60% më e ulët se mesatarja kombëtare prej 8.016 banorë/NJQV, llogaritjet krahasuar me ZF të Kukësit rezultojnë edhe më të vogla. Njësitë më të vogla janë Arrën dhe Kalis në Kukës (më pak se 1300 banorë së bashku).

*Tabela 2: Popullsia dhe dendësia në ZF*

| Njësitë e Qeversjes Vendore | Popullsia | Dendësia Banorë/ km2 |
|---|---|---|
| Bashkia Kukës | **16,719** | **1013** |
| Komuna Kolsh | 1,250 | 27 |
| Komuna Shtiqen | 3,438 | 96 |
| Komuna Malzi | 3,072 | 19 |
| Komuna Terthore | 2,959 | 42 |
| Komuna Zapod | 2,217 | 63 |
| Komuna Surroj | 1,099 | 13 |
| Komuna Bicaj | 5,631 | 71 |
| Komuna Topojan | 1,753 | 24 |
| Komuna Shishtavec | 3,835 | 65 |
| Komuna Arren | 462 | 8 |
| Komuna Ujëmisht | 1,797 | 33 |
| Komuna Grykë Cajë | 1,440 | 16 |
| Komuna Bushtricë | 1,486 | 37 |
| Komuna Kalis | 827 | 29 |
| **TOTAL ZF Kukës** | **47,985** | **51** |

*Burimi: Raporti i UNDP mbi Zonat Funksionale, 2013*

Kukësi, si qendër urbane ka dendësi popullsie relativisht të lartë (1.013 banorë/km$^2$). Vërehet se kjo shifër është mjaft e ulët në komuna, nën nivelin 28 banorë/km$^2$ mesatarisht, por ka edhe komuna ku dendësia arrin në shifra fare minimale si komuna Arren (8 banore/km$^2$). NjQV-të përreth kanë një dendësi popullsie mesatare, ndërsa pjesa tjetër e NJQV-ve, që janë larg nga qendra, janë pak të banuara dhe me ndërveprime shumë të dobëta, duke qenë të distancuara nga qendra e zonës funksionale. Dendësia mesatare e ZF është 51 banorë/km$^{2.}$

Analizat e kohëve të fundit nxjerrin në pah dy tendenca të rëndësishme lidhur me popullsinë: (i) shpopullimi i përgjithshëm (ii) dhe shpopullimi i ndjekur nga migrimet ndër-rajonale nga zonat rurale në qendrat urbane. Vitet e fundit popullsia e bashkive u rrit me 3.8%, ndërsa në komuna ajo ka rënë me 2.5%. Sic tregohet edhe nga harta e mëposhtme, komunat që kanë përjetuar rënien më të madhe janë; Kalis (42.8%), Kolsh 30.6%, dhe Topojan (12.8%)[5]. Shifrat më të ulëta të dendësinë janë vërejtur në komunat Arrën (8 banorë/km2) e Grykë-Çaje (10 banorë/km2)[6].

5 Në hartë këto zona janë shënuar me ngjyrë bezhë të celët. Strategjia e Zhvillimit Rajonal Kukës, 2012-2016

6 Në nivel qarku në krahasimin 2001-2011 ka pasur një rënie prej 23% si ndër shifrat më të larta për shkak të emigracionit.(shih Shqipëri:Popullsia dhe Dinamikat e Saj-Horizonte të Reja Demografike? - INSTAT, Maj 2014)

Harta 5: Lëvizja e Popullsisë




Harta tregon lëvizjet e popullsisë, ku ngjyra kafe e fortë tregon ku kanë rezultuar lëvizjet më të mëdha dhe koncentrimi i popullsisë.

Faktorët kryesorë që kontribuojnë në këto zhvillime demografike janë të lidhura me tranzicionin ekonomik: mbylljen e shumë ndërmarrjeve në pronësi shtetërore dhe papunësisë që e shoqëroi; infrastrukturën e transportit dhe të komunikimit tepër të dobët; terrenit në përgjithësi të vështirë; kushteve të pafavorshme klimatike dhe bujqësore, etj. Migrimi nga zonat rurale në ato urbane brenda qarkut lidhet gjithashtu me kushtet e vështira të punës në bujqësi, produktiviteti i ulët i këtij sektori dhe aksesi i kufizuar ndaj shërbimeve në zonat rurale.

## *2.5.2 Struktura e Popullsisë*

Zona Funksionalë e Kukësit paraqitet më një popullsi relativisht të re duke qenë një karakteristikë që e dallon atë edhe në rang vendi[7]. Tendencat e tre grup-moshave kanë qenë pak a shumë të qëndrueshme që nga viti 2006. Nëse shikojmë strukturën e popullsisë, vëmë rë se 49% të saj e përbën mosha e aftë për punë dhe pjesa tjetër 14% përbëhet nga fëmijët (mosha e re) dhe 37% e përbën grup mosha 65 vjet e lartë (shih grafikun 1 më poshtë). Bazuar në këtë strukturë moshe të popullsisë në këtë zonë situata e mbulimit paraqitet kritike nëse krahasohet me mesataren e vendit. Koeficienti i shkallës së mbulimit për të rinjtë është në total 76%, dhe paraqitet më i lartë se mesatarja e koeficientit për gjithë qarkun e Kukësit (43.2%). Po kështu, edhe shkalla e mbulimit për të moshuarit paraqitet e lartë nëse e krahasojmë me mesataren për qarkun e Kukësit (12.4%)[8], apo në rang vendi (shih tabelën 3 më poshtë). Kjo nënkupton një barrë të konsiderueshme të personave të varur brenda njësive ekonomike familjare dhe ekonomisë së zonës në përgjithësi. Kjo shkallë varësie vjen si rezultat i shkallës së lartë të lindjeve që vazhdon të jetë më e larta në republikë. Shtimi natyral i popullsisë së zonës funksionale në shtatë vitet e fundit paraqitet me një mesatare prej 120 banorë në vit.

[7] Shih INSTAT "Shqipëri Projeksionet e Popullsisë 2011-2031" Maj 2014

[8] Sipas te dhënave të Census 2011: shih Shqipëri:Popullsia dhe Dinamikat e Saj-Horizonte të Reja Demografike? - INSTAT, Maj 2014

*Grafiku 1: Struktura e Popullsisë sipas moshës*




*Tabela 3: Shkalla e Mbulimit*[9]

| Shkalla e Varësisë | Total | Urbane | Rurale |
|---|---|---|---|
| **Për të Rinjtë** | 76% | 84% | 72% |
| **Për të Moshuarit** | 30% | 32% | 29% |
| **Raporti i Përgjithshëm** | 1.06 | 1.16 | 1.01 |

*Burimi: Të dhënat e Qarkut të Kukësit 2014*

Sic shihet nga të dhënat, perspektiva e ardhshme lidhur me dinamikën e popullsisë e parë nën këndvështrimin edhe të tregut të punës paraqitet pozitive, me tendencë në rritje të fuqisë punëtore të aftë për punë në të ardhmen. Kjo tendencë nga ana tjetër shtron përpara sfidën e ndërrmarjes së politikave të duhura për tregun e punës me qëllim punësimin e kontigjenteve të reja që i shtohen tregut të punës në këtë zonë.

Kukësi është konsideruar gjithmonë si një ndër rajonet më të varfëra të vendit. PBB e llogaritur është 1,753 Euro për frymë, ndërkohë që PBB e vendit është 2469 Euro. Në vitin 2010, numri i familjeve që përfitonin ndihmë ekonomike[10] ishtë 1027 familje për 10.000 banorë dhe që nga viti 2006 ky tregues ka rënë vetëm me 2.5%[11].

Përgjithësisht, numri më i madh i familjeve që përfitojnë ndihmë ekonomike jetojnë në zonat rurale (komuna). Vihet re se familjet që jetojnë në zonat urbane i nënshtrohen mbulimit të plotë të ndihmës ekonomike, kurse ato që jetojnë në zonat rurale janë subjekt i llojit të pjesshëm të ndihmës. Këto të fundit trajtohen kryesisht me ndihmë të pjesshme ekonomike, sepse ata konsiderohen si të vetë-punësuar në sektorin e bujqësisë, ndonëse ata përballen me vështirësi të ndryshme financiare. Megjithatë, këto vlera mund të jenë të nënvlerësuara nëse marrim parasysh efektin e shpopullimit. 18 nga 27 komunat në nivel rajoni kanë një numër në ulje të familjeve që përfitojnë ndihmë ekonomike për 10.000 banorë. Rëniet më të mëdha vihen re në komunat e ZF të Kukësit si Surroj (-51 %), Zapod (-19%), Shishtavec dhe Kolsh (-18%). Ndërsa vetëm Bushtrica nga ZF e Kukësit ka rritjet më të mëdha të këtij treguesi, të tjerat i përkesin komunave të ZF të tjera të rajonit të Kukësit. Një tjetër tregues mbi situatën sociale në qark janë edhe shpenzimet që bëhen për konsum. Më shumë se gjysma e këtyre shpenzimeve në qark shkojnë për konsum ushqimi dhe pijesh jo-alkoolike. Kukësi është një ndër 5 rajonet me tregues të lartë të këtij lloj shpenzimi.

[9] Shkalla e mbulimit përfaqësonë respektivisht raportin e popullsisë së grupmoshave 0-14 vjeç dhe 65 vjeç e lart kundrejt popullsisë në moshën 15-64 vjeç.
[10] Sipas ligjit nr 9355, datë 10.3.2005 për ndihmën dhe shërbimet shoqërore; "Ndihmë ekonomike" është mbështetja, në para e natyrë, e individëve me status të veçantë dhe e familjeve në nevojë
[11] Strategjia e Zhvillimit Rajonal, Kukës

## 3. TIPARET KRYESORE TË ZONËS FUNKSIONALE

Bazuar në konceptin mbi organizimin e zonave funksionale në Qarkun e Kukësit janë identifikuar qartë tre ZF, Kukësi, Hasi dhe Tropoja. Kufijtë e këtyre zonave korrespondojnë me kufijtë e rretheve përbërëse të Qarkut[12].

ZF mund të konsiderohet edhe si *qendra kryesore administrative* e Qarkut, pasi në të janë të vendosur edhe institucionet kryesore te dekoncentruara si dhe struktura të qeverisjes qëndrore në nivelin lokal, si: Nënprefektura, Gjykata, Prokurori, apo drejtorite rajonale të arsimt, shëndetësisë, bujqësisë etj.  Kjo sjell si rezultat një ndërveprim institucional të zyrave në nivel rrethi të përfaqësuara në qytetin e Kukësit, Bajram Currit dhe Krumës, ndërveprim që lidhet me përgjegjësitë dhe funksionet që secila prej këtyre zyrave si në nivel rrethi dhe qarku kanë në përgjegjësinë e tyre ligjore.

Harta 6: Nderveprimet në punësim




Qyteti i Kukësit, si qendër administrative është qendra e gravitetit të të gjithë zonës. Aty ndodhen të gjitha shërbimet e nevojshme sociale, administrative, ekonomike. ZF e Kukësit hyn *në modelin e përqendruar të zonës funksionale*, në të cilin ka vetëm një qendër të rëndësishme që është qyteti ose qendra administrative e rrethit. si i tillë ai ofron shërbime dhe është qendra e mishërimit të ndërveprimeve për të gjithë zonën duke rritur mundësinë e gjenerimit të të ardhurave vendore për komunitetin lokal.

Qendra e Kukësit si zonë funksionale, dallohet për *bashkëveprim për sa i përket punësimit, konsumimit dhe aksesit në shërbime.* Karakteristikë në këtë ZF është një përqendrim i ndërveprimit ekonomik nga komunat drejt qendrës Kukës, një tendencë kjo e hasur edhe në ZF të tjëra të Qarkut të Kukësit: Bajram Curri dhe Krumë.

Bashkia e Kukësit është qendra kryesore e ZF, dhe më e rëndësishme si në aspektin ekonomik, administrativ, dhe atë social. Qendra të tjera ekonomike përfshijnë Bicaj, Shtiqen, Shishtavec dhe Shemri (Malzi). *Pavarësisht këtyre qendrave ekonomike, Kukësi është edhe vendi ku zhvillohet aktiviteti tregtar kryesor.* Kjo vjen për shkak edhe të strukturës ekonomike të zonës, ku Qyteti i Kukëst shikohet si i vetmi vend i rëndësishëm i tregut, në të cilin janë realizohen edhe nderveprimet kryesore tregëtare.

[12] dldp Studimi mbi Zonat Funksionale

Në aspektin e *bashkëveprimit ndërkufitar Kukësi është edhe qendra kryesore e ndërveprimit tregetar më Kosovën* për shkak të afërsisë së tij me tregun e Kosovës e veçanërisht me dy qytetet kryesore të Rajonit Ekonomik Jugor të Kosovës, Prizrenin dhe Gjakovën. Aksesi direkt në rrjetin kombëtar rrugor si rezultat i ndërtimit të autostradës Durrës – Kukës, e ka afruar Kukësin edhe me tregjet e tjera brenda territorit të vendit, duke rritur në këtë mënyrë aksesin e ZF si në tregun vendas edhe atë rajonal.

Harta 7 : Nderveprimet e tregjeve




*Burimi*: Studimi i Zonave Funksionale, dldp

Kukësi, si qendër urbane ka dendësi popullsie relativisht të lartë, NjQV-të përreth kanë një dendësi popullsie mesatare, ndërsa pjesa tjetër e NJQV-ve, që janë larg nga qendra, janë pak të banuara dhe me ndërveprime shumë të dobëta, duke qenë të distancuara nga zona funksionale.

Dy tendenca të rëndësishme janë vënë re në këtë rreth: shpopullimi i përgjithshëm i ndjekur nga migrimet ndër-rajonale nga zonat rurale në qendrat urbane. Vitet e fundit popullsia e bashkive u rrit me 3.8%, ndërsa në komuna ajo ka rënë me 2.5%. Komunat që kanë përjetuar rënien më të madhe janë; Kalis (42.8%), Kolsh 30.6%, Fierzë (13.5%) dhe Topojan (12.8%). Bashkia e Kukësit rezulton NJQV me dendësinë e popullsisë mbi mesataren rajonale, përkatësisht me 2.569 banorë/km2. Shifrat më të ulëta të dendësinë janë vërejtur në komunat Arrën (10 banorë/km2) e Grykë-Çaje (20 banorë/km2). Bashkia Kukës ka një popullsi relativisht të re. Tendencat e tre grup-moshave kanë qenë pak a shumë të qëndrueshme që nga viti 2006.

Faktorët kryesorë që kontribuojnë në këto zhvillime demografike janë të lidhura me tranzicionin ekonomik: mbylljen e shumë ndërmarrjeve në pronësi shtetërore dhe papunësisë që e shoqëroi; infrastrukturën e transportit dhe të komunikimit jashtëzakonisht të dobët; terrenit në përgjithësi të vështirë; kushteve të pafavorshme klimatike dhe bujqësore; si dhe shfrytëzimit pa kriter të pyjeve.

Ajo që vihet re në Zonën Funksionale të Kukësit është fakti se afër qendrës funksionale të Kukësit, si qendër urbane ka relativisht një dendësi popullsie të lartë, njësitë e qeverisjes vendore (NjQV) përreth kanë një dendësi popullsie mesatare, ndërsa pjesa tjetër e NJQV-ve, që janë larg nga qendra janë pak të banuara dhe me ndërveprime shumë të dobëta, duke qenë të distancuara nga zona funksionale.

Faktorët që kontribuojnë në gjendjen aktuale janë:

1. Tranzicioni ekonomik dhe rënia e ofertës së punës;

2. Migrimi nga zonat rurale në ato urbane brenda qarkut si rrjedhojë e kushteve të vështira të punës në bujqësi, produktiviteti i ulët i këtij sektori dhe aksesi i kufizuar ndaj shërbimeve në zonat rurale,

## 3.1 Karakterisitkat e Zonës Funksionale

### *3.1.1 Të dhëna të përgjithshmë mbi ekonominë e ZFK*

Historia e zhvillimit të ekonomisë së rajonit të Kukësit tregon për një zhvillim gradual të shërbimeve që në vitet 45 me fokus në bujqësi e blegtori. Kukësi ishte një vend i njohur dhe me traditë në rritjen dhe mbarështrimin e deleve. Cilësia e mishit dhe e leshit të deleve lumjane ishin të njohura në të gjithë Ballkanin. Deri para viteve '90, banorët e Zonës Funksionale të Kukësit kanë qenë të angazhuar në aktivitete të tilla si minierat, sektori i tregtisë, industrisë së lehtë ushqimore, punimet artizanale, ndërtim, etj. Përmes liqenit artificial të Fierzës bëhej i mundur transporti i mallrave dhe udhëtarëve. Një pjesë e konsiderueshme e banorëve të qytetit dhe të fshatrave punonin në zonën nxjerrëse dhe përpunuese të kromit në Kalimash, në minierën e nxjerrjes së bakrit në Gjegjan, etj. Pas '90, pothuajse tërë këto aktivitete shtetërore u mbyllën, gjë që çoi në rritjen e papunësisë dhe varfërisë për banorët. Kukësi ishte gjithashtu një qendër e njohur e transportit liqenor, i vetmi i llojit të tillë në Shqipëri.

Tabela 4:Kontributi i Qarqeve në PBB (%)

| | 2008 | 2009 | 2010 | 2011 | 2012* |
|---|---|---|---|---|---|
| Dibër | 2.9% | 3.0% | 3.1% | 2.9% | 3.2% |
| Durrës | 9.5% | 9.6% | 10.2% | 10.0% | 9.9% |
| **Kukës** | **2.2%** | **2.2%** | **2.2%** | **2.2%** | **2.1%** |
| Lezhë | 3.4% | 3.4% | 3.2% | 3.2% | 3.4% |
| Shkodër | 5.6% | 5.7% | 6.0% | 5.7% | 5.4% |
| Elbasan | 7.3% | 7.4% | 8.1% | 8.1% | 7.9% |
| Tiranë | 40.5% | 40.5% | 38.8% | 38.3% | 38.2% |
| Berat | 4.0% | 4.0% | 4.1% | 4.2% | 4.1% |
| Fier | 10.2% | 9.8% | 10.6% | 11.1% | 12.4% |
| Gjirokastër | 2.2% | 2.2% | 2.2% | 2.5% | 2.2% |
| Korçë | 5.6% | 5.7% | 5.6% | 5.5% | 5.5% |
| Vlorë | 6.5% | 6.5% | 6.0% | 6.3% | 5.8% |

*Burimi: INSTAT*

Pavarësisht se është një rajon i pasur me burime të shumta natyrore dhe mundësi të shumta, ZF e Kukëst, si i gjithë Rajoni i Kukësit është dhe një nga zonat më të varfra në të gjithë Shqipërinë. Kjo duket qartë në analizën e të dhënave të Prodhimit të Përgjithshëm Bruto (PBB). Kontributi i këtij rajoni në Prodhimin e Brendshëm vazhdon të jetë më i ulti në vitet e fundit në rang vendi, vetëm 2.2%. Po kështu niveli i PBB për frymë është më i ulti, duke qenë në një nivel rreth 30% më të ulët se mesatarja kombëtare dhe 12% më të ulët se mesatarja e zonës veriore.

Tabela 5: PBB për frymë

| | 2008 | 2009 | 2010 | 2011 | 2012* |
|---|---|---|---|---|---|
| Ne nivel kombetar | 366,665 | 390,754 | 425,554 | 447,754 | 460,436 |
| Zona e Veriut | 287,448 | 311,075 | 351,706 | 360,353 | 371,667 |
| Rajoni Kukes | 246,346 | 271,812 | 305,599 | 329,255 | 319,935 |
| **Ne raport me Mesataren Kombetare %** | **67.2%** | **69.6%** | **71.8%** | **73.5%** | **69.5%** |
| **Ne raport me Zonen e Veriut %** | **85.7%** | **87.4%** | **86.9%** | **91.4%** | **86.1%** |

*Burimi: INSTAT*

Tabela 6: Prefektura Kukës: Vlera e Shtuar Bruto sipas sektoreve (në %)

| | 2008 | 2009 | 2010 | 2011 | 2012 |
|---|---|---|---|---|---|
| Bujqësia, gjuetia dhe pyjet;Peshkimi | 29.4 | 28.9 | 31.5 | 40.2 | 36.9 |
| Industria | 13.1 | 14.5 | 13.9 | 6.6 | 7.9 |
| Ndërtim | 20.9 | 19.5 | 17.5 | 16.2 | 15.4 |
| Tregëti, Hotele, Restorante, Transport dhe Komunikacioni | 13.7 | 13.2 | 13.0 | 11.4 | 11.1 |
| Ndërmjetësimi Financiare, pasuri të pa-tund, qera etj | 6.0 | 5.6 | 5.9 | 7.5 | 8.6 |
| Shërbime të tjera | 16.9 | 18.4 | 18.2 | 18.1 | 20.2 |

*Burimi: INSTAT*

Niveli i ulët i zhvillimit ekonomik të zonës lidhet më faktin se të ardhurat në këtë zonë gjenerohen kryesisht nga sektorët me produktivitet të ulët. Ekonomia e kësaj zone bazohet në sektorin e bujqësisë (shih tabelën 6 ) e cila zë mesatarisht 33% të gjithë të vlerës së shtuar bruto për rajonin, ndërkohë që kontributi i industrisë është vetëm në nivelin mesatar për rreth 11%, dhe siç dallohet nga tabela kontributi i këtij sektori ka ardhur në rënie në vitet e fundit.

Ekonomia e zonës funksionale mbizotërohet nga biznesi individual apo ai familjar dhe kryesisht është e bazuar tek tregëtia e vogël. Kjo shpjegohet edhe nga struktura e ndërmarrjeve ku 81% e zënë bizneset e vogla që punësojnë deri 4 persona, që kryesisht janë biznese familjare (grafiku 2) .

Ndërmarjet e biznesit të madh janë të përqëndruara (grafiku 3 më poshtë), kryesisht në sektorin e shërbimeve (48%) dhe të tregëtisë (34%) ndërsa sektori i ndërtimit (16%) dhe prodhimit (13%) energji, miniera zënë një përqindje më të vogël, c'ka tregon edhe një herë se ekonomia e zonës bazohet në sektorët që gjenerojnë më pak të ardhura. Prezenca e ndërmarrjeve me kapital të huaj është pothuajse e papërfillshme vetëm 2 ndërmarrje ose 1.1% e ndërmarrjeve të biznesit të madh, ndërsa ato me kapital të përbashkët (3) zënë vetëm 1.6% të totalit të ndërmarrjeve të kësaj kategorie.

Sot, sektorët kryesorë të punësimit janë sektori i tregtisë dhe i shërbimeve, sektori i transportit dhe, pjesa tjetër që janë më të paktë, janë sektori prodhues dhe ai i ndërtimit, i cili bazohet kryesisht në kontraktimet publike.

Grafiku 2: Struktura e Ndërmarrjeve




*Burimi:Qarku i Kukësit*

Grafiku3: Struktura e Biznesit sipas Degëve të Ekonomisë




*Burimi:Qarku i Kukësit*

Sic edhe shihet nga harta 5 më poshtë shumica e bizneseve janë të përqëndruara në Bashkinë e Kukësit (79%[13]), ndërsa komunat paraqiten me një numër të reduktuar biznesesh në totalin e tyre. Pas Kukësit më një numër shumë të vogël vijnë Tërthore (17 njësi), Shtiqen (16 njësi) dhe Malzi (15 njësi).

Harta 8: Koncentrimi i Bizsneve brenda ZF




*Burimi: INSTAT*

[13] 503 biznese kundrejt 637 bizneseve në total (Burimi Instat)

Ndërsa komuna të tilla si Grykë Çajë dhe Komuna Ujmisht kanë respektivisht 1 dhe 2 biznese në total. Prezenca kaq e ulët e numrit të bizneseve tregon për nivelin e ulët ekonomik të këtyre komunave.

Këto të dhëna bëjnë që edhe shpërndarja e bizneseve për 1000 banorë, të jetë shumë dispropocionale. Bashkia Kukës si qendra e ZF ka rreth 46 biznese për 1000 banorë, ndërkohë që komunat Ujmisht dhe Grykë Çajë kanë në territorin e tyre vetëm 1 biznes për 1000 banorë, dhe këta krysisht biznese familjare. Numri i bizneseve është akoma shumë i ulët dhe situata e tyre është e keqe. Shumica kanë probleme financiare edhe me taksat duke mos pasur burime të mjaftueshme për investime të mëtejshme.

Struktura e ekonomisë së zonës funksionale reflektohet edhe në strukturën e eksport importit. Sic shihet nga tabela e mëposhtme, pjesën më të madhe të produkteve të importit në pesë vitet e fundit e zënë "produktet vegjetale" (29.8%) të ndjekura nga "metale bazë dhe artikujt prej tyre" (15.8%), dhe "produkte minerale" (15.5%). Pesha specifike e dy produkteve të fundit ka qenë relativisht e lartë në vitin 2013, përkatësisht 36% dhe 44.8%.

Tabela 6: Eksport-import sipas hyrjes në pikat doganore për zonën e Kukësit *ne 000 leke*

| | 2009 | | 2010 | | 2011 | | 2012 | | 2013 | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Import | Export | Import | Export | Import | Export | Import | Export | Import | Export |
| Kafshë të gjalla, produkte me origjinë kafshore | 62 | - | 79 | 3 | 21 | - | 16 | 4 | 8 | 9 |
| Produkte vegjetale | 742 | 97 | 1,357 | 217 | 1,161 | 360 | 1,486 | 408 | 1,639 | 486 |
| Yndyrna | 2 | - | 0 | 0 | 2 | - | 1 | 1 | - | 1 |
| Ushqime të përgatitura, pije alkolike, duhan | 208 | 8 | 313 | 33 | 376 | 17 | 512 | 16 | 494 | 22 |
| Produkte minerale | 555 | 236 | 19 | 1,148 | 195 | 2,392 | 157 | 4,051 | 21 | 3,589 |
| Produkte të industrisë kimike | 87 | 35 | 11 | 87 | 23 | 135 | 6 | 215 | 2 | 232 |
| Plastika, goma dhe artikujt e tyre | 66 | 9 | 156 | 11 | 478 | 18 | 352 | 56 | 144 | 56 |
| Lëkurët dhe artikujt prej tyre | 0 | 8 | 0 | 2 | - | - | - | 1 | - | - |
| Druri dhe artikuj prej druri | 10 | 12 | 13 | 8 | 18 | 12 | 12 | 2 | 3 | 2 |
| Letra dhe artikujt prej letre | 4 | 13 | 6 | 28 | 1 | 31 | 1 | 27 | - | 18 |
| Tekstile dhe artikuj tekstile | 8 | 1 | 12 | 1 | 3 | 2 | 3 | 2 | 1 | 4 |
| Veshjet e këmbëve | 1 | 0 | 0 | 1 | 0 | - | - | 0 | 0 | - |
| Artikuj prej guri, allcie, produkte qeramike, qelqi | 60 | 1 | 51 | 15 | 45 | 281 | 21 | 464 | 25 | 385 |
| Perla, gurë të cmuar, metale të cmuara etj | - | - | - | - | 0 | - | - | - | - | - |
| Metale bazë dhe artikujt prej tyre | 274 | 52 | 485 | 67 | 350 | 97 | 219 | 229 | 351 | 2,883 |
| Makineri e pajisje mekanike dhe elektrike | 85 | 711 | 112 | 214 | 406 | 100 | 1,470 | 912 | 207 | 129 |
| Mjetet e transportit | 169 | 82 | 138 | 101 | 624 | 192 | 435 | 433 | 413 | 10 |
| Instrumente optike, fotografike, muzikore etj | 16 | 2 | 3 | 9 | 1 | 4 | 0 | 54 | 11 | 13 |
| Artikuj të ndryshëm të prodhuar | 20 | 10 | 29 | 82 | 24 | 84 | 3 | 71 | 2 | 164 |
| | **2,368** | **1,276** | **2,785** | **2,027** | **3,731** | **3,726** | **4,693** | **6,948** | **3,319** | **8,002** |

*Burimi: INSTAT*

Eksporti dominohet nga "produkte minerale" (48%) dhe "makineri e pajisje mekanike dhe elektrike" (16%). Eksporti i produkteve minerale ka ardhur duke u rritur që nga viti 2008 me ritme shumë të larta në vitet e fundit (nga 4.9 herë:2009 në 15.2 herë:2013) ndërsa nivelin më të lartë e ka pasur në vitin 2012. Një rol të madh ka luajtur këtu eksporti i mineraleve në Kosovë për përpunim të mëtejshëm të tyre (shih seksionin për minierat më poshtë).

Sa i përket investimeve publike shpërndarja e tyre është jo e barabartë. Investimet më të larta janë kryer nga Bashkia Kukës në vlerën 51.000 mijë lekë, e ndjekur edhe nga Komuna Malzi, Kalis dhe Ujmisht. Ndërsa komunat e tjera paraqiten në nivel zero investime ose pothuajse zero. Ndryshe paraqitet situata nëse shohim investimet për frymë, vihet re që Komuna Kalis dhe Arrën shpërndajnë respektivisht 19.000 dhe 15.000 lekë/banorë, të ndjekura nga Komuna Ujmisht me 8.000 lekë/banor. Ndërsa Bashkia Kukës që ka nivelin më të lartë të investimeve në vlerë absolute renditet së bashku me Komunën Grykë Çajë, njësia e gjashtë vendore për sa i takon investimeve për frymë me 3.000 lekë për banor.

Kjo vjen si pasojë e mundësive të ndryshme të njësive vendore për të kryer investime me të ardhurat e tyre, por edhe nga skema e financimit të shpenzimeve kapitale të kryera nëpërmjet skemës së granteve konkurruese që në përgjithësi ka krijuar një pabarazi në shpërndarjen e tyre. Fokusi i investimeve ka qenë kryesisht në infrastrukturën lokale, ndërkohë që investimet në fushën e zhvillimit ekonomik vendor pothuajse mungojnë. Moskryerja e investimeve nga njësitë vendore, në fushën e zhvillimit ekonomik vendor ka sjellë një efekt negativ në zhvillimin e bizneseve, duke mos i mbështetur dhe duke mos i krijuar atyre kushtet e përshtatshme për zhvillimin e tyre.

Edhe pse aktualisht ekonomia e zonës është disi e pazhvilluar, mundësitë, pozicionimi gjeografik në një pikë të favorshme në kufi me Malin e Zi, Kosovën e Maqedoninë, aksesi i shpejtë në tregjet e afërta kufitare të Kosovës (Prizren, Gjakovë, Dragash), apo Mal të Zi, (Berane, etj) bën që ajo të mbetet qendra e bashkëpunimit, institucioneve e shkëmbimeve. Zhvillimi i autostradës Durrës-Morinë ka rritur rëndësine e këtij rajoni, përfshirë lidhjen e drejtpërdrejtë me Kosovën dhe tregjet nga vendet e tjera fqinje.

### 3.1.2 Tregu i Punës dhe Struktura e tij

Si rezultat i mbylljes se minierave, uzinës dhe të shumë ndërmarrjeve ekonomike që trajtonin një numër të madh punëtorësh pas viteve 90', papunësia është shumë e madhe në krahasim me rajonet e tjera të Shqipërisë. Pjesa më e madhe e popullsisë është e punësuar në sektorin e shërbimeve, (57.3%) ndërsa rreth 33% në sektorin e bujqësisë dhe vetëm 9.5% në sektorin e industrisë. Ndërsa në nivel njësie vendore kjo strukturë ndryshon çka lidhet edhe me vendndodhjen e minierave në këtë zonë. Punësimi në sektorin e bujqësisë dominon në komunat Arren, Shishtavec dhe Topojan.

Grafiku 6: Punësimi sipas Sektorëve të ekonomisë




Burimi: INSTAT

Grafiku 7: Statusi i Punësimit




Ekziston një lidhje e drejtë ndërmjet sektorëve të punësimit dhe statusit të punësimit. 51.6% e personave që punojnë janë të punësuar, ndërsa mesatarisht 48.4% janë të vetë-punësuar ose punojnë në bizneset familjare, ndërkohë që statusi i punësimit është i ndryshëm nga njësia në njësi, sic shihet edhe nga grafiku 7 më lartë. Punësimi zë një peshë më të madhe specifike në

bashkinë e Kukësit, komunat Kolsh, Ujëmisht dhe Zapod. Ndërsa vetëpunësimi ose punësimi në ekonomitë familjare është më i shpeshtë në komunat Arren, Shishtavec dhe Bushtricë. Pjesa më e madhe e të punësuarve (61%) punojnë më kohë të pjesëshme, çka lidhet edhe me natyrën rurale të zonës edhe me aktivitetin bujqesor, dhe vetëm 33.2% punojnë me kohë të plotë.

Grafiku 8: Shkalla e papunësisë sipas NjQV




*Burimi: INSTAT*

Pjesa më e madhe e të punësuarve janë me shkollë tetëvjeçare dhe të mesme të përgjithshme (48%), 35.4% me shkollë të mesme profesionale dhe vetëm 14.8% me shkollë të lartë. Një pjesë e konsiderueshme e banorëve të komunave janë të punësuar në qytetin e Kukësit, por edhe në komuna të tjera afër vendbanimeve të tyre.

Niveli i papunësisë është i lartë. Të dhënat e Censusit 2011 nxorën një nivel papunësie në masën 50% të forcave të afta për punë. Niveli më i lartë i papunësisë është regjistruar ndërmjet të rinjve 65.9%, ndjekur nga papunësia ndërmjet grave në masën 51.5%, ndërsa ndërmjet meshkujve arrin në masën 50.1%.

Bashkia e Kukësit ka një normë të lartë papunësie. Mbi 35 % e popullësisë së aftë për punë është e papunë. Të ardhurat mesatare mujore janë mjaft të ulta për shkak se shumë familje jetojnë me ndihmë ekonomike. Shumica e familjeve jetojnë me rroga nga sektori publik që ka një mesatare prej 19.000 lekësh. Duke qenë se niveli jetik është mesatarisht i njëjtë me të ardhurat mesatare për familje, kuptohet që shumica e familjeve jetojnë nën nivelin jetik dhe niveli i të ardhurave është i pamjaftueshëm për të përballuar një jetesë normale.

Grafiku 9: Shkalla e popullsisë e trajtuar me ndihmë sociale




*Burimi: Qarku i Kukësit*

Një nga tiparet shoqëruese të nivelit të varfërisë është niveli i trajtimit të popullsisë më ndihmë ekonomike. Në shkallë të ZF 43.3% e popullsisë trajtohet me ndihme ekonomike, ndërsa siç mund të shihet nga grafiku 9, komunat ku ky nivel është tepër i ndjeshëm janë Kolsh (69.8%), Ujmisht (66.4%) dhe Tërthorë (64.3%).

Kështu, bazuar në analizën e mësipërme, ajo që vërehet e që do të nxisë zvillimin ekonomik të ZF të Kukësit lidhet dhe me zhvillimin e bujqësisë, turizmit e minierave që në totalin e tyre do të sjellin rritje të punësimit, e të cilësisë së ofrimit të shërbimeve me qëllim përafrimin e standardeve me ato europiane.

Bujqësia mbetet ndër sektorët më të rëndësishëm ekonomikë që ofron rreth 33% të të gjithë të vlerës së shtuar bruto për rajonin e kryesisht për Zonën Funksionale, duke siguruar edhe nivelin më të lartë të punësimit. Duhet konsideruar faktin se shumica e popullsisë jeton në zona rurale e të ardhurat e tyre gjenerohen kryesisht nga aktivitetet bujqësore dhe potencialet në këtë sektor nuk janë të shfrytëzuara në mënyrën e duhur. Në përgjithësi ekonomia rurale është e fragmentuar dhe ndërmarrjet e vogla bujqësore e sipërmarrjet kanë vështirësi që të aksesojnë tregjet e mëdha kombëtare apo dhe rajonale. Në këtë kuadër, përmirësimi i aksesit në tregje e forcimi i cilësisë së ofrimit të produkteve do të krijojë mundësi për të rritur konkurueshmërinë e sektorit të bujqësisë jo vetëm brenda vendit por edhe jashtë tij. Vlen këtu të përmenden traditat e bashkëpunimit tregtar e shkëmbimit të produkteve me Kosovën, Malin e Zi si një hap i rëndësishëm në këtë kuadër.

Turizmi (përfshirë turizmin kulturor e historik, atë rural,natyror, liqenor e agro-turizmin) është një potencial gjithashtu për zhvillimin ekonomik të ZF, i cili është reflektuar gjerësisht edhe në nivel institucional – si, në strategjinë e rajonit e planin e zhvillimit të Bashkisë. Bukuritë natyrore të ZF e traditat kulturore e historike të zonës ofrojnë mundësi të shumta të cilat duhet të promovohen. Kjo Zonë ka asete të mjaftueshme për të tërhequr turistët, veçanërisht burimet e jashtëzakonshme natyrore në majat e maleve, kullotat alpine, luginat e thella, si dhe liqenet dhe lumenjtë spektakolarë.

Minierat si sektor i tretë i rëndësishëm i identifikuar ofron gjithashtu një potencial i cili duhet shfrytëzuar për të patur një rritje të punësimit e të tregtisë sa i përket këtij sektori. Ky sektor i tretë mbetet më sfidues sa i përket zhvillimit të projekteve poteciale, por ka vlerë të analizohet – sic do shihet edhe në kapitujt e mëposhtëm – pasi mbetet ende i pashfrytëzuar sipas kapaciteteve që ofron. Investimet në këtë sektor kryesisht varen nga politikat kombëtare – marrëveshjet e koncesionit e investimet private, por megjithatë një plan më i detajuar i ndërthurrjes së politikave në këtë sektor me ato në nivel lokal ka nevojë që të elaborohet.

# 4. ANALIZË E THELLUAR E EKONOMISË SË ZONËS FUNKSIONALE

## *4.1 Analiza e sektorëve kryesorë të ekonomisë*

### *4.1.1 Sektori i Bujqësisë*

#### *4.1.1.1 Aktiviteti Bujqësor*

Siç u përmend edhe më lartë, Bujqësia mbetet sektori që siguron nivelin më të madh të të ardhurave dhe sektori kryesor i punësimit në ZF Kukësit. Kjo zonë njihet për zhvillimin e bujqësisë dhe sidomos blegtorisë falë një klime mjaft të përshtatshme për zhvillimin e saj. Klima dhe terrreni gjeografik janë faktorët kryesorë që garantojnë zhvillimin e bujqësisë. Bujqësia zë një vend shumë të rëndësishëm në zhvillimin e tregut të brendshëm, ku operojnë një numër i madh tregtarësh me prodhimin vendas.

Terreni malor i zonës ndikon dhe në strukturën e tokës, ku pyjet zënë rreth 62% të

Harta 9: Shpërndarja e tokës bujqësore




*Burimi: Drejtoria e Bujqësisë, Qarku Kukës*

territorit të zonës, ndërsa toka bujqësore zë vetëm 16% (11374.2 ha) të territorit të zonës, një përqindje e vogël krahasuar me mesataren në shkallë vendi (24%)[14] të tokës bujqësore. Në Komuna si Shishtaveci rreth 43.8% e të gjithë territorit përbëhet nga pyjet, tokat pyjore dhe djerrinat. Në Tërthore pyjet dhe kullotat zënë një sipërfaqe të konsiderueshme, ato kanë një peshë të konsiderueshme dhe paraqesin një rëndësi industriale pasi shfrytëzimi i tyre mund të bëhet edhe për interesa jo vetëm të komunave, por edhe të mbarë qarkut e më gjerë. Topojani

[14] INSTAT Statisitikat e Bujqësisë 2012

dallohet me një pasuri natyrore. Pyjet përbëjnë pasurinë natyrore një nga më kryesoret. Llojet e drurëve janë, ha, pishë, mështekën, shkozë, rraboll etj.[15]

Duhet thënë që në rang qarku, ZFK zë 45% të tokës bujqësore, duke bërë që kjo zonë ta këtë bujqësinë një potencial më të madh krahasuar me dy zonat e tjera.

Shishtavec (17%) dhe Bicaj (9) kanë sipërfaqen më të madhe të tokës bujqësore, në rang të ZF, ndërsa Arren (2%) dhe Surroj (3%) janë komunat ku sipërfaqja e tokës bujqësore është shumë e vogël. E diktuar nga kjo strukturë toke, pjesa e tokës e shfrytëzueshme për bujqësi përbëhet në një mase të madhe nga kullotat 56% (16,991 ha), ndërsa toka arë zë vetëm 34% (9,963ha). Ndërsa sipërfaqet e mbjella me vreshta dhe pemtoret zënë një përqindje shumë të vogël (3% dhe 4%).

Ndër bimët e arave pjesa më dërrmuese e sipërfaqes së mbjellë dominohet nga foragjeret, (Tabela 7) e ndjekur nga drithrat. Kurse në aspektin e prodhimtarisë, patatja dhe perimet zënë peshën më të madhe të prodhimeve bujqësore në këtë zonë.

Kryesisht patatja është një nga kulturat më të kultivuara në zonë ku banorët sigurojnë një pjesë të të ardhurave (përfshirë edhe thekra). Në zonën e Shishtavecit banorët kanë traditë të hershme në kultivimin e saj, pasi kushtet klimatike -tokësore janë mjaft të favorshme. Në këtë zonë mbillen sipërfaqe relativisht të mëdha dhe rendimentet e patates janë të kënaqshme, ndonëse banorët e komunës kanë hasur mjaft vështirësi në nxjerrjen në treg të kësaj kulture për shkak të superprodhimit dhe taksave të ulëtë të importit për këtë kulturë. Infrastruktura e dobët si dhe futja e kësaj kulture nga vende të tjera fqinje e ka bërë më pak konkurruese në tregun lokal, pasi kjo kulturë del në treg me koste më të lartë se sa ajo e importit, megjithëse mbetet një ndër prodhimet bio të Shqipërisë. Po kështu edhë në Topojan, vihet re se në këtë komunë rendimentet e patates janë të kënaqshme, ndonëse banorët e komunës kanë hasur mjaft vështirësi në nxjerrjen në treg të kësaj kulture. Edhe në Bicaj ka një rendiment mjaft të lartë të patates. Infrastruktura e dobët, si dhe futja e kësaj kulture nga vende të tjera fqinje e ka bërë më pak konkurruese në tregun lokal, pasi kjo kulturë del në treg me koste më të lartë se sa ajo e importit. Megjithatë, patatja e Kukësit është mjaft e pëlqyer për cilësinë e saj dhe së bashku me gështenjat përbëjnë dy nga produktet më tipike të zonës të cilat furnizojnë jo vetëm tregun lokal, por tregëtohen edhe në tregun kombëtar apo në Kosovë, dhe së fundi gështenja edhe në vendet europiane. ZFK zë vendin e gjashtë në republikë për prodhimin e patates[16].

*Tabela 7: Tendenca e Mbjelljeve dhe Prodhimi i Bimëve të Arave*

| | 2009 | 2010 | 2011 | 2012 | 2013 |
|---|---|---|---|---|---|
| Siperfaqe e mbjelle ha | | | | | |
| Fasule | 120 | 174 | 175 | 178 | 178 |
| Foragjere | 5,889 | 6,211 | 5,976 | 5,878 | 5,989 |
| Grure | 1,850 | 1,176 | 1,201 | 1,545 | 1,390 |
| Miser | 2,792 | 3,280 | 2,980 | 2,921 | 3,076 |
| Patate | 525 | 556 | 696 | 564 | 595 |
| Perime | 617 | 635 | 669 | 647 | 666 |
| Tagjira | 389 | 172 | 216 | 276 | 289 |
| Theker | 396 | 430 | 442 | 505 | 428 |
| **Prodhimi ne ton** | | | | | |
| Fasule | 640 | 732 | 481 | 250 | 278 |
| Grure | 8,107 | 5,721 | 4,779 | 6,334 | 5,416 |
| Miser | 12,944 | 18,287 | 14,720 | 13,773 | 15,177 |
| Patate | 12,331 | 12,235 | 15,134 | 11,038 | 13,500 |
| Perime | 10,948 | 12,408 | 13,019 | 13,202 | 13,781 |
| Theker | 947 | 960 | 1,062 | 1,352 | 1,062 |

*Burimi: Këshilli i Qarkut Kukës*

[15] Plani i Zhvillimit Shishtavec, Tërthorë, Topojan, 2012

[16] Krahasimi me 36 rrethet e vendit

Prodhimi i bimëve të arave në krahasim me rrethet e tjera të qarkut të Kukësit (Has, Tropojë) është në nivele më të larta, gati dyfish më shumë të prodhimit të patates, perimeve, drithërave, thekrës, etj. Ka zona për shembull që relievi është mjaft i favorshëm për kultivimin e bimës së arës si në Komunën e Tërthorës ku toka gëlqerore mundëson rritjen e misrit, fasules e grurit. Po kështu edhe në Bicaj, kulturat kryesore janë gruri dhe misri që në total shkojnë mbi 250 ha, 20 ha me perime, ndërsa pjesa tjetër, mbi 100 ha mbillet me foragjere (kryesisht jonxhe). Prodhimi mesatar varion 30 kv/ha grurë dhe 40 kv/ha miseë (në tokat që vaditet).

Në lidhje me gjendjen e pemëtarisë, situata tregon për një trend pozitiv. Në vitin 2013 regjistroheshin pemë frutore 857 mijë rrënjë, vreshta 88 mijë rrënjë dhe 344 mijë rrënjë. Numri i tyre dhe prodhimtaria ka ardhur duke u rritur vit pas viti ku rritjen më të madhe e kanë pasur vreshtat me 8% në vit, pemët frutore 6%, dhe pjergullat me 3% në vit. Si rezultat i rritjes së numrit të vreshtave prodhimi ka pësuar një rritje me ritme mesatare vjetore 12%. Pemtaria është edhe dega që sjell burimin më të madh të të ardhurave, rreth 55%[17] për fermerët.

Sic shihet nga harta e mëposhtëme, pemët frutore rriten pothuajse në gjithë territorin e ZFK, por zonat ku përqëndrimi i tyre është më i madh janë Bicaj (20%), Shtiqen (16%) dhe Ujmisht (14%). Malzi, dallohet për rritjen e gështenjës. Zonat e Ujmsht (19%) dhe Shtiqen (18%) janë komunat ku prodhohet edhe sasia më e madhe e arrave, të ndjekur nga Bicaj (15%). Bicaj dhe Kukës dallohen si zona ku vreshtaria është më e zhvilluar.

Në ZFK ushtrojne aktivitetin dy firma per prodhimin e pijeve alkolike kryesisht, të cilat përdorin si lëndë bazë produktet e zonës si kumbullat, rrushin, manaferren, etj. Këto dy firma janë të pozicionuara në Bashkinë e Kukësit dhe sherbejnë edhe si pika ngrumbullimi e përpunimi të frutave të rritura në ZFK.

Përmbledhje skematike e Avantazheve dhe Problematikes që has sektori i Bujqësisë jepet në figurën e mëposhtëme.

**Figura 2: Avantazhet dhe Problematika e Sektorit të Bujqësisë[18]**




[17] Shih: INSAT "Statistikat e Bujqësisë 2012"

[18] Kutite nengjyre te kuqe paraqesin avantazhet, me ngjyre gri problematiken direkte dhe me ngjyre lejla elementet pengues ne cilesine dhe eficencen e prodhimit bujqesor.

Ashtu si në të gjithë vendin, zhvillimi i bujqësisë dhe performanca ekonomike e sektorit të bujqësisë edhe në ZF të Kukësit ndikohet nga disa faktorë ku më kryesorët janë:

- ***Madhësia e vogël e fermave***: në masë të madhe dominohen nga fermat e vogla dhe të fragmentuara dhe produktiviteti në përgjithësi.[19] Nëse bëjmë krahasim në nivel kombëtar, madhësia e fermave në 2012 ishte 4.8[20] ha dhe ka pasur ndryshime tepër të vogla krahasuar nga viti 2000 deri në 2012, me një rritje rreth 0.20 ha. Për sa i përket organizimit të fermave, ato janë të organizuara sipas fushës së prodhimtarisë si Grupi i Patatës (Shishtavec), Grupi i Pemtarisë (Malzi), Grupi i Domateve dhe i Pemëtarisë, Grupi i Bimëve arave (Bicaj), Grupi i Vreshtarisë (Bashkia Kukës), Grupi Vresh-Perime (Tërthorë), Grupi i Patates (Topojan)[21].
- ***Niveli i ulët i mekanikës dhe teknologjisë bujqësore***: siç paraqitet edhe nga tabelat 9 më poshtë, mekanika bujqësore mbetet e kufizuar si në numër dhe në larminë e saj. Për shkak të terrenit në zonat malore toka punohet me kafshë ose me krah[22]. Për shembull, në Komunën e Shishtavecit toka bujqësore punohet me mjete primitive si parmendë dhe me krahë. Nga ana tjetër, ka terrene të vështira si në zonën e Topojanit, ku relievi shumë i pjerrët nuk lejon mundësinë e sistemimit të mekanizmit.

*Tabela 8: Kapacitete Ujitëse*

| Rezervuari | Viti Ndertimit | Aftesia Ujitese ne Ha | Toka nen Uje Ha | Kapaciteti m3 |
|---|---|---|---|---|
| BARDHOC 1 | 1967 | 7 | 7 | 25,000 |
| BARDHOC 2 | 1967 | 5 | 5 | 16,000 |
| FUSHE DUKAGJIN | 1980 | 86 | | 300,000 |
| SHISHTAVEC - NO' | 1985 | 230 | 552 | 610,000 |
| POBREG | 1975 | 37 | 40 | 130,000 |
| VOREN BUSHTRIC | 1970 | 50 | 50 | 156,000 |
| SHTANE | 1982 | 32 | 94 | 112,000 |
| **Total** | | **447** | **748** | **1,349,000** |

*Burimi: Këshilli i Qarkut Kukës*

*Tabela 9: Mekanika Bujqësore*

| Lloji | 2011 | 2012 | 2013 |
|---|---|---|---|
| Traktore me rrota | 81 | 95 | 96 |
| Traktore me zinxhir | 5 | 5 | 6 |
| Minitraktore | 100 | 111 | 114 |
| Makina Mbjellese | 84 | 91 | 104 |
| Motokorrese | 13 | 16 | 19 |
| Autokombajna | 10 | 10 | 14 |
| Freza | 42 | 52 | 56 |

- ***Kapacitetet vaditëse***: edhe pse kjo zonë është e njohur për kapacitetet e saj të mëdha hidrike, vaditja është një problem për zhvillimin e prodhimit bujqësor. Tabela 8 më poshtë konfirmon mungesën e investimeve në këtë drejtim. Nga viti 1982 në këtë zonë nuk ka pasur asnjë investim në drejtim të shtimit të rezervuarëve. Ky fakt konfirmohet edhe në planet e zhvillimit të disa komunave. 23 Nga të dhënat del se vetëm 7% e tokës bujqësore mund të vaditen nga rezervuaret aktuale. Për shembull, në Komunën e Shishtavecit ndonëse kapacitetet ujore janë të pranishme në zonë, sistemi i vaditjes nuk funksionon dhe del si prioritet rikonstruksioni dhe ndërtimi i kanaleve ujitës. Kanalet vaditëse në Shishtavec dhe Borje janë plotësisht të dëmtuara megjithëse ato kanë funksionuar gjatë sistemit komunist.
- ***Pronësia dhe regjistrimi i tokës***: aplikimi i tatimit mbi tokën ka rritur hezitimin e fshatarëve të plotësojnë dokumentacionin e pronësisë së tokës. Gjithashtu marrja e ndihmës ekonomike ka qenë një nga faktorët e mos plotësimit të dokumentacionit të pronësisë.
- ***Përdorimi i farave të zgjedhura*** që rrisin produktivitetin e prodhimeve bujqësore ka qenë i kufizuar, për shkak të kapaciteteve financiare.

---

[19] Shih Strategjia Ndërsektoriale e Zhvillimit Rural e Bujqësor 2014-2020 (fq 8488 - Fletorja Zyrtare 169/2014)
[20] Shih: INSAT "Statistikat e Bujqësisë 2012".
[21] http://ëëë.agro.al/fileadmin/user_upload/diragr/Materiale_per_sherbimin_keshillimor/.pdf)
[22] Shih: INSAT "Statistikat e Bujqësisë 2012".
[23] Shih Plani i Zhvillimit Komuna Bicaj, (fq 44) Plani i Zhvillimit Komuna Tërthorë.

- ***Kostoja e lartë e shpenzimeve të transportit:*** Kukësi zinte vendin e katërt në vend lidhur me % që zinte kostoja e transportit (12%)[24] e produkteve bujqësore.
- Kjo sjell në vëmendje domosdoshmërinë për ngritjen ***e pikave të grumbullimit*** në disa qendra të zonës funksionale, duke siguruar dhe kushte optimale ruajtjeje. Kjo do të reduktonte koston e prodhimeve, ruante cilësinë dhe ndikonte në uljen e çimimeve të shitjes. Aktualisht ekziston vetëm 1 pika e grumbullimit të prodhimeve bujqësore (dhoma frigoriferike per ruatjen e frutave dhe perimeve)e cila ndodhet në Tregun e Fruta-perimeve pranë Bashkisë Kukes me kapacitet 30-40m3. Ngritja e pikave të tjera të grumbullimit të prodhimeve bujqësore në zonat të tjera të ZFK duhet të bëhet duke marrë parasysh përqëndrimin e prodhimtarisë bujqësore në zona të ndryshmë, por dhe shpërndarjen gjografike për të siguruar një akses të ekuilibruar fizik të fermerëve nga pikat e grumbullimit.
- Sfida në sektorin e bujqësisë e blegtorisë është edhe ***siguria ushqimore e ofrimi i standardeve të duhura për konsumatorin.*** Kjo zonë po ndihmohet nga projekte të ndryshme të IPARD, GIZ, të cilat do të ndikojnë në përmirësimin e situatës në këtë drejtim.

### *4.1.1.2 Aktiviteti Blegtoral*

Blegtoria është një nga burimet kryesore të të ardhurave për disa nga komunat që bëjnë pjesë në ZF. ZF e Kukësit është e pasur me bagëti të trasha e të imta, si dhe shpendë e bletë. Pjesën më të madhe e zënë të imtat, (76% numrit të kafshëve), brenda të cilit delet zënë përqindjen më të madhe (59%).

Grafiku 13: Struktura e blegtorisë




*Burimi: Këshilli i Qarkut Kukës*

Bletaria është sektori i cili ka pësuar rritjen më të madhe kohët e fundit (grafiku 13), me një rritje mesatare vjetore prej 4% në pesë vitet e fundit, ose me një numër total prej 800 kosheresh. Nëse garantohet siguria ushqimore dhe ruhen elementet e brand-it, të qenurit produkt lokal dhe "bio" , kjo veprimtari mund të jetë një mundësi shumë e mirë për gjenerimin e të ardhurave.

Blegtoria është e shtrirë në të gjithë zonën, me dominim më të madh të kafshëve të imta (dele, dhi). Por përqëndrimi më i madh i saj është në zonat e Shishtavecit dhe Bicajt, ku numri i krereve të imta, gjedhëve është më i madh, për të gjitha llojet e tyre, ndjekur nga Grykë Cajë e Bushtricë për numrin e të imtave dhe Topojan për njëthundrakët.

Për shembull, blegtoria në Komunën e Shishtavecit është pjesë e rëndëshme e ekonomisë së zonës pasi siguron një pjesë të konsiderueshme të të ardhurave. Këto të ardhura fermeri i siguron nga mishi, ndërsa produktet e nënproduktet e tjera përdoren kryesisht për përdorim familjar dhe nuk tregtohen në treg.

[24] INSTAT Statistikat e Bujqësisë 2012".

Në këtë zonë banorët kryesisht mbarështojnë gjedh, të leshta dhe të dhirta. Gjedhi mbarështohet në numër të vogël në nivel komunë. Banorët e mbarështojnë në numër të vogël vetëm për nevojat familjare.

Harta 10: Zhvillimi i Blegtorisë sipas NjQV




Gjedhi në këtë zonë mbarështohet lehtë me kullotje natyrore gjatë periudhës së pranverës, verës dhe vjeshtës, kurse në dimër me regjim stallor. Familjet grumbullojnë rezerva dimërore për mbarështim. Dhentë përdoren kryesisht për prodhim mishi, kryesisht për treg lokal në Kukës, kurse qumështi dhe leshi për përdorim familjar, shumë pak tregtohet ose aspak. Raca më përhapur në zonë është tipi i deles “Rude”.

Në Topojan, blegtoria është dega më e rëndësishme e bujqësisë, pasi ajo mbulon pjesën më të madhe të ardhurave. Me një tipologji të ngjashme me atë të Shishtavecit (gjedh, dhi, delja “Rudë”), infrastruktura e dobët rrugore nuk bën të mundur arritjen e tregut për shitjen e qumshtit dhe nënprodukteve të tij.

Në zonën e Tërthorës për shembull përsa i përket mbarështrimit të blegtorisë kjo ka specifikat e veta për secilin fshat, ku mund të përmendim në funksion të terrenit përshkues në ato me terren të pjerrët e kushte për kullotë, trajtohet dhia, delja, e në vende të tjera mbarështrohet lopa e vendit. Tufat e imta variojnë nga 20-50 krerë e mesatarisht 30 krerë për frymë.

Vlen të përmendet zona e Bicaj ku blegtoria është sektori i vetëm që ka njohur vetëm rritje këto 20 vitet e fundit (Është rritur dyfish numri i gjedhëve dhe është trefishuar numri i të imtave).

Të dhënat e mëposhtme japin sasinë e prodhimeve bujqësore të prodhuara ne vitin 2012, dhe peshën specifike të prodhimit që realizon zona e Kukësit kundrejt gjithë qarkut, apo në total në shkallë vendi. [25]

Tabela 8 : Prodhimi i produkteve blegtorale në vitin 2012

| | Totali/ ton | Gjedhe | Te imta | Shpende | Veze kokra | Lesh | Mjalte |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Kukes | **3,723** | **2,247** | **1,409** | **67** | 4,781 | 75 | 45 |
| Total Qarku | 7,620 | 5,155 | 2,130 | 185 | 13,971 | 132 | 129 |
| Total Vendi | 149,977 | 69,035 | 47,654 | 16,245 | 886,930 | 3,296 | 3,296 |
| Ne peshe specifike | | | | | | | |
| Kukes/Qarkut | 49% | 44% | 66% | 36% | 34.2% | 56.8% | 34.9% |
| Kuke//Vendi | 2% | 3% | 3% | 0% | 0.5% | 2.3% | 1.4% |

Përmbledhje skematike e Avantazheve dhe Problematikes që has sektori i blegtorisë figurën e mëposhtëme

**Figura 3: Avantazhet dhe Problematika e Sektorit të Blegtorisë[26]**




Duke qenë një sektor vital për ekonominë e zonës bujqësia haset me disa sfida të cilat duhet të adresohen sa më parë. Këto sfida në mënyrë të përmbledhur mund t'i japim më poshtë:

- ***Rendimenti i prodhimit:*** siç jepet edhe nga tabela më poshtë, nivelet e rendimenteve të prodhimeve blegtorale janë të ulta krahasuar me mesataren e qarkut për prodhimet kryesore, (veç qumshtit të lopës), dhe tepër të ulta krahasuar me mesataren në rang vendi[27].

Tabela 9: Rendimeneti mesatar i produkteve kryesore në vitin 2012

| | Qumesht Lope kg/cope | Qumesht dele kg/cope | Qumesht dhije kg/cope | Veze kokrra/cope | Lesh kg/cope | Mjalte kg/koshere |
|---|---|---|---|---|---|---|
| ZF Kukes | 1901 | 50 | 90 | 109 | 2 | 7 |
| Kukes | 1734 | 62 | 106 | 119 | 2 | 8 |
| vendi | 2684 | 60 | 114 | 181 | 2 | 13 |
| Rendimenti kundrejt | | | | | | |
| Mesatares se Qarkut | 10% | -19% | -15% | -8% | 0% | -13% |
| Mesatares se Vendit | -29% | -17% | -21% | -40% | 0% | -46% |

- ***Shërbimet veterinare:*** shërbimet veterinare në pjesën më të mirë ofrohen në qendrën e zonës në Kukës dhe në disa komuna, ndërsa komuna të tjera, krysisht të largëtat, aksesin në këto shërbime e kanë më të vështirë.

[26] Kutite nengjyre te kuqe paraqesin avantazhet, me ngjyre gri problematiken direkte dhe me ngjyre lejla elementet pengues ne cilesine dhe eficencen e prodhimit bujqesor.

27 Në strukturën racore të gjedhit mbizotëron raca e vendit "Gjersej" e cila rezulton me prodhimtari të ulët , dhe ndërkohë nuk janë bërë hapa për përmirësimin racor. Ndërsa tek të imtat mbizotëron raca "Rude" e cila është një burim gjenetik i pashtershëm, por jo i shfrytëzuar plotësisht.

- ***Mangësitë në grumbullimin dhe përpunimin e produkteve blegtorale:*** Prodhimet blegtorale prodhohen nga ferma të vogla, që i përkasin ekonomive familjare. Organizimi i grumbullimit të qumështit dhe produkteve blegtorale është pika më e dobët e zinxhirit të vlerës së këtyre produkteve. Nga intervistat e kryera si dhe analizat e dertanishme, grumbullimi, përpunimi dhe tregëtimi janë disa nga problemët e fermerëve të zonës.
- ***Ofrimi i shërbimeve këshillimore për fermerët.***
- ***Siguria ushqimore:*** ngritja e pikave të grumbullimit me kushte të përshtatshme konservimi dhe ruajtjeje, organizimi i shitjeve në tregje të kontrolluara nga pikëpamja higjeno sanitare janë ndër problemet e shumta që hasin fermerët në këtë zonë.
- ***Mungesa e zinxhirit të duhur grumbullues dhe përpunues:*** Në ZFK gjëndën vetëm 4 qendra të perpunimit të qumshit 2 në Komunën Surroj (Fshati Cinamak dhe Fshati Fush), 1 në Komunën Shishtavac (Fshati Novosej dhe 1 në Komunën Gryk-Caje. Ndërkohë në zona të tilla si Bicaj, Shtiqen edhe pse në nivel të ZF kanë një nivel të rëndësishëm të prodhimeve blegtorale, nuk ndodhen qëndra të grumbullimit e përpunimit të qumshtit.

### *4.1.1.3 Bimët Aromatike dhe Medicinale dhe (BMA)*

Zona e Kukësit ka potenciale shumë të mëdha përsa i përket bimëve medicinale, pasi është mjaft e pasur me këto burime. Një bimë tipike medicinale e Zonës është sherebela, e cila kultivohet nga mbi 10.000 familje në Zonën e Kukësit. Për më tepër se një vit ama, ky produkt nuk gjen mjaftueshëm treg për të sjellë fitime tek kultivuesit e saj. Ashtu si sherebela, janë rreth 124 bimë medicinale që rriten në Zonë, për të cilat ama mungon drejtimi teknik dhe duhen bërë studime toke për të nxitur kultivimin e tyre dhe rritur përfitimet[28].

Grafiku 14: Zonat e grumbullimit të bimëve medicinale




*Burimi: Këshilli i Qarkut Kukës*

Bimët medicinale që rriten në këtë zonë janë Boronica (Vacinium Myrtyllus), Trumza ( Saturea mantana), Dëllinja e zezë (Juniperus comunis), Dëllinja e kuqe(Juniperus Sabina), Agulicja (Primula grandiflora), Shqema ( Cermodell), Lulekuqja (Papaver rhoas), Trëndafili i egër (Rosa canina), Sherebela (Salvia officinalis), Shpatore (Tiris germanica), Luleshtrydha ( Fragaria vesca), Kamomili (Matricaria chamomile), Hithra (Urtica dioica), Manaferra (Robus friticosa), Mështenka.

Në disa ish kooperativa si në Arren, Shemri (Malzi), Surroj kanë qenë të ngritura impiante distilimi të gjetheve të pishës dhe rrëshirës, për prodhimin e esencave. Aktualisht bimët mblidhen kryesisht nga banorë të fshatrave në territoret e të cilëve ato ndodhen dhe pastaj

[28] Bazuar në diskutimet gjatë Takimit Konsultativ me Forumin e Zonës Funksionale të Kukësit, 25 nëntor 2014.

grumbullohen nga tregtarë lokalë apo të tjerë që jo të gjithë janë të licensuar. Fermerët lokalë nuk i kultivojnë këto bimë por thjesht i mbledhin në natyrë[29].

Gjithashtu në vende si Shishtaveci ku mjedisi i kësaj zone është mjaft i larmishëm, rriten në formë natyrale bimë medicinale si, shkem, qershizë. Disa banorë gjatë stinës së verës angazhohen në mbledhjen e qershizë, të cilën e shesin në tregun lokal. Kjo shërben për të rritur të ardhurat e tyre familjare. Numër i banorëve që merren me mbledhjen e qershizës së egër është i vogël. [30]

Tërthora gjithashtu ka potenciale për rritjen e bimëve mjeksore që shërbejnë në industrinë farmaceutike si boronica, sherebela, sanza, trumza, lule manushaqja, lule shtogu, kokërr shtogu, mollë të egra, etj. Grumbullimi i tyre bëhet spontanisht dhe nuk ka ende ndonjë organizim të vecantë për mbledhjen e tyre. [31]

Në komunën Topojan në formë natyrale rriten bimë medicionale si, shkem, qershizë. Disa banorë gjatë stinës së verës angazhohen në mbledhjen e qershizë, të cilën e shesin në tregun lokal. [32]

Komuna Bicaj njihet për shembull për rritjen e boronicës specifikisht, lule basani, sherebela, shkemi.[33]

Edhe pse bimët medicinale përbëjnë një sektor shumë të rendësishëm për sigurimin e të ardhurave për shumë familje, në ZFK eksistojnë vetëm 2 pika grumbullimi te Bimve Medicinale, një në Parkun i Ri dhe tjetra në Zonën Industriale. Të dija pikat e grumbullimit ndodhen në Bashkine e Kukesit. Përqëndrimi i pikave të grumbullimit vetëm në bashkinë e Kukësit, bën që kostoja e transportit të tyre nga pika të ndryshmë të mbledhjes deri në pikat e grumbullimit të jetë e larte.

Megjithë vështirësitë në tregtimin e bimëve medicinale, ka potenciale që këto prodhime të jenë konkuruese jo vetëm në tregun lokal por edhe atë rajonal e ndërkufitar.

### *4.1.2 Peshkimi*

Peshkimi përbën një potencial mjaftë të rëndësishëm për zhvillimin ekonomik të Zonës Funksionale. Liqeni i Fierzës, përbën një mundësi të madhe për për kultivimin e peshkimit me rreth 5000 ha sipërfaqe ujore (pra mbi 70%). Peshkimi në Liqenin e Fierzës, përbën një veprimtari të rëndësishme për gjithë zonën. Ujrat janë tipike për kultivimin natyrorë të popullatave peshkore që në këtë zonë marrin një zhvillim vërtetë të dukshëm. Që nga formimi, struktura peshkore u tjetërsua me lloje peshqish liqenorë, e shoqëruar me largimin e llojeve të ujërave të rrjedhshëm që më parë popullonin lumin Drin, si trofta, ngjala dhe gjetën mjedis të përshtatshëm shumimi dhe ushqimi, peshq si ballëgjeri i bardhë dhe ai larosh, krapi, luçiperka, karasi dhe gjuhca (cironka), sharmaku. Sot në Fierzë rriten rreth 13 lloje peshqish përfshirë edhe rritjen e midhjeve të vogla të ujërave të ëmbla. Vlen të përmendet se ndër gjitarët ujorë me

[29] Strategjia Rajonale, Kukës, 2012
[30] Plani i Zhvillimit Komuna Shishtavec, 2012
[31] Plani i Zhvillimit Komuna Tërthorë, 2012
[32] Plani i Zhvillimit Komuna Topojan, 2012
[33] Plani i Zhvillimit Komuna Bicaj, 2012

rëndësi biologjike që jetojnë në ujërat e Fierzës përmendet lundërza, lloj i Listës së Kuqe të Faunës shqiptare, globalisht i kërcënuar.

Nga Liqeni është marrë deri në 5 mijë tonë peshk në vit, por prodhimi ka pësuar rënie në dhjetëvjeçarët e fundit për shkak të mos shtimit, por edhe për arsye të peshkimit të pa kontrolluar, shpesh dhe me mjete shfarosëse si dhe ndotja e liqenit. Po kështu mungojnë edhe kushtet për rritjen e ruajtjen e peshkut. Megjithatë, problemi më i madh që ekziston është se ky liqen ndotet shumë nga mbetjet urbane ku pjesa më e madhe vjen nga rrjedhjet e lumenjve të Drinit të Bardhë dhe Drinit të Zi, të cilat ndikojnë negativisht në cilësinë e ujit, faunës. ambjetit përreth, si dhe shfrytëzimin e terrenit për plazh dhe aktivitete ujore.

Ndërkohë, sic është shprehur edhe në Strategjinë Rajonale të Kukësit edhe në atë të Bashkisë Kukes, ky potencial natyror i pa shfrytëzuar, ka një kërkesë në rritje nga banorët per t'u vizituar dhe interes nga pushteti vendor për ta shndërruar në një destinacion turistik

Gjithashtu po bëhen përpjekje të vazhdueshme për të ndërgjegjësuar popullsinë në lidhje me vlerat e peshkimit, mbrojtjen e Liqenit sic është Dita e Peshkimit e cila festohet në 13 qershor.

Për këtë arësye marrja e masave për  për të përmirësuar kushtet aktuale të liqenit e rritur peshkimin, nëpërmjet pastrimi i Liqenit të Fierzës dhe zonës përreth tij, sistemimit të bregut te Liqenit dhe pershtatjes së tij ne një Pike Turistike , si dhe peshkezimit artificial si të Liqenit te Fierzes dhe ujembledhesve  te Qarkut Kukes ka qënë dhe mbetën si prioritete të për zhvillimin e këtij sektori në mënyrë të qëndrueshme dhe kthimin e tij në një potencial për zhvillimin e ekonomisë lokale dhe turizmit.

Figura e mëposhtme paraqet analizën SËOT për sektorin e Bujqësisë.

### Anët e Forta

- Klimë e favorshme për zhvillimin e Bujqësisë Bio dhe Blegtorisë
- Bujqësia e blegtoria janë motori më i madh i të ardhurave në ZF
- Shumëllojshmëri bimësh medicinale
- Kërkesë në rritje e tregut të brendshëm për produkte origjinale vendase
- Akses pranë rrugës kombëtare Durrës Kukës;
- Akses i shpejtë në tregjet e vendeve fqinje ( Kosovë, Mali i Zi, Maqedoni)

### Dobësitë

- Kapacitete të kufizuara për zhvillimin e bujqësisë dhe blegtorisë
- Bashkëpunim i dobët mes autoriteteve publike dhe industrisë së bujqësisë
- Mungesë financimesh dhe investimesh
- Mungesa e certifikimeve me standarte cilësie
- Mungesë ndërgjegjësimi për nevojën për t'u trajnuar mbi pajtueshmërinë ligjore, higjenën, cilësinë etj.
- Mungesë vizioni në sjelljen e risive në agrobiznes
- Mungesë teknologjie inovative lehtësuese gjatë prodhimtarisë
- Tregjet ushqimore ne kushte të papërshtatshme higjeno-sanitare

### Mundësitë

- Zhvillim i mëtejshëm i kapaciteteve bujqësore dhe blegtorale të rajonit
- Rritje e prodhimeve BIO dhe prodhimeve të certifikuara
- Rritja e numrit të dhenëve dhe futje e racave me prodhimtari të lartë
- Mundësi për zhvillimin e agrobizneseve nëpërmjet zhvillimit të agroturizmit
- Rritja e promovimit të produkteve rajonale për të nxitur konkurueshmërinë dhe prodhimin
- Treg i hapur drejt investimeve të reja në agrobiznes
- Interes në rritje per eksportin e bimeve medicinale dhe aromatike

### Kërcënimet

- Pamundësia për të mbuluar gjithë ZF
- Madhësia e vogël e fermave pengesë për rritje të produktivitetit dhe konkurueshmërisë
- Përdorim i pakontrolluar i pesticideve
- Terren dhe ujë i ndotur që kërcënon cilësinë e peshkut dhe prodhimeve të tjera bujqësore
- Mungesë kontrollesh higjene dhe cilësie të cilat pengojnë sigurinë e konsumatorit dhe eksportin ndaj vëndeve të BE-së.
- Mos-zbatimi i praktikave miqësore ndaj ambjentit

## 4.2 Sektori i Turizmit

Turizmi është një nga potencialet madhore të Zonës Funksionale të Kukësit. Natyra e bukur, peisazhet, folklori tradicional, vendet kulturore e historike, parqet natyrore e pyjet, liqenet, lumenjtë, zonat e mbrojtura, janë të njohura tashmë, por pak të shfrytëzuara. Në Strategjinë Rajonale të Kukësit 2012, por edhe në Planin e Zhvillimit të Bashkisë së Kukësit 2011-2015, turizmi qëndron si një nga prioritete kryesore. Analiza e potencialeve të turizmit është kryer duke u bazuar në strukturën e produkteve të turizmit në Shqipëri[34].

| Turizmi Kulturor & Historik | Turizmi Rural | Turizmi Natyror | Turizmi Liqenor |
|---|---|---|---|
| •Muzeu<br>•Aktivitetet Kulturore të Zones<br>•Festivalet Folklorike<br>•Kulinaria e Zonës<br>•Traditat e Zonës<br>•Monumentetet e Trashëgimisë Kulturore<br>•Historia e Zonës | •Fshatrat dhe zonat rurale me natyre të pasur alpine<br>•Stili i vacante i jetes rurale të zones<br>•Festat e vecanta ne fshatra apo zona te caktuara<br>•Agro Turizmi | •"Hard Adventures" , si ngjtja ne majat malore<br>•Sporti malor i skive dhe garat me ski<br>•Eco- turizmi<br>•Kampingjet malore | •Plazhi liqenor<br>•Sportet liqenore (gara me varka, kanoe, gara noti);<br>•Lundrime me traget turistike përgjat liqenit |

Bazuar në ndarjen e mësipërme situata e turizmit në ZF të Kukësit është si më poshtë:

### 4.2.1 Turizmi Kulturor

Prodhimet e artizanatit të sotëm kuksian, jane në vazhdën e traditave shekullore që datojnë nga koha Ilire. Tradita e poçarisë ka qenë një traditë e lashtë[35]. Gdhendja e gurit, drurit, punimi i hekurit janë përdorur gjerësisht dikur për zbukurimin e shtëpive, duke filluar që nga periudha e mesjetës e në vazhdim. Prodhimet qilimave të artizanave Kuksiane , kanë qenë po aq të famshme, sikurse dhe prodhimet e artizaneve të Korçës dhe të Krujës. Një vend të rëndësishem ka zënë përgatitja e kostumeve tradicionale popullore të grave dhe burrave. Ato janë ruajtur origjinale dhe janë një shprehje e qartë e identitetit Kuksian. Kostumet popullore, sidomos të grave, shquhen për bukurinë, elegancën, koloritin e pasur dhe shumëllojshmerinë dhe janë unike në llojin e tyre. Tradita e prodhimit të artikujve të tillë të artizanatit sot po humbet pasi numri i personave që merren me këto mjeshtëri po zvogëlohet së tepërmi.

Ka një gamë të gjerë veprimtarish kuturore-artistike që zhvillohen në këtë zonë, kryesisht në qendrën e saj të Kukësit si manifestime, festivale, konkurse letrare, panaire, ekspozita. Festa të veçanta si Festa e Gështenjës, Festa e Patates, Dita e Artizanatit, Dita e Bujarisë, Festat e Komunave, Ditë Peshkimi, Festa e Mjaltit, Pelegrinazh Pashtrik, Dita Rajonale e Arsimit, Kolonia Kombëtare e Piktorëve “ArtKukës" janë aktivitete të cilat shërbejnë për të mbledhur komunitetin e zonës, por edhe për të tërhequr turistë.

[34] Struktura e prezantuar në draft Strategjinë e Turizmit ne Shqipëri

[35] Disa dekada më parë, në varret e zbuluara gjate kërkimeve arkiologjike, në fshatin Kolsh, janë gjetur objekte pocerie, të zbukuruara me vizatime artistike, e te prodhuara nga vendasit.

Edhe pse Kukësi ka një histori të tijën të shkuar, apo edhe të afërt me mbështetjën e bërë popullsisë kosovare gjatë luftës në Kosovë, pak është bërë deri tani për evidentimin historik, apo edhe artisitik, të kësaj periudhe nëpërmjet objekteve që mund të ktheheshin në një atraksion turistik.

Kjo zonë ka disa monumente të trashëgimisë kulturore por mirëmbajtja e tyre dhe shfrytëzimi i potencialve të tyrë për promovimin e turizmit kulturor dhe historik ende nuk po realizohet në nivelet që kërkohet.

#### *4.2.1.1 Turizmi rural*

Zona funksionale e Kukësit ka potenciale të rëndësishme të zhvillimit të turizmit rural e në mënyrë të vecantë të turizmit malor. Sasati në lartësinë e mbi 1700 metrave mbi nivelin e detit, është një vend mjaft tërheqës pasi në stinën e verës ai mbushet plot me vizitorë që qëndrojnë deri sa vjen dimri. Kanioni i Shkallës së Keqe (Gjallicë) është një nga më madhështorët me një thellësi prej 2000 m i paeksploruar deri më sot. Kroji i Bardhë[36], në malin e Gjallicës është një pikë turistike që po bëhet gjithnjë e më e njohur jo vetëm nga vendasit, por edhe nga turistë e gjuetarë nga zona të tjera të vendit. Pika turistike pranë Gurit të Mëngjesit në Shishtavec vizitohet nga vizitorët vendas dhe nga zona të tjera, apo nga Kosova.

Një tjetër pikë turistike është edhe Pylli i Mështeknave, ku thuajse çdo ditë janë të pranishëm vizitorë të ardhur nga zona të ndryshme, madje edhe të huaj, kryesisht nga Kosova. Po kështu ndodh edhe me stanet e Novosejit, "Kroji i Kuq", 'Kroi i Bardhë", që kanë nisur të vizitohen jo vetëm gjatë verës, por edhe në dimër. Në zonën e bjeshkëve në Shishtavec[37] ndodhet një shkëmb i lartë në mes të gjebërimit dhe të një bari të rritur shëndetshëm. Banorët e quajnë Guri i Mëngjesit sepse aty lind dielli. Pranë liqenit artificial të Kallabakut, ndodhet fshati i vogël turistik i Novosej i pasur me lugina të gjelbëruara dhe pyje.

| Monumentet Natyrore |
|---|
| - Pisha e Gjergjanit |
| - Gryka e Çajes |
| - Cirku akullnajor i Zepes |
| - Kroi i Bardhe |
| - Kanioni i Bicajt |
| - Kanioni i Vanave |
| - Lisat e Kalisit |
| - Karsti i Arnit |
| - Keneta e Kukësit |
| - Kroi i Kuq, Gjallice |
| - Guri i Mengjesit, Shishtavec |
| - Guri i Shqipes (Borje) |
| - Burimi i Kolosianit |
| - Dushkajat e Novoseit |
| - Meshtekna e Shishtavecit (liqeni i Kallabakut) |
| - Rrobulli i Lakut te Topojanit. |

Zhvillimi i turizmit malor ka bërë hapa të rëndësishëm përpara duke çuar në shtimin e numrit e banesave turistike në zonat rurale. Po ashtu edhe ndërtimi i autostradës, dhe I aeroportit të Kukësit kanë krijuar mundësi efikase për zhvillimin cilësor të turizmit malor, për të cilin kërkesat janë gjithnjë në rritje si nga vizitorët nga shqipëria dhe zonat e Kosoves, si Prizrenit e Dragash. Marrëveshjet ndërmjet Qarkut, Bashkisë e komunave po i japin një zhvillim këtij lloj turizmi.

[36] Është vetëm 30 kilometra larg qytetit të Kukësit.

[37] Komuna e Shishtavecit është shpallur zonë e mbrojtur e kategorisë së katërt, aty nuk ka më gjueti të paligjshme, ka zogj e kafshë të egra që nga lepujt deti tek dhitë e egra dhe kaprojtë, kafshë grabitqare që nga macet e egra, rreqebujt deri tek ujku.

### 4.2.2 Turizmi Natyror -Dimëror

Zona e Shishtavecit njihet si një nga zonat ku, edhe pse modest, zhvillohet turizmi dimëror. Ushtrimin i sportit të skive tashmë realizohet tashmë prej më shumë se 7 dekadash[38]. Në të kaluarën, si rezultat i masivizmit të sportit të skive, mes Shishtavecit dhe Voskopojës ndahej vit pas viti organizi i kampionateve të skive. Kjo praktikë më ardhjen e tranzicionit është ndërprerë. Shishtaveci ka sot ekipin e tij të skive të federuar nga Federata Shqiptare e Skive dhe po ashtu edhe fshati Mborje. Fshati Novoseje njihet për mundjen dhe fshati Borje për hipizmin. Ndërsa pika të tjera turistike si Kroji i Ramës, Kroji i Kishës dhe Kroji Tatzot, vizitohen vetëm nga pasionuarit pas alpinizmit dimëror.

Në se flasim për turizmin ndërkufitar apo marrëdhënie të tjera në këtë hapësirë, sërish Shishtaveci ka përparësi të dukshme, për shkak të pozicionit, potencialeve njerëzore, ekonomike e kulturore. Turizmi përbën prioritetin e parë për zhvillimin e Komunës së Shishtavecit, e cila zotëron burime të virgjëra natyrore e të pa shfrytëzuara

Gjithashtu edhe në Komunën e Tërthorës, megjithëse infrastruktura ka bërë që bjeshka të mos frekuentohet, mbetet një resurs i pashfrytëzuar për turizmin alpin për vitet e ardhshme. Kjo është shprehur qartë edhe në Planin e Zhvillimit të Komunës e ka nevojë për incentiva që të mund të zhvillohet.

Në Bicaj për shembull, e gjithë pjesa e bjeshkës (duke filluar nga Laku i dardhës e deri tek kroi i kuq) është një vend i mrekullueshëm për vizitorët dhe turistët që janë të interesuar për klimën e freskët malore. Para disa vitesh në këtë zonë kalonin pushimet verore mjaft vendas dhe të huaj.

Zhvillimi i turizmit shoqërohet me zhvillimin e prodhimeve bujqësore, blegtorale, riparimin, përmirësimin e shtëpive të banorëve, rregullimin/ ngritjen e vendeve të përshtatshme për kalimin e kohës së lirë të vizitorëve, si dhe përmirësimi i prodhimeve lokale, etj.

Duke pasur parasysh natyrën shumë të pasur të kesaj zone, zhvillimi i turizimit mund të jëtë gjithëvjetor duke u shfrytëzuar për gjatë gjithë stinëve të vitit.

#### 4.2.2.1 Turizmi Liqenor

Zona e Kukësit shtrihet në anën juglindore të liqenit artificial të Fierzës. Ekzistenca e liqenit në këtë zonë është një potencial i madh për zhvillimin e turizimit, pasi pika të caktuara të tij mund të shfrytëzohen gjatë verës si plazhe që mund të përdoren nga banorët vendas si pika për larje dhe banjo dielli, por njëkohësisht mund të frekuentohen edhe nga banorët e zonave kufitare më Kosovën, të cilëve të tilla vende ju mungojnë. Po kështu, edhe zhvillimi i akuakulturës është një potencial për t'u konsideruar pasi liqeni i Kukësit njihet për peshkun që rritet aty, i cili sot preferohet nga turistët që vizitojnë qytetin. Sporte të tilla si garat me kanoe mund të jënë një mundësi e mirë për t'u zhvilluar nisur nga sipërfaqja e madhe e liqenit dhe lidhja e tij me degët e Drinit.

Por marrja e masave për pastrimin dhe mbajtjen pastër të liqenit dhe krijimin e infrastrukturës së duhur për sportet liqenore apo pikat e plazheve përgjate liqenit duhet të jenë në vemëndjen e autoriteteve lokale.

---

[38] Ky sport ka filluar të ushtrohet që prej vitit 1953, pavarsisht se infrastruktura e lehte si veshja e skiatorëve, skitë dhe gjithë paijsjet e tjera kurrë nuk kanë qënë në nivelin e ushtrimit në mënyrë profesioniste.

Përmledhje skematike e Avantazheve dhe Problematikes që has sektori i turizmit jepen ne figurën e mëposhtëme

**Figura 4: Avantazhet dhe Problematika e Sektorit të Turizmit[39]**




Edhe pse potencialet ekzistuese janë të mëdha zhvillimi i turizmit në këtë zonë has disa sfida, të cilat paraqiten më poshtë:

- ***Kapacitetet akomoduese***: Në qytetin e Kukësit janë në funksionim 10 hotele bujtina janë ndërtuar në zonën e Shishtavevit. Krahas tendencës në rritje të numrit të bujtinave, jo rrallë shumë prej turistëve kalojnë netët në banesat e banorëve vendas, apo në verë edhe në çadra. Ndërsa rritet numri i vizitorëve, i domosdoshëm mbetet zgjerimi i shërbimit të hotelerisë, përmes ndërtimit të hoteleve turistike, apo bujtinave në zonat e thella malore. Vihet re tendenca e ndërtimit të bujtinave nga qytetarë të larguar prej kohësh drejt kryeqytetit, të cilët po i rehabilitojnë banesat e tyre duke i kthyer në bujtina.
- ***Cilësia e shërbimeve*** megjithë përmirësimet e kohëve të fundit ende mbetet një problem që kërkon vëmendje dhe ngritje të kapaciteteve e aftësive të si menaxheriale edhe të shërbimeve;
- ***Infrasturktura e dobët:*** problemet me infrastrukturën rrugore, të furnizimit me energji elektrike, kanalizimeve, furnizimit me ujë, ndikojnë direkt në cilësinë e shërbimit dhe lehtësimin e aktivitetit turistik
- ***Sinjalistike rrugore e dobët;***
- ***Mungesa e promovimit intensiv*** nëpërmjet rritjes së marketimit dhe informacionit, duke shfrytëzuar operatorët e ndryshëm turistikë.

[39] Kutite nengjyre te kuqe paraqesin avantazhet, me ngjyre gri problematiken direkte dhe me ngjyre lejla elementet pengues ne cilesine dhe eficencen e prodhimit bujqesor.

Harta 11: Përqëndrimi i hoteleve dhe bujtinave




- ***Problem i pronave dhe ndërtimet pa leje***, sjell një ndikim negativ si në lidhje me sigurinë e zhvillimit të bizneseve në këtë fushë edhe me problemet e zhvillimit urban në funksion të turizmit.
- ***Mungesa e një qasje të koordinuar dhe të integruar të ofertës turistike:*** edhe pse produktet turistike në zonë në momentin aktual mbeten të limituara, për të rritur sa më shumë mundësinë e shfrytëzimit të kapaciteteve ekzistuese është e nevojshme që të zhvillohen paketa të cilat integrojnë ture të alternuara së bashku me zona të tjera si Valbona, apo dhe me pikat në vendet kufitare si Sharri, Brezovica në Kosovë, në mënyre që të rrisi mundësinë e thithjes sa më shumë të turistëve vendas e të huaj duke i ofruar në të njëjtën kohë një program të alternuar. Zhvillimi i rrjetit të bujtinave do të ndihmojë në koordinimin e përpjekjeve për të ofruar sa më shumë mundësi akomodimi të kërkesave në një periudhë të vetme.

Në kohën kur kërkesa dhe vetë industria e turizmit po zhvillohen jo vetëm si rezultat i kërkesës nga jashtë por edhe i kërkesave të tregut të brendshëm, zhvillimi i turizmit duhet të shkojë paralelisht dhe të shoqërohet me zhvillimin e prodhimeve bujqësore, blegtorale, përmirësimin e shtëpive të banorëve, dhe ngritjen e kapaciteteve të reja akomoduese, rregullimin dhe ngritjen e vendeve të përshtatshme për kalimin e kohës së lirë të vizitorëve, si dhe përmirësimin e prodhimeve lokale etj.

Promovimi, përmirësimi i edukimit dhe nivelit të kulturës tek banorët e zonës për zhvillimin e turizmit, e mikëpritjes së turistëve, nivelin e jetesës dhe konceptet për zhvillimin lokal të zonës së tyre, rritja e aftësive profesionale dhe e njohurive të banorëve mbi ekonominë e tregut dhe përshtatjen me kërkesat e tij, janë sfida që duhen mbajtur parasysh për një zhvillim të këtij sektori në të ardhmen.

Nga kjo analizë del në pah se ZF ka burime të shumta për zhvillimin e turizmit në një sërë degësh të tij por nga ana tjetër vërehen dhe një sërë mangësish të cilave duhet t'u jepet zgjidhje sa më shpejtë, dhe kjo mund të arrihet vetëm në rastet kur hartohen politika turistike të studiuara mbi bazën e gjendjes aktuale në të cilën ndodhet zona, dhe duke mbajtur parasysh një qasje të integruar.

Figura e mëposhtme paraqet analizën SËOT për sektorin e Turizmit.

### Anët e Forta

- Pasuri natyrore dhe biodiversitet I pasur
- Vlera Historike e kulturore
- Peisazhe piktoreske ,
- Ekzistenca e pasurive të ndryshme natyrore qe lejojne zhvillimin e disa llojeve turizmi e sportesh, si sportet e ujit (liqeni) sportet e skive, ngjitjeve malore etj.
- Tradita të forta të artit popullor
- Tradita të forta bujarie dhe mikpritjeje
- Akses i afërt në rrjetin rrugor kombëtar nëpermjet aksit Durres - Kukës
- Pjesëmarrje në iniciativa e programme të bashkëpunimit nderkufitar

### Dobësitë

- Infrastrukturën e përshtatshme për aksesueshmërinë nga turistët
- Kapacitete të limituara akomoduese dhe cilësi jo e lartë shërbimi
- Bashkëpunim i dobët mes autoriteteve publike dhe industrisë së turizmit
- Mungesë“Inovacioni” dhe paketash të integruara që lidhin turizmin malor me ate detar, apo lloje të tjera
- Rregullim i dobët Urban dhe ndotje Urbane
- Mungesa e sigurisë dhe shërbimit shëndetësor të shpejtë nëpër zona malore

### Mundësitë

- Përmirësimi i infrastrukturës
- Zhvillimi I mëtejshem i sektorit të agroturizmit
- Rritja e prodhimeve BIO dhe prodhimeve të certifikuara
- Kerkese ne rritje nga tregu vendas per turizmin dimeror dhe te natyres
- Mundësi për zhvillimin e llojeve të ndryshme të turizmit (përfshi lloje të reja të turizmit si ai aventurier, liqenor, medicinal etj.)
- Rritja dhe përmirësimi i kapaciteteve akomoduese dhe të shërbimeve turistike.
- Rritja e promovimit të turizmit të rajonit brënda dhe jashtë vendit
- Treg i hapur drejt sipërmarrjeve të reja turistike (*welcoming market*)
- Politika për tërheqjen e investitorëve
- Potenciale për Iniciativa për zhvillimin e bizneseve turistike dhe sidomos sporteve dimerore.
- Mjedis pa ndotje industriale
- Rimëkëmbja e prodhimeve artizanale
- Promovim i kulinarisë vendase bazuar në shfrytezimin e produkteve BIO të zonës.

### Kërcënimet

- Sistem jo i integruar sic duhet me tregun turistik ndërkombëtar
- Motivim financiar jo i mjaftueshëm për zhvillimin e turizmit
- Konkurrencë e fortë nga zona të tjera të afërta rurale-malore me turizëm më të zhvilluar (psh. Thethi)
- Menaxhim jo i qëndrueshëm i mbetjeve urbane dhe pasurive natyrore
- Zhvillim shumë i vonuar i turizmit të qëndrueshëm
- Globalizimi (zbehja e traditave kulturore)

## 4.2.3 *Minierat*

ZF e Kukësit dallohet për burimet e shumta minerale. Rezervat kryesore të kromit ndodhën shkëmbejtë Ultrabazik të Zonës së Kalimashit. Miniera kryesore e nxjerrjes së kromit janë në zonat Kalimash 1 dhe 2, por edhe zonat përreth. Burime të mineralit të kromit ka dhe në zonën e Surroit por nxjrrja e tyre bëhet nëpërmjet karrirave.

Minerali i bakrit nxirret në zonën e Gjegjanit dhe Ngdhesht. në zonën e Shënmrisë ndodhet miniera e bakrit në Lerpoj, e pashfrytëzuar deri tani.

Hekur-Nikel dhe Nikel-Silikat: përqëndrimi kryesor në Kolsh, Surroj dhe Arren. Këto miniera janë sot në potencialin e tyre më të madh (rezerva maksimale), të cilat llogariten në masën prej 74 milion ton rezerve minerali.

Harta 12: Vendodhja e Minierave dhe HEC-ve




Boksidet dhe alumini shtrihen në Qafë- Bëne, ndërsa mineralet radioaktive (ende rezervat të pa përcaktuara) ndodhen në Nimce, ndërsa kuarcitet në Kallabak e Shishtavec.

Në ZF te Kukësit ushtrojnë aktivitetin e tyre 25 subjekte minerare[40] Numri i të punësuarve në këtë sektor është rreth 1000 punonjës, dhe të gjithe janë punëtorë që jetojnë Kukës dhe komunat ku janë të vendosur minierat. Numri më i madh i punonjësve është punësuar nga kompania I.M.I Të gjitha minierat janë të privatizuara. Kontributi i këtij sektori në zhvillimin e ekonomisë së zonës lidhet vetëm me punësimin e fuqisë së aftë për punë dhe kontributin në buxhetin e NjQV ku janë të vendosura nëpërmjet dhënies se 6% të vlerës së prodhimit që quhet *renta minerare.*

Pjesa me e madhe e mineralit të Kromit përpunohet në një fabrike të ngritur ne ZF të Hasit, ndërkohe qe pritet të ndrihet një Fabrikë ë përpunimit të Kromit në ZF të Kukësit.

[40] Burimi: Prefektura Kukes

Minerali i hekur - nikelit eksportohet në Kosovë, në Uzinën e Shkrirjes së Hekur-Nikelit në Drenas, ndërkohë që nëse investohet në ngritjen e kapaciteteve në shkrirjen e hekur-nikelit direkt në zonen e Kukësit, kjo do të rriste mundesinë për një punësim më të madh të punëtorëve nga zona, si dhe do të ndikonte në përmirësimin e ekonomisë dhe të ardhurave lokale.

Në këtë zonë siç jepet edhe në hartën e mesipërme ekzistojnë edhe një numer i madh i HEC-ve. Në Komunën e Bicaj ndodhet edhe masivi i shfrytëzimit të rërës së bardhë e cila furnizon gjithë zonën e Kukësit dhe Hasit. Kjo pasuri përbën një burim shumë të rëndësishëm për popullsinë e zonës, vetëm se shfrytëzimi i saj duhet të kryhet me kriter, dhe duhet të investohet në mënyrë të studjuar në drejtim të shfrytëzimit dhe përpunimit të saj.

Në bazë të Strategjisë Rajonale të Qarkut të Kukësit 2012, veprimet që mund të ndërmerren në lidhje me këtë sektor do të fokusohen në nisma të përbashkëta të aktorëve të ndryshëm. Këtu përfshihen promovimi dhe shfrytëzimi i planifikuar i bazuar në kërkime, të mineraleve nëpërmjet aplikimit të metodave e teknologjive moderne, metoda e teknologji që konsiderojnë aspektet dhe pasojat mjedisore. Shembuj të ndërhyrjeve në këtë sektor mund të jenë:

- studime, kërkime dhe inventar të depozitave minerale të disponueshme e konomikisht të qëndrueshme
- fushata ndërgjegjësuese dhe promovuese mbi rezervat minerale ekzistuese dhe nxitjen e investimeve për të tërhequr kompanitë minerale në rajon
- pastrimi i vendeve që paraqesin rreziqe mjedisore
- prezantim programesh trajnuese e edukimi profesional lidhur me industrinë.

Figura e mëposhtme paraqet analizën SËOT për sektorin e Minierave.

### Anët e Forta

- Rajon i pasur me shumllojshmëri mineralesh metalore dhe jo-metalore
- Eksperiencë të mëparshme me nxjerrjen dhe përpunimin e mineraleve
- Fuqi puntore e disponueshme
- Biznese të interesuara drejt mundësive minerare të rajonit

### Dobësitë

- Bashkëpunim i dobët mes autoriteteve publike dhe industrisë së nxjerrjes dhe përpunimit të mineraleve
- Mungesë investimesh në rimëkëmbjen e industrisë
- Infrastrukturë e vjetëruar
- Mungesë teknologjish moderne të kërkimit dhe nxjerrjes së mineraleve
- Mungesë sensibilizimi ambjental nga bizneset minerare ekzistuese
- Mungesë kontrollesh ambjentale.

### Mundësitë

- Mundesi per rivitalizimin e industrise se perpunimit te hekur nikelit qe do sjelle vleren e shtuar te produktit
- Mundësi të reja punësimi dhe zhvillimi rajonal me rimëkëmbjen e minierave të vjetra dhe investimin në minierat e reja
- Tërheqja e investimeve publike si dhe bizneseve të reja
- Mundësi të shumta eksporti brënda dhe jashtë vëndit
- Investim në trajnimin, edukimin dhe rritjen e kapaciteteve në industrinë e minierave
- Ndërgjegjësim i komunitetit të bizneseve minerare për mbrojtjen e ambjentit nga ndotjet e minierave

### Kërcënimet

- Aktivitete të paligjshme si pasojë e braktisjes së disa minierave apo mungesës së subjekteve të liçencuara
- Kushte të dobëta pune dhe siguri e ulët e jetës së puntorëve të minierave
- Ndotje ambjentale prej mbetjeve minerare dhe mungesës së hapsirave për depozitimin apo përpunimin e tyre
- Cilësia e peshkut, bujqësisë dhe blegtorisë e rrezikuar nga ndotja e terrenit dhe ujit si dhe rrezik shëndetësor për banorët vëndas
- Zhvillim i vonuar i rajonit për shkak të mos-shfrytëzimit të plotë të pasurive minerare të cilat do ndikonin konsiderueshëm në rritjen e ekonomisë dhe punësimit

## Konkluzione

Analiza e sektorëve të mësipërm ekonomik nxjerr disa karakteristika qe jëne të përbashketa për të tre sektorët kryesore të analizuar të cilat janë:

*1. Një zonë më e pasur me burime minerare, prodhimtari të pasur bujqësore e blegtorale dhe me pasuri natyrore të vecanta;*

*2. Avantazhe konkuruese të cmimeve të produkteve të ndryshme të prodhuara në zonë;*

*3. Mundesi e potenciale të medha për të perdorur elementin "BIO" ne shumë sektorë si bujqësi e turizem;*

*4. Interes në rritje nga tregu i brendshëm dhe ai rajonal për perdorimin e burimeve minerale, larmisë së produkteve bujqësore e blegtorale;*

Por potencialet e medha qe kjo zonë ka si rezultat i pasurive të saj nentokesore, mbitokesore dhe trashegimise kulturore nuk shfrytezohen si rezultat i ndikimit të një sërë faktorësh të cilët ndikojnë paralelisht dhe respektivisht ne gjithe sektoret. Nder keta faktorët me ndikim negativ më të ndjshëm janë:

*1. Infrastruktura rrugore ende e pazhvilluar në disa zona;*

*2. Kapacitetet e burimeve njerezore të pazhvilluara, si rezultat edhe i mungeses se nje sistemi te trajnimit profesional multi-disiplinor;*

*3. Mungese të këshillimeve profesionale të shtrire në të gjithe sektoret dhe sherbimeve specifike per fermret, strukturat akomoduese e mikepritese;*

*5. Mungese e sistemve financiare mbeshtetese;*

Ndërsa një pjesë e ketyre problemeve mund të adresohen nëpermjet mbeshtetjeve dhe aplikimit të programeve specifike nga strukturat qendrore (sherbimet buqjesore, veterinare), tregu financiar apo mikro-kreditit, sistemi I VET. Ndersa një pjesë e mire e tyre që lidhen më zhvillimin e infrastruktures lokale, si asaj rrugore, transportit publik, tregjeve dhe pikave te grumbullimit te produkteve bujqesore e blegtorale, mund të realizohen nga Njesite e reja te qeverisjes vendore qe do te krijohen me qëllim krijimin e kushteve fizike në ndihme të ekonomive dhe bizneseve lokale.

# 5. SHERBIMET PUBLIKE NE ZONEN FUNKSIONALE KUKËS

## *5.1 Infrastruktura*

Në këtë zonë kalon ndër veprat kryesore infrastrukturore mund të përmendim: autostrada Durrës - Morinë e cila është pjesë e aksit rrugor kombëtar që lidh Shqipërinë me Kosovën. Akset kryesore që lidhin qendrën e kësaj zone, qytetin e Kukësit me zonat e tjera janë: aksi Kukës-Durrës (1.5 orë), aksi Kukës-Peshkopi (1.5-2 orë), aksi Kukës-Has (30-40 min), aksi Kukës-Shishtavec (30 min).

Në këtë zonë ndodhet pika kufitare më e rëndësishme që lidh Shqipërinë më Kosovën, Morinë/Kukës dhe 4 (katër) pika kufitare të tjera (Shishtavec/Kukës, Orgjosë/Kukës, Borje/Kukës për këmbësorët dhe, Qafa Prush/Kukës për ngarkesa dhe mjete).

Në qytetin e kukësit ndodhet aeroporti i Kukësit ndërtuar në 2004, por për shkak të kushteve koncesionare të Aeroportit të Rinasit nuk është në funksion,por përbën një potencial për zonën.

Harta 13: Rrjeti rrugor ne Zonen Funksionale




Sipas të dhënave nga zyrat përkatëse të shërbimeve në komuna, këto të kontrolluara me të dhënat e drejtorisë rajonale të rrugëve kemi:

**Tabla 9: Rrjeti Rrugor**

| NjQV | Km ne total | Rruge Urbane | Rruge rurale | Km te asfaltuara | Km te pa asfaltuara |
|---|---|---|---|---|---|
| Bashkia Kukes | 25 | 8.5 | | 6.7 | |
| Shtiqen | 18.9 | 0 | | 13.1 | |
| Malzi | 108 | 0 | | | 108 |
| Terthore | 29.9 | 0 | | | |
| Zapod | 28.8 | 0 | | | 10 |
| Surroj | 94.5 | 0 | | 13.9 | 13.9 |
| Bicaj | 39 | 0 | 30 | 13.6 | 18 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| Shishtavec | 36.6 | 0 | 17 | | |
| Arren | 19 | 0 | 12 | | |
| Gryke Caje | 21 | 0 | 7 | | |
| Bushtrice | 4.5 | 0 | | | |
| Kolsh | 9.9 | 0 | 4.6 | 2 | |
| Kalis | 70.1 | 0 | | 12 | |
| Topojan | 50.5 | 0 | | 1.5 | |
| Ujmisht | 23 | 0 | | 2 | |

Burimi: NjQV dhe Drejtoria Rajonale e Rugëve Kukës.

Ndërsa rrugë rajonale 122.5 km dhe kombëtare 181 km rrugë. Cilësia e infrastrukturës rrugore lë shumë për të dëshiruar ku shume pak nga rrugët lokale janë të asfaltuara dhe pjesa tjetër është e pashtruar. Sic shihet edhe nga grafiku me poshte pjesa e rrugeve te asfaltuara dhe ne kushte te mira eshte vogel.

**Grafiku 10: Gjendja e infrastruktures rrugore**




Duke qenë se investimet në këto komuna janë të hershme kategorizimi i cilësisë së rrugëve të asfaltuara është i vështirë për punonjësit e komunës. Zonat më të largëta nga pikëpamja e udhëtimit janë: Arren, Ujmisht, Bushtrice, Gryke Cajë, Kalis ku koha e udhëtimit nga qendrat e këtyre komunave në Kukës është rreth 2.5 – 3 orë. Ndërsa mesatarja e pjesës tjetër të komunave me Kukësin është rreth 45 – 60 minuta.

Inventari i rrugeve për Zonën Funksionale të Kukësit të ndarë sipas komunave është

**Tabela 10: Inventari i rrugeve për Zonën Funksionale të Kukësit**

| Nr | Komuna | Emërtimi | Gjatësia (km) | |
|---|---|---|---|---|
| | | | Rajonale | Komunale |
| 1 | Malzi | Shemri - Petkaj | 3 | |
| 2 | Malzi | Shemri – Miniere | | 2 |
| 3 | Malzi | Vrish – Piste | 9 | |
| 4 | Malzi | Rn05 - Vaspas | | 9 |
| 5 | Malzi | Kryemadh - Ura Vezirit | | 7 |
| 6 | Malzi | Qafshtan - Laku i Pyllit | | 13 |
| 7 | Malzi | RN05 – Shikaj | 8.4 | |
| 8 | Malzi | Shemri – Simon | | 3 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 9 | Malzi | Shemri – Qam | | 8 |
| 10 | Malzi | Rn 05- Zhubaj | | 4 |
| 11 | Malzi | Kalimash- Miniere | | 3 |
| 12 | Kolsh | Kolsh - Karburant | | 5 |
| 13 | Kolsh | Kryqezim- Mamez | 7 | |
| 14 | Surroj | F.dugagjin - Qafe Komi | 28 | |
| 15 | Surroj | Mulliri i Surroit - Komune | 3 | |
| 16 | Surroj | Rn - Aliaj | | 4 |
| 17 | Surroj | Rn05- Qinamak | | 2.5 |
| 18 | Surroj | Mamez Qinamak - Surroj | 11 | |
| 19 | Surroj | Surroj - A.Vata | | 3 |
| 20 | Surroj | K.Leke - Bregu Drinit | | 7 |
| 21 | Arren | Qafe Komi - Arren | 10 | |
| 22 | Arren | Arren - Arreza | | 4 |
| 23 | Arren | Arren - Barra | | 7 |
| 24 | Arren | Arni - Vrini | | 8 |
| 25 | Arren | Arni - Verrini | | 3 |
| 26 | Terthore | Perbreg - Gjegjqn | | 3 |
| 27 | Ujmisht | Rn31 - Malqene | 2 | |
| 28 | Ujmisht | Domaj - Lapaj | 12 | |
| 29 | Ujmisht | Ujmisht - Tejdrine | | 6 |
| 30 | Bushtrice | Lapaj - Bushtrice | 6 | |
| 31 | Kalis | Bushtrice - Kalis | 12 | |
| 32 | Kalis | Kalis - Geshtenje | | 3 |
| 33 | Gryke caje | Fshat - Caje | 7 | 14 |
| 34 | Gryke caje | Fshati - Buzemadhe | | 7 |
| 35 | Bicaj | Kolesjan - Rn16 | 9 | 26 |
| 36 | Bicaj | Nange - Bushat | | 1.8 |
| 37 | Bicaj | Bicaj - Bushat | | 3.5 |
| 38 | Bicaj | Rn31 - Gabrrice | | 4.5 |
| 39 | Bicaj | L. Dardhe - Tershene | | 2.1 |
| 40 | Topojan | Rn26 - Topojan | 2 | |
| 41 | Topojan | Breki - Topojan | | 6 |
| 42 | Shishtavec | Mulliri Novosej - Turaj | | 8 |
| 43 | Shishtavec | Rn26 - Borje/Orgjost | | 7.5 |
| 44 | Shishtavec | Cernaleve - Pike kalimi | | 7 |
| 45 | Shishtavec | Rn26 - Miniera e Kallabakut | | 8 |
| 46 | Zapod | Rn26 - Zapod | 7 | |
| 47 | Zapod | Zapod - Orgjost | | 4 |
| 48 | Zapod | Rn26 - Bele | | 6 |
| 49 | Zapod | Orcikel - Kosharisht | | 2 |
| 50 | Zapod | Ura e Kaloshit - Orgjost | | 4 |
| 51 | Shtiqen | Met.Shtiqen - Uzine | 5 | |
| 52 | Shtiqen | Rn05 - Lume | | 1 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 53 | Shtiqen | Rn31 - Krenze | | 2 |
| 54 | Shtiqen | Gostil - Shtiqen | 1.7 | |

Burimi: FShZh

Distancat e udhëtimit nga qendra e ZF Kukës në qendrat e komunave të ZF si dhe intervalet kohore të bllokimit gjatë dimrit, janë sipas paraqitjes së tabelës më poshtë.

**Tabela 11: Distancat e udhëtimit nga qendra e ZF Kukës**

| Nr. | Qender Urbane | Qender Komune | Distanca ( Km ) | Intervali kohor I bllokuar gjate dimrit |
|---|---|---|---|---|
| 1 | K U K Ë S | Malzi ( shemri) | 35 | Periodike |
| 2 | | Kolsh | 11.5 | 0 |
| 3 | | Surroj | 24 | 2 Jave |
| 4 | | Arren | 51 | 12 Jave |
| 5 | | Terthore | 13.5 | 0 |
| 6 | | Ujmisht | 24 | Periodike |
| 7 | | Bushtrice | 31 | Periodike |
| 8 | | Kalis | 46 | 4 Jave |
| 9 | | Gryke-Çaje ( Fshat ) | 36.5 | Periodike |
| 10 | | Bicaj | 11 | 0 |
| 11 | | Topojan | 20.5 | Periodike |
| 12 | | Shishtavec | 31 | 1 Jave |
| 13 | | Zapod | 21 | Periodike |
| 14 | | Shtiqen | 6 | 0 |

Burimi: Qarku Kukës

Nga tabela e mësipërme shohim se Komunat mund të grupohen sipas largesisë nga qendra e Kukësit në komuna të afërta 6-12 km ku janë Shtiqen, Kolsh dhe Bicaj. Komuna të largëta 13-25 km ku përfshihen Zapodi, Topojani, Ujmishti dhe Surroj. Komuna shumë të largëta mbi 25 km ku përfshihen Malzi, Arren, Bushtrice, Kalis, Grykë-Cajë dhe Shishtavec.

Bashkia Kukës ka edhe një inventar prej 25 km rrugë në total, ku 8.5 km janë rrugë kryesore dhe një gjatësi prej 16.5 km janë rrugë dytësore. Nga i gjithë inventari i rrugëve të Bashkisë, 18 km rrugë janë të asfaltuara dhe 7 km janë me cakull.

Mirëmbajtja e infrastrukturës rrugore në të gjitha njësitë e Zonës Funksionale Kukës bëhet me punonjës të komunave pra mund të quhet ndërmarrje publike. Komunat kanë nga 2 punonjës që merren me mirëmbajtje rutinë të rrugëve ndërsa për bashkinë Kukës stafi që merret me mirëmbajtjen e rrugëve është 1 administratë dhe 18 punonjës mirëmbajtjeje.

Mirëmbajtja e rrugëve në Bashkinë e Kukësit është 2,2 milion lekë në vit ku përfshihen edhe pagat e punonjësve.

Mirëmbajtja konsiston në pastrim nga dëbora, por edhe mbushje të gropave. Kukësi duke qenë qendër urbane në mirëmbajten e rrugëve përfshin edhe mirëmbajtje të trotuareve dhe pusetave të rrjetit KUZ.

Në komuna mirëmbajtja është krejt minimale dhe pjesa më e madhe e shërbimeve të mirëmbajtjes konsiston në pastrimin e rrugëve nga dëbora. Ky shërbim në shumë raste bëhet edhe në bashkëpunim me qarkun dhe prefekturën kur ka situata emergjence.

Komunat që ofrojnë mirëmbajtje për rrugët komunale që kanë në administrim ofrojnë një mirëmbajtje krejt të papërfillshme për standartet. Mirëmbajtja është minimale për sheshimin e rrugëve dhe mbushje të gropave që krijohen për shkak të reshjeve. Mbushja e gropave të rrugëve bëhet në mënyrë që këta rrugë të jenë minimalisht të kalueshme nga mjetet e transportit qoftë të udhëtarëve apo të mallrave.

Komunat Kolsh, Arren, Bushtricë, Ujmisht shpenzojnë mesatarisht 600 000 lekë në vit për mirëmbajtje të rrugëve komunale. Komuna Shishtavec shpenzon 800 000 lekë në vit për këtë shërbim.

Komuna Malzi duke qenë një komunë me inventarin më të madh të rrugëve komunale 108 km të tilla, shërbimin e mirëmbajtjes së rrugëve e kryen me nënkontraktor duke shpenzuar mesatarisht 2,5 milion lekë në vit.

Një shërbim me kompani private për mirëmbajtjen e rrugëve ofron edhe komuna Topojan e cila në katër vitet e fundit ka shpenzuar 20,300,000 lekë për investime dhe mirëmbajtje të rrugëve ku sigurisht peshën kryesore e zënë investimet. Fondet e financimit janë FShZh.

Në komuna të thella si Grykë-Caje shërbimi i mirëmbajtjes është inekzistent. Mirëmbajtja bëhet nga persona ose kompani private vullnetarisht dhe konsiston në pastrimin e dëborës dhe sheshim minimal të rrugëve pas shkrirjes së dëborës.

Komuna Terthore ka problematike nderthurjen e rrugeve te fshatrave me rrugen kryesore – Autostraden Kukes – Morinë. Ndërprerja e këtyre rrugëve dytësore me autostradën jashtë jashtë standarteve dhe përbëjnë rrezik për banorët.

Në Zonën Funksionale të Kukësit janë rrugë që janë në inventar të Qarkut Kukës duke qenë rrugë rajonale, dhe inventari i rrugëve nacionale që janë ose kanë pjesë në territorin e ZF Kukës ( Tabela 13 me poshte)

**Tabela 13: Inventari i Rrugeve Rajonale dhe Nacionale**

| Emertimi | Gjatesia Km | Kategoria |
|---|---|---|
| Mamez - Surroj | 11 | Rruge Rajonale |
| Mulliri i Surroit- Q,K Surroj | 2.9 | Rruge Rajonale |
| Kryqezim –Mamez | 4.6 | Rruge Rajonale |
| Ura Koloshit- Orgjost-Zapod | 10 | Rruge Rajonale |
| Kryqezimi-Topojan | 1.5 | Rruge Rajonale |
| Kryqezimi Meteor - Shtiqen | 2.5 | Rruge Rajonale |
| Kolosjan-Laku i Tejes | 18 | Rruge Rajonale |
| Kryqezim Qender-Komuna Ujmisht | 2 | Rruge Rajonale |
| Bushtrice - Kalis | 12 | Rruge Rajonale |
| Lapaj-Fshat | 7 | Rruge Rajonale |
| Surroj - Arren | 22 | Rruge Rajonale |
| Aeroport-Domaj | 12 | Rruge Rajonale |
| Ura e Koloshit -Shishtavec | 17 | Rruge Rajonale |
| | | |
| Bashkia Kukes - Qafe.Shllak | 47.6 | Rruge Nacionale |
| Morin-Tuneli Kalimash | 42 | Rruge Nacionale |
| Bashkia Kukes-Draj Reç | 26 | Rruge Nacionale |
| Domaj -Bushtrice | 19 | Rruge Nacionale |
| Kukes -Shishtavec | 15 | Rruge Nacionale |
| Kukes-Krume | 31.4 | Rruge Nacionale |

Burimi: Qarku Kukës.

Në katër vitet e fundit investimet në infrastrukturën rrugore kanë qenë shumë të kufizuara dhe të pakta. Këto investime kanë qenë në rrugë rajonale që gjenden brenda Zonës Funksionale.

| Nr. | Emërtimi i Rrugës | Gjatësia | Fondi i investimit | Financuar |
|---|---|---|---|---|
| 1. | Aeroport – Domaj | 10.2 km | 301,788,720 Lekë | Banka Evropiane e Investimeve |
| 2. | Kukës – Shishtavec (loti I) | 2.6 km | 252,267,000 Lekë | Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve |
| 3. | Kukës – Shishtavec (loti II) | 6 km | 1,186,572,960 Lekë | Banka Islamike për Zhvillim |
| 4. | Domaj – Lapaj | 11.5 km | 261,032,230 Lekë | Banka Botërore |
| 5. | Lapaj – Bushtricë | 7.2 km | 242,488,190 Lekë | Banka e Këshillit të Evropës |

Burimi: Këshilli i Qarkut Kukës

Bashkia Kukës në katër vitet e kaluara ka patur një investim në tre rrugë të qytetit me një total prej 900 m dhe investim nga buxheti i shtetit me vlerë 23 milion lekë.

## *5.2 Transporti*

Sipas të dhënave të mbledhura nga NjQV-të dhe Qarku Kukës, ZF Kukës është një zonë me tipare të forta koncentrike ku në përgjithësi ndërveprimet janë mes komunave aktuale dhe Kukësit si qendër e ZF dhe shumë pak mes komunave me njëra-tjetrën.

Në ZF të Kukësit transporti i udhëtarëve bëhet në mënyrë jo të rregullt. Lëvizja e qytetarëve bëhet kryesisht nga komunat në Kukës kjo për faktin se Kukësi është Qendër Qarkut dhe ku janë përqendruar institucionet kryesore shtetërore. Linjat kryesore të transportit të udhëtarëve me qendrat kryesore të vendit si Tiranë dhe Durrës bëhen nga Kukësi.

Mjetet kryesore të transportit janë minibusët dhe taksi, pasi transporti urban është shumë i kufizuar, pothuaj inekzitent. Këto për lëvizjet brenda zonës i.e. mes komunave ose mes komunave dhe Bashkisë Kukës.

Nga Kukësi në drejtim të Tiranës dhe Durrësit transporti është disi më i rregulluar. Janë dy kompani të licensuara që ofrojnë shërbimin ndërqytetas me autobusë. Shërbimi i transportit të udhëtarëve funksionon sipas këtij grafiku:

| **Linja** | **Orari** |
|---|---|
| Kukës - Tiranë | 7, 9, 13, 16, 18 |
| Tiranë - Kukës | 7, 9, 13, 16, 18 |
| Kukës - Durrës | 8, 11, 16 |
| Durrës - Kukës | 8, 11, 16 |

Burimi: Zyra e Shërbimeve, Bashkia Kukës

Transporti i udhëtarëve kryhet edhe me mjete si mjete 8+1 dhe mjete taksi, por këto nuk kanë orare të rregullta pasi lëvizin në varësi të nevojave dhe në mes të orareve të autobusëve. Bashkia Kukës ka dhënë 35 licensa për mjete 8+1 dhe vetëm një licensë për mjete 4+1.

Transporti urban është inekzistent në komuna dhe në Bashkinë e Kukësit, kjo edhe për faktin së janë njësi me sipërfaqe të vogla.

Nuk ka linja të dedikuara për shërbimin e transportit të qytetarëve nga komunat drejt Kukësit si qendër. Transporti nga Kukësi në komunat e afërta është i shpeshtë pothuaj cdo orë, kjo edhe për shkak se në këto komuna si Shtiqen, Bicaj, që janë afër, por edhe Ujmisht dhe Bushtricë që janë pak më larg kalojnë rrugë që lidhin qendra më të mëdha si Kukës – Peshkopi.

Komuna Kolsh për shkak të afërsisë që ka me Kukësin konsiderohet më shumë Lagje e Kukësit sesa Komunë më vete dhe pothuaj të gjitha shërbimet përfshi edhe ato të tregëtisë merren në qytetin e Kukësit. Ndërsa transporti nga komunat e tjera dhe kthim bëhet me mjete private. Transporti kryhet përmes mjeteve furgonë që janë rreth 6 të cilët lëvizin me orare jo të rregullta, por sipas nevojës. Megjithëatë duke qenë se nevojat janë, atëherë transporti është kthyer pothuaj i rregullt cdo 30 minuta.

Komuna Malzi duke patur një sipërfaqe të madhe dhe rrjedhimisht edhe shumë rrugë komunale, ka lëshuar 5 licenca për transportin e udhëtarëve për mjete 8+1. Oraret e nisjes nga qendra e komunës për në Kukës janë të rregullta. Nisja nga qendra e komunës për në Kukës bëhet në oraret 6, 7 dhe 8 ndërsa kthimi nga Kukësi në qendër të komunës në oraret 13, 14 dhe 15. Gjithashtu janë edhe dy mjete që ofrojnë shërbim transporti mes fshatrave të komunës.

Komuna Shishtavec e kryen shërbimin e transportit të udhëtarëve përmes mjeteve që levizin nga fshatrat për në Kukës. Cdo fshat ka një linjë të vetën nga Qendra e fshatit në Kukës në mëngjes dhe e njëjta linjë kthimi në drekë. Nuk ka një linjë transporti nga qendra e komunës në fshatra dhe anasjelltas. Transporti bëhet nga persona privatë.

Transporti në komuna të largëta dhe të thella është më i rrallë dhe kryhet nga Komuna drejt Kukësi në mëngjes dhe në drekë është kthimi nga Kukësi në Komuna. Me këtë frekuencë lëvizin banorët e komunave Arren dhe Grykë-Cajë. Grykë-Cajë ka herë pas here edhe mjet shtesë, por në të gjitha rastet nuk ka një orar të përcaktuar.

Komuna Surroj ka 3-4 furgona që ofrojnë shërbimin e transportit ku prioritar ngelet orari 7 nisja nga Komuna dhe 13 kthimi nga Kukësi.

Në shumicën e komunave, transporti brenda komunës nuk ekziston. Kjo detyron banorët që të udhëtojnë me orë për të shkuar nga një fshat në tjetrin. Ose nga një fshat në qendër të komunës për të marrë mjet dhe udhëtuar drejt Kukësit.

Sipas të dhënave nga Qëshilli i qarkut Kukës, janë këto linja që u janë dhënë licensat nga autoritetet përkatëse, të cilëve u është rezervuar edhe stacion qëndrimi në qytetin e Kukësit.

**Tabela 14: Linjat e Transportit**

| Emertimi I linjes | Emertimi I subjektit | Numri I orarave te sherbimit ne linje | Stacioni I nisjes |
|---|---|---|---|
| Kukes -Krume -Kukes | Skender Tobli | 1 | Tek "Shote Galica" |
| Kukes -Peshkopi- Kukes | Agim Halilaj | 2 | Stacioni i Bicajve |
| Kukes-Puke-Kukes | – | 2 | Tek "Shote Galica" |
| Kukes-Shkoder-Kukes | Vllezerit -Kopani | 2 | Ish hotel parku |
| KuKes -Durres-Kukes | Fat- 5 | 2 | Ish hotel parku |
| Kukes -Tirane-Kukes | Laci- Kompani | 2 | Ish hotel parku |
| Kukes - Lezhe -Kukes | – | – | Ish hotel parku |

Burimi: Qarku Kukës.

## Rekomandime për Infrastrukturën dhe transportin

- **Inventarizimi:** Megjithëse ka disa të dhëna për inventarin e rrugëve në ZF Kukës, përsëri ngelet *prioritare inventarizimi* i menjëhershëm dhe kategorizimi i rrugëve duke marrë në konsideratë ristrukturimin e njësive të qeverisjes vendore. Ristrukturimi i NjQV do të bëjë të domosdoshme jo vetëm kategorizimin e rrugëvë sipas rëndësisë dhe fluksit, por edhe sipas pronësisë dhe administrimit. Ky hap duhet të ndërmerret menjëherë sapo të fillojë mandatin administrata e re.

- **Hartimi i strategjisë rrugore:** Gjithashtu administrata e re e NjQV duhet të *hartojë një strategji* për zhvillimin e ZF duke konsideruar investimet në rrugë. Sipas të dhënave nga NjQV-të dhe analizës së përgjithshme, duhet patur parasysh se jo të gjitha rrugët kanë të njëjtin intensitet transporti.

- **Siguria njerëzore:** Duhet prioritarizuar rrugët më problematike nga ana e *sigurisë njerëzore* dhe të ndërhyhet në sigurimin e tyre. Shtrimi me asfalt i te gjitha rrugëve sigurisht që do të ishte zgjidhja më e mirë, por dihet që është i kushtueshëm, sidomos për njësitë e reja që formohen, për këtë është e rëndësishme një *studim i hollësishëm* i efektit të sistemit rrugor në kohezionin social dhe ekonomik te Zonës Funksionale, por nga ana tjetër edhe një studim për rehabilitimin dhe përmirësimin e rrugëve problematike për sigurinë e njerëzve.
- **Përllogaritje e kostos:** Gjithashtu duhet të merret në konsideratë përllogaritja e kostove për mirëmbajtjen e rrugëve e studiuar dhe hartuar nga FShZh, e cila aktualisht nuk zë vend dhe nuk mund të përfshihet në asnjërën nga njësitë përbërëse të ZF. Kjo do të ndihmonte në maksimizimin e efikasitetit të financimeve, duke bërë të mundur një plan për mirëmbajtjen e rrugëve dhe jo thjesht financime kur situata bëhet alarmante.

- **Nyjet lidhëse:** Prioritet duhet t'i jepet nga NjQV e re *studimit të ndërthurjeve* të rrugëve dytësore me ato kryesore dhe sidomos autostradën Milot – Morinë. Në vende të ndryshme hyrjet dhe daljet nuk janë sipas standarteve gjë që përbën rrezik për jetën e qytetarëve.

- **Mobiliteti i banorëve:** Të kryhet një studim më i hollësishëm në lidhje me mobilitetin e banorëve, por edhe me nevojat e tyre për transport. Duke qenë se qyteti i Kukësit është qendra e jetës së ZF, të studiohet mundësia e shtimit të mjeteve që qarkullojnë drejt dhe nga Kukësi. Të studiohet formalizimi i linjave të trasnportit publik e të monitorohet dhënia e licensave për një trasport sa më të rregullt dhe pa probleme për banorët.

- **Linja urbane:** Mund të shihet mundësia e vendosjes së një linje transporti urban për qytetin e Kukësit, por edhe me komunat e afërta Bicaj, Shtiqen dhe Kolsh. Ky mund të jetë një projekt i shpejtë, pasi transporti me këto komuna është mjaft i shpeshtë dhe ka shumë ndërveprim mes këtyre komunave. Të nxitet sektori privat (përmes rregulloreve dhe lehtësirave të ndryshme që mund të miratohen nga këshilli bashkiak) për të shtuar orët e lëvizjes edhe pas-dite në zonat periferike. Një studim dhe planifikim për lëvizjen urbane duhet të kryhet edhe për lehtësimin e lëvizjes së banorëve mes komunave ekzistuese dhe mes fshatrave.

- **Hartëzimi i pikë ndalesave:** Të kryhet një studim edhe për planifikimin e pikë ndalesave të mjeteve që transportojnë banorët duke i dhënë mundësi që të funksionojnë me stacione të rregullta dhe në këtë mënyrë edhe përmirësim i orareve dhe transportit në përgjithësi.

## 5.3 *Shërbimi i pastrimit dhe menaxhimit të mbetjeve*

Në ZF të Kukësit shërbimi i menaxhimit të mbetjeve është shumë i kufizuar dhe lë shumë për të dëshiruar. Komunat në përgjithësi nuk e kanë këtë shërbim dhe kufizohet kryesisht në mbledhje të mbeturinave sipas një grafiku i cili nuk është i rregullt por sipas nevojave. Të gjitha komunat e kontaktuara ankohen për mungesë kapacitetesh financiare për të ofruar shërbimin dhe mungesë të ndërgjegjësimit të banorëve. Komunat vuajnë mungesën e mjeteve dhe të pikave të grumbullimit të mbetjeve në lagjet ose fshatrat e komunës. Në komunat ku ky shërbim ofrohet i cunguar (Shishtavec, Terthore) grumbullimi i mbeturinave bëhet me punonjës të komunës dhe me mjete të vogla, por jo mjete teknollogjike. Komuna Shishtavec shpenzon një shumë modeste për gjithë shërbimin e pastrimit 200 000 Leke/vit. Komunat kanë venddepozitime për mbetjet. Këto venddepozitime janë thjesht të miratuara nga këshillat e njësive përkatëse, por realisht nuk kanë standarte ose nuk mund te konsiderohen venddepozitime te mirëfillta.

Harta 12: Venddepositimet e Mbetjeve Urbane




Komuna Shishtavec mundohet të ketë një shërbim sa më të mirë të trajtimit të mbetjeve për faktin se është komunë që i ka kushtuar goxha vëmendje zhvillimit të turizmit malor. Komuna ka një venddepozitim në Madenë dhe ka vendosur një tarifë prej 100 lekë për familje ku përqindja e arkëtimit është me një maksimum 20%. Gjithsesi shërbimi nuk i ofrohet gjithë banorëve dhe përqindja e mbulimit të shërbimit është 5%. Mbikqyrja e shërbimit e cila korrespondon edhe me njoftimet komunës për të bërë largimin e mbetjeve kryhet përmes kryepleqve të fshatrave.

Në komunat e tjera shërbimi nuk ekziston. Duke qenë se komunat në përgjithësi kanë konsum të prodhimeve organike, banorët në shumicën e rasteve i trajtojnë vetë mbetjet duke i groposur. Por duke mos patur plane të mirëfillta kompostimi, menaxhimi i mbetjeve ngelet problemtaik në komuna. Kjo vlen edhe për komunat që e ofrojnë këtë shërbim, pasi jo gjithmonë banorët dërgojnë mbetjet në vendet e caktuara. Problematikë vazhdon të mbetet ndërgjegjesimi i banorëve të komunave në lidhje me mbetjet plastike dhe amballazhet. Shpesh nëse nuk groposen (që në vetvete paraqet problemet e veta) ato hidhen në lumej ose përrenj ose në vende të hapura.

Njësia e vetme më e koordinuar në këtë aspekt është Bashkia Kukës. Për depozitimin e mbetjeve ka një venddepozitim që shërben për hedhjen e mbeturinave që mblidhen në nga Bashkia.

Venddepozitimi për bashkinë Kukës, ndodhet në një distancë prej rreth 12 km larg Bashkisë dhe ndodhet në Myc-Mamëz, pjesë e Komunës Kolsh. Sipas bashkisë venddepozitimi në Mamëz ka një sipërfaqe prej 9000m2 dhe një kapacitet prej 45000tonësh. Jetëgjatësia e venddepozitimit mendohet të jetë 15 vjet por gjithmonë në varësi të efikasitetit të shfrytëzimit, përpunimit të mbetjeve dhe të investimeve që mund të bëhen në të.

Ndërsa në lidhje me Bashkinë Kukës, shërbimi i pastrimit të qytetit realizohet nga sektori i pastrimit pra ndërmarrje publike që funksionon në kuadër të Drejtorisë së Shërbimeve Publike të Bashkisë Kukës. Tarifa e shërbimit të pastrimit për familjarët është që nga viti 2010 e në vazhdim është 1200 lekë për familje në vit, ndërsa për bizneset dhe institucionet ndahet si më poshtë:.

| Tarifa mesatare ne lek | 2012 |
|---|---|
| Familjet | 1200 |
| Biznesi i vogel | 10000 |
| Biznesi i madh | 60000 |
| Institucionet | 60000 |

Burimi: Drejtoria e Shërbimeve – Bashkia Kukës

Shërbimi i ofrohet 4200 familjeve, në lagjen e re bashkia ka aplikuar një sistem për grumbullimin e mbeturinave në banesë, meqë janë shtëpi të reja tip vilash, 338 Bizneseve dhe 30 institucioneve.

Sipas të dhënave nga Drejtoria e Shërbimeve, prodhimi i mbetjeve është 4800 ton mbetje urbane në vit dhe 2600 ton mbetje inerte në vit:

| Vitet | 2012 | 2013 |
|---|---|---|
| Mbetje urbane | 4700 ton | 4800 ton |
| Mbetje inerte | 2500 ton | 2600 ton |

Burimi: Drejtoria e Shërbimeve – Bashkia Kukës

Mbetjet inerte që prodhohen nga qytetarët me punimet e ndryshme që kryhen transportohen dhe depozitohen në gropen e mbetjeve të inerteve në dalje te qytetit perballë varrezave publike. Kjo grope mirmbahet nga firma private "Marsi" e kontraktuar nga Bashkia.

Mbetjet spitalore trajtohen nga një firmë e kontraktuar nga Spitali Rajonal Kukës e specializuar për përpunimin e këtyre mbetjeve.

Grumbullimi i mbetjeve urbane grumbullohen nga bashkia cdo ditë për bizneset dhe familjet, ndërsa mbetjet inerte një herë në javë.

Problematike për Bashkinë e Kukësit, por edhe më gjerë ngelet Liqeni i Fierzës. Liqeni konsiderohet qoftë nga Bashkia por edhe nga Qarku si aset me potenciale zhvillimi turistik. Por në të njëjtën kohë është edhe nje potencial mbetjesh, sidomos plastike për shkak të hedhjes së mbetjeve në këtë liqen dhe në lumejtë që e furnizojnë. Ky është problem që vjen edhe për shkak të ndotjeve nga komunat fqinje dhe ato të Kosovës. Kjo situatë është mjaft problematike për bashkinë dhe qarkun.

Struktura e Ndërmarrjes së pastrimit në Bashkinë Kukës konsiston në një numër prej 14 punonjësish nga te cilet 2 punojne ne administrate, 10 ne ngarkim shkarkim dhe 1 ne transport.

Shërbimi i pastrimit nga ndërmarrja e pastrimit të Bashkisë konsiston edhe në fshirjen e rrugëve dhe trotuareve të cilat fshihen dhe pastrohen cdo dite. (Informacioni i dhënë nga Bashkia është cdo dite, por arësyetimi logjik është që në ditët me reshje shiu ose dëbore, ky shërbim nuk ofrohet). Sasia e rrugëve dhe e trotuareve të pastruara është 70 000 m2 për gjithë territorin e bashkisë. Gjatë tre muajve të verës 35 000 m2 rrugë lagen me një frekuence 2 herë në ditë.

Shërbimi i grumbullimit të mbetjeve ka infrastrukturë prej 180 kontenierësh 1.2 m3 të cilët janë instaluar që në vitin 2005 e në vazhdim nga të cilët 100 janë në gjendje të mirë, ndërsa 80 të tjerët në gjendje jo të mirë. Transporti nga kontenierët në venddepozitimi bëhet me tre kamionë ku 2 janë tip Iveco Teknollogjike 3.5 ton (viti i prodhimit 1996) secili dhe një tip Mercedes Benz (viti i prodhimit 1992) me nje kazan 7 tonësh.

| Lloji | Kapaciteti | Njësia | Sasia | Gjendja |
|---|---|---|---|---|
| Kontenierë | 1.2 m3 | copë | 180 | 100 mirë/ 80 amortizuar |
| Kamion | 3.5 ton Teknollogjik | copë | 2 | Amortizuar (prodhim 1996) |
| Kamion | 7 ton | copë | 1 | Amortizuar (prodhim 1992) |

Burimi: Drejtoria e Shërbimeve – Bashkia Kukës

Këto tre automjete përdoren për grumbullimin dhe transportin e mbeturinave në gropën e mbetjeve urbane në Mamëz. Qyteti është ndarë në tre zona ku çdo mjet ka brigaden e punëtorëve në dispozicion. Mjetet punojnë paralelisht në një orar të caktuar për marrjen e mbetjeve urbane.

Ndërsa në venddepozitim punimet kryhen me një traktor tip Caterpillar, i cili punon për përpunimin e mbetjeve urbane në gropën përkatëse në Mamëz. Lëviz mbetjet urbane duke shfrytëzuar të gjithë hapësirat e gropës në mënyre periodike dy herë në javë.

Nuk ekziston një plan riciklimi apo kompostimi mbetjesh, megjithëse si kudo në shqipëri persona të ndryshëm tërheqin nga kontenierët materialet plastike dhe metalike, për t'i dërguar në njësi ekonomike që merren me trajtimin e tyre.

Sipas të dhënave nga Drejtoria e Shërbimeve pranë Bashkisë Kukës kostoja për shërbimin e pastrimit për vitin 2012 kanë qenë 14 500 mijë lekë ose rreth 15% e buxhetit të përgjithshëm operativ të Bashkisë. Kjo kosto mbulohet në masën 70% nga Granti i pakushtëzuar dhe 30% nga tarifat

| **Tabela 15: Buxheti ne 000/lek** | 2012 |
|---|---|
| Buxheti i alokuar për shërbimin e pastrimit dhe menaxhimin e mbetjeve | 14500 |
| Buxheti total operativ vjetor i bashkisë | 97400 |
| Nga transferta e pakushtezuar | 70 % |
| Nga taksat dhe tarifat | 30 % |

Burimi: Drejtoria e Shërbimeve – Bashkia Kukës

Gjithsesi përqindja e pagesës së tarifave është e kënaqshme, por mbulimi i kostos së shërbimit me tarifë nuk është i kënaqshëm.

**Tabela 17: Te dhena per bilancin e pagesave**

| Numri I subjekteve | **2012** | | **Përqindja e mbledhur** |
|---|---|---|---|
| | **Faturuar (lek)** | **Paguar (lek)** | |
| Familjet | 4000 | 3550 | 88.75% |
| Biznesi i vogel | 2600 | 2750 | 105.77% |
| Biznesi i madh | 3500 | 4100 | 117.14% |
| Institucionet | 3500 | 1557 | 44.49% |

Burimi: Drejtoria e Shërbimeve – Bashkia Kukës

Në kuadër të një studimi të bërë nga SELEA ku dhe bashkia Kukës ka qenë pjesëmarrëse në të dhënat në lidhje me një kostim të shërbimit të pastrimit për një vit në Bashkinë Kukës, kemi si më poshtë:

**Tabela 16: Preventivi i Kostos per sherbimin e pastrimit**

| | **Struktura** | **Njesia** | **Paga/Sasia** | **Vlera/muaj** |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Pergjegjes | 1 | 35000 | 35000 |
| 2 | Punetore | 20 | 30000 | 600000 |
| 3 | Shofer | 4 | 30000 | 120000 |
| 4 | Traktorist | 1 | 21000 | 21000 |
| | ***Shuma*** | | | ***755000*** |
| | **Shpenzime te tjera** | | | |
| 5 | Nafte /mjetet e transportit | litra | 1860 | 334800 |
| 6 | Nafte /traktori | | 500 | 90000 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 7 | Mirmbajtje mjete | | | 100000 |
| 8 | Mirmbajtje traktori | | | 10000 |
| 9 | Te ndryshme | | | 50000 |
| | ***Shuma*** | | | ***584800*** |
| | ***Shuma gjithsej*** | | | ***1339800*** |
| | | | | |
| | **Shuma per 1 vit** | | | **16077600** |

Burimi: Drejtoria e Shërbimeve – Bashkia Kukës (sipas një pyetësori për SELEA)

**Rekomandime për sektorin e menaxhimit të mbetjeve**

- **Plani i menjëhershëm:** NjQV e re duhet të miratojë sa më shpejt një plan të për menaxhimin e mbetjeve në komuat ekzistuese. Kjo do të vijë në bazë të një studimi për menaxhimin e mbetjeve dhe ndërgjegjësimin e popullsisë për një gjë të tillë. Duke patur parasysh situatën aktuale në komuna ku menaxhimi bëhet sipas vullnetit të popullsisë, vlen të theksohet se ky hap është shumë i rëndësishëm dhe duhet të jetë i menjëhershëm.

- **Menaxhimi:** Nga ana menaxheriale rekomandohet qe menaxhimi i mbetjeve të kalojë me sipërmarrje private duke vendosur standartet vetë NjQV-ja. Një menaxhim i tillë ka rezultuar më efikas në eksperiencën e NjQV-ve të mëdha ekzistuese në Shqipëri.

- **Infrastruktura**: Nga ana infrastrukturore, duhen theksuar disa gjëra. Nuk ka një shifër të saktë të prodhimit të mbetjeve nga ana e komunave në tërësi. Por duke patur parasysh edhe përbërjen e popullsisë dhe gjendjen ekonomike, mund të thuhet se ndërtimi i stacioneve të ndërmjetëm do të kishte një kosto të lartë dhe nuk do të kishte sens ekonomik. Për këtë rekomandohet që grumbullimi i mbetjeve në komunat ekzistuese të bëhet fillimisht në pika të caktuara nëpër komuna.

- **Investimet**: Fillimisht mund të fillohet me pika mbledhjeje betoni, për të kaluar më vonë në kontenierë. Duke konsideruar shtrirjen dhe numrin e fshatrave mund të fillohet me një minimum prej 200 pikash grumbullimi të mbetjeve në fshatra. Rekomandohet që marrja e mbetjeve të kryhet më mjete teknollogjike. Për këtë është e rëndësishme investimi në të paktën 4 kamionë shtesë që do të kryejnë këtë shërbim. Kamionët do të bëjnë itinerare të marrjes së mbetjeve sipas një grafiku të caktua fillimisht një herë në javë sipas këtyre grupimeve: Shtiqen, Bicaj, Ujmisht, Bushtricë, Grykë-Cajë dhe Kalis 1 kamion. Topojan, Zapod dhe Shishtavec 1 kamion. Surroj, Arren dhe Kolsh 1 kamion. Malzi ngelet një rrugë më vete me një kamion për vetë specifikën e vendndodhjes. Në varësi të mundësive mund të konsiderohet edhe një studim për përdorimin e dy kamionëve për të kryer mbledhjen sipas grupimeve të mësipërm por me frekuencë 2 herë në javë.

- **Ndërgjegjesimi**: megjithëse disa komuna praktikojnë groposjen e mbeturinave, nga njëra anë është pozitive, pasi shumica e mbetjeve janë organike, por nga ana tjetër përbëjnë problem për mjedisin. Në këtë kontekst është e rëndësishme ndërgjegjësimi i banorëve që të vazhdojnë një praktikë të tillë por duke bërë një ndarje të mbetjeve në të biodegradueshme dhe në jo të biodegradueshme. Duke bërë kompostimin e të biodegradueshmeve dhe depozitimin në vende të caktuara të të tjerave. Punë ndërgjegjësuese rekomandohet të bëhet edhe në lidhje me nevojën për pagesën e tarifës nga banorët e komunave që nuk janë mësuar me këto tarifa.

- **Tarifimi**: rekomandohet një studim i hollësishëm për kostimin e shërbimit të pastrimit në të gjithë elementët e tij dhe një diferencim i tarifës së këtij shërbimi për zonën urbane dhe atë rurale në varësi të ofrimit të shërbimit. Duhet të merren në konsideratë kapacitetet paguese të tarifave të banorëve.

## 5.4 Shërbimi i Ujësjellës-Kanalizime

Në zonën funksionale të Kukësit ekziston ndërmarrja e ujësjellës kanalizime Kukës. Ndërmarrja ka formën ligjore ShA dhe i shërben qytetit të Kukësit dhe dy komunave përreth dhe përkatësisht Shtiqen dhe Bicaj. Analizimi i situatës dhe të dhënat janë të vlefshme për vitin 2013. Të dhënat mesatare për shërbimin janë që i shërben një popullsia rreth 40,000 banorë me një orar mesatar prej 9 orësh në ditë dhe një cilësi uji brenda normave.

Ndërmarrja ka një staf prej 70 punonjësish të ndarë në staf administrativ 12 dhe punonjës operativë 58.

Popullsia e zonës ku operon Ndërmarrja e UK është 40,000 banorë dhe ndërmarrja i shërben 100% të banorëve me shërbimin e ujësjellësit. Shërbimi i jepet 25,000 banorëve që jetojnë në qytet dhe 15,000 banorëve që jetojnë në fshatra. Sipas të dhënave për Kukës UK Sh.A. 39,600 banorë e marrin shërbimin në shtëpi, ndërsa 400 të tjerë në cezma publike. Ndërsa shërbimi i sistemit të ujërave të zeza i ofrohet vetëm banorëve të qytetit 100% ndërsa banorëve të komunave nuk i ofrohet fare ky shërbim.

Tabela 17: Numri i popullsise

| | |
|---|---|
| Popullsia qe jeton ne zonen e juridiksionit- ne Qytet | 25,000 |
| Popullsia qe jeton ne zonen e juridiksionit- ne Fshat | 15,000 |
| Popullsia qe jeton ne zonen e juridiksionit- Total | 40,000 |
| Popullsia qe faktikisht furnizohet me uje nga shoqeria/nj.admn.- ne Qytet | 25,000 |
| Popullsia qe faktikisht furnizohet me uje nga shoqeria/nj.admn.- ne Fshat | 15,000 |
| Popullsia totale qe faktikisht furnizohet me uje nga shoqeria/nj.admn.- Total | 40,000 |
| Popullsia qe sherbehet me lidhjeve ne banese | 39,600 |
| Popullsia qe sherbehet me çezma publike | 400 |
| Popullsia totale me lidhje ne sistemin e kanalizimeve | 25,000 |
| Popullsia me lidhje ne sistemin e kanalizimeve-ne Fshat | 0 |
| Popullsia me lidhje ne sistemin e kanalizimeve-ne Qytet | 25,000 |

Burimi: DPUK

Prodhimi i ujit është me rënie të lirë gjë që lehtëson kostot operative të ndërmarrjes. Gjatësia totale e sistemit të ujësjellësit është 115.6 km të cilat ndahen në 25.1 km tubacionet e rrjetit kryesor dhe 90.5 rrjeti dytësor ose shpërndarës. Sistemi kryesor dhe dytësor i tubacioneve përbëhet nga materiale të ndryshme sipas tabelës më poshtë.

| | |
|---|---|
| Gjatesia totale e tubacioneve prej çeliku (km) | 21 |
| Gjatesia totale e tubacioneve prej gize (km) | 88 |
| Gjatesia totale e tubacioneve prej polietilen-plastike (km) | 2.3 |
| Gjatesia totale e tubacioneve prej materialeve te tjera (km) | 4.3 |
| Gjatesia e linjave te rrjetit kryesor (km) | 25.1 |
| Gjatesia e linjave te rrjetit shperndares (km) | 90.5 |
| Gjatesia totale e rrjetit te ujit (km) | 115.6 |

Burimi: DPUK

Treguesit e shpërndarjes dhe faturimit të ujësjellësit për 2013 janë si më poshtë, ku sic shihet kemi një diferencë prej pothuaj 200 mijë m3 ose 17.5% të pafaturuar, e cila shkaktohet për shkak të dëmtimeve të rrjetit dhe carjeve të tubacioneve të cilat janë në një nivel shumë të lartë – 2681 carje në total

Tabela 19

| | |
|---|---|
| Vellimi neto i ujit ne sistemin e shperndarjes se zones se sherbimit (000 m3) | 965 |
| Vellimi total i ujit te faturuar tek klientet - Total (000m3) | 796.3 |

Burimi: DPUK

Ndërmarrja i shërben klientëve në Bashki (qytet) dhe në Komuna (fshat) dhe lidhjet me klientët janë lidhje me matësa dhe pa matësa. Ndërkohë që edhe faturimi i ujit bëhet sipas këtij sistemi. Klientët e UK ndahen në kliente familiarë, privatë dhe institucione. Ndarja e klientëve të lidhur me sistemin sipas llojit (me ose pa matës) dhe sipas vendodhjes (qytet ose fshat) është si vijon:

Tabela 20

| | |
|---|---|
| Nr. i lidhjeve te ujit - me mates - Total | 1,934 |
| Nr. i lidhjeve te ujit - pa mates -Total | 3,039 |
| Nr. total i lidhjeve te ujit ( me dhe pa mates) - Total | 4,973 |
| Nr. total i lidhjeve te ujit – Qytet | 3,434 |
| Nr. total i lidhjeve te ujit- Fshat | 1,539 |

Burimi: DPUK

Tarifa e ujit për m3 është për familiarë 25 lekë, për privatë 80 lekë dhe për institucione 60 lekë.

Cilësia e ujit është relativisht e mirë dhe brenda standarteve:

Tabela 21

| | |
|---|---|
| Nr. testimeve per Klorin Mbetes | 975.00 |
| Nr. kampioneve negative per Klorin Mbetes | 975.00 |
| Nr. testimeve per Koliform | 1,205.00 |
| Nr. kampioneve negative per Koliform | 975.00 |
| Norma e sigurise (Klori Mbetes) | 100% |
| Norma e sigurise (Koliforme) | 80.9% |
| Sasia e klorit qe konsumohet ne secilin muaj (kg) | 111.67 |

Burimi: DPUK

Problemi i mbulimit të ZF me shëerbimet e uje-sjelles kanalizimet ka qënë një nga pikat e kontesueshme në takimin e Forumit të ZF të mbajtur në 5 Mars 2015. Anetarët e Forumit gjatë procesit të validimit të të dhënave të mbledhura, patën disa objeksione në lidhje me mbulimin me shërbimin e ujësjellësit dhe të KUZ. Objeksionet kryesore konsistojnë në mbulimin me ujësjellës dhe kanalizime të zonës nën administrimin e ndërmrrjes sh.a. Ndërkohë që nga të dhënat e mësipërme dhe prezantimeve është e qartë që kanalizimet janë 0% e popullsisë në komunat Bicaj dhe Shtiqen. Ndërsa mbulimi me ujësjellës është objekti kryesor i diskutimit.

Duke bërë verifikimin në dokumentacionin e Ndërmarrjes Ujësjellës Knalizime sh.a., por edhe me të dhënat e vetë ndërmarrjes nga kontaktet direkte, të dyja këto të krahasuara me të dhënat e censusit 2011 kemi këto të dhëna:

**Tabela 22**

| NjQV | Nr. I Familjeve Total | Rrjet ujësjellësi brenda banesës | Rrjet ujësjellësi jashtë banesës, por në ndërtesë | Rrjet ujësjellësi jashtë ndërtesës | Sistem i llojit tjetër | Pa asnjë lloj sistemi | Përqindja brenda banesës mbi totalin |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Kukës | 3511 | 3458 | 21 | 26 | 2 | 4 | 98.5% |
| Bicaj | 1037 | 587 | 167 | 250 | 15 | 18 | 56.6% |
| Shtiqen | 584 | 450 | 36 | 89 | 9 | 0 | 77% |

Burimi: Instat Census 2011 dhe llogaritje të vetat

Krahasimi i mëposhtëm është bërë për efekt demonstrimi të të dhënave nga dy burimet që lidhet edhe me faktin se të dhënat janë marrë në periudha të ndryshme.

| NjQV | Rrjet ujësjellësi brenda banesës – Census | Rrjet ujësjellësi brenda banesës – sh.a. |
|---|---|---|
| Kukës | 3458 | 3434 |
| Bicaj | 587 | 859 |
| Shtiqen | 450 | 680 |

Sipas të dhënave të mësipërme censusi nxjerr për Bashkinë e Kukësit një përqindje shumë e lartë e furnizimit me ujë në banesa gjë që ishte pjesë e diskutimeve në forum. Diskutimet e forumit nxirrnin furnizim me ujë në Kukës rreth 60-70% të popullsisë, gjë që nuk mbështetet as nga të dhënat zyrtare të ndërmarrjes dhe as nga censusi 2011. Gjithsesi, sipas informacioneve nga Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës Kanalizime ka patur të paktën një investim në Kukës, i cili ka qenë pas periudhës së censusit 2011, në ujësjellësin e Kukësit dhe 14 fshatrave përreth, gjë që justifikon edhe ndryshimet e mësipërme.

Megjithëse është e qartë që në zonë ka problematika problematika që kanë të bëjnë me zonat informale dhe të drejtat e pronësisë mbi kanalizimet dhe tubacionet e ujësjellësit.

Kjo cështje duhet të mërret në konsideratë dhe të jetë një nga problemet që duhet të shihen më prioritet nga administrata e re me qëllim që të kenë një hartë të qartë të shërbimeve duke përfshirë të gjithë zonën, përfshirë edhe zonat informale.

Situata me shërbimin e KUZ paraqitet ndryshe, pasi sic u tha më lart ky shërbim i ofrohet vetëm qytetit në masën 100%. Gjatësia totale e sistemit është 32 km dhe e gjitha është material prej betoni. Numri total i lidhjeve me sistemin është 3,434. Vëllimi total i ujit që faturohet për KUZ është 459.9 mijë m3.

Kostoja totale e operimit të UK është 51,154,700 lekë. Vetëm 30,897,100 lekë arrihet të faturohet pra rreth 60.4% e shërbimit arrin të faturohet. Nga kjo pjesën më të madhe të faturimit e ka ujësjellësi (26,498,000 lekë).

Norma mesatare e arkëtimit është 55,3%.

Ndërsa në komunat e tjera shërbimi i ujësjellësit është komunal (Shishtavec, Terthore, Kolsh, Malzi, Topojan, Ujmisht, Grykë-Cajë, Arren, Surroj). Nuk ka informacion për komunat Zapod, Bushtricë dhe Kalis. Furnizimi i banorëve me ujë në disa fshatra bëhet përmes cezmave publike gjë që e bën mjaft të vështirë situatën e banorëve në komuna.

Në komunën e Shishtavecit ka 1460 familje nga të cilat 1370 kanë akses në shërbimin e ujësjellësit të komunës. Nga këto 1350 familje janë të lidhura direkt me sistemin e ujësjellësit. Sistemi parësor i ujësjellësit ka gjatësi 18km dhe është cilësi e mirë pasi ka përfunduar në 2014. Ka një gjatësi prej 2 km të tjera që është cilësi e dobët për shkak të materialit të përdorur (gizë) dhe kohës së investimit (viti 1975). Gjatësia e rrjetit dytësor është 55 km. Shërbimi jepet nëpërmjet 7 rezervuarëve ku njëri është kryesori me kapacitet 300m3 dhe të tjerët janë 2 me kapacitet 100m3 dy me kapacitet 30m3 dhe dy me kapacitet 20m3. Këto të fundit janë të

shpërndarë nëpër fshatra për të ofruar një cilësi sa më të mirë. Burimi kryesor i ujësjellësit është në Kallabak me kapacitet 15 l/s dhe ka edhe burime të tjera më të vogla në Pashtrec, Prrena, Cernaleve dhe Moravë.

Struktura e menaxhimit është një strukturë e ngritur pranë komunës – sektori i ujësjellësit i cili përbëhet nga 5 persona.

Indeksi i prodhimit të ujit është 120% dhe nga kjo 90% arrin të shitet. 70% e ujit të faturuar arrin të arkëtohet. Cmimi i ujit është 40 lekë/m3 deri në 15m3, mbi këtë normë është 400lekë/m3.

Nga shpenzimet kryesore të Ujësjellësit 80% arrin të mbulohet nga arkëtimet ndërsa pjesa tjetër nga granti i komunës. Cilësia e shërbimit me ujë është e mirë dhe arrin deri në 20 orë furnizim në ditë.

Në komunën e Shishtavecit funksionon edhe sistemi i KUZ ku ky shërbim i ofrohet 70% të popullsisë. Shpenzimet për këtë shërbim mbulohen nga grantet e komunës.

Ndërsa komuna Terthore nga 310 familje, 305 kanë akses në shërbimin e ujësjellësit të komunës.

Ndërsa komuna Kolsh i ofron shërbimin gjithë banorëve të komunës përmes 3 ujësjellësve të vegjël. Menaxhimi është shumë problem për këtë komunë pasi nuk ka një ndërmarrje të mirëfilltë për menaxhimin e ujësjellësit në komunë. Banorët paguajnë një tarifë për të mirëmbajtur sistemin përmes personave privatë. Gjithashtu ka probleme me pagesën e faturave të energjisë.

Komuna Malzi i ofron shërbimin 80% të popullsisë përmes 6 ujësjellësve me një mesatare 6 orë në ditë furnizim. Të gjithë ujësjellësit në këtë komunë janë me rrjedhje të lirë e rrjedhimisht nuk kanë kosto energjie. Depozita më e madhe ajo e Shëmrisë ka një kapacitet 200m3 ujë.

Vetëm dy fshatra dhe si rrjedhojë dy ujësjellësa faturojnë ujin me matësa me një tarifë 15 lek/m3 me një mesatare prej 70% pagesë tarifash. Nërsa pjesa tjetër nuk faturohet. Unjësjellësi menaxhohet nga Komuna.

Komuna Arren shërbehet përmes 3 ujësjellësave që i shërbejnë 75% të popullsisë gjithë ditën. Rrjeti i shpërndarjes përbëhet nga 12 km tubacione primare dhe 5.5 km tubacione sekondare. Ujësjellësi menaxhohet nga komuna, por meqenëse është me rrjedhje të lirë dhe nuk ka kosto të energjisë elektrike, menaxhimi është minimal. Nuk merret tarifë për ujin.

Komuna Grykë-Cajë shërbehet nga 2 ujësjellës që i shërbejnë 45% të popullsisë. Ujësjellësi menaxhohet nga komuna, por meqenëse është me rrjedhje të lirë dhe nuk ka kosto të energjisë elektrike, menaxhimi është minimal. Nuk merret tarifë për ujin.

Komuna Surroj shërbehet përmes 3 ujësjellësve të cilët janë me rrjedhje të lirë. Furnizimi me ujë është rreth 6 orë në ditë dhe furnizohet 60% e popullsisë. Përvec rrjetit që furnizon shtëpitë, ujësjellësi furnizon edhe 84 cesme familjare ose publike. Ujësjellësi menaxhohet nga komuna, por meqenëse është me rrjedhje të lirë dhe nuk ka kosto të energjisë elektrike, menaxhimi është minimal. Nuk merret tarifë për ujin.

Komuna Ujmisht i shërben banorëve me 2 ujësjellës që mbulon rreth 60 % të popullsisë. Ujësjellësi menaxhohet nga komuna, por meqenëse është me rrjedhje të lirë dhe nuk ka kosto të energjisë elektrike, menaxhimi është minimal. Nuk merret tarifë për ujin.

Komuna Topojan i shërben banorëve me 2 ujësjellës që mbulojnë rreth 45% të popullsisë ose 4 fshatra. Ka një rrjet kryesor prej 10 km dhe është në gjendje të mirë. Ujësjellësi menaxhohet nga komuna, por meqenëse është me rrjedhje të lirë dhe nuk ka kosto të energjisë elektrike, menaxhimi është minimal. Nuk merret tarifë për ujin.

Sipas informacioneve nga NjQV-të dhe Administrata e Qarkut burimet nga ku merret uji për Ujësjellësin e Kukësit sh.a. por edhe burimet e tjera nuk kanë rrezik kontaminimi, megjithëse ZF është zonë me potenciale minerare. Burimet janë burime gëlqerore.

Kjo cështje duhet të mërret në konsideratë dhe të jetë një nga problemet që duhet të shihen më prioritet nga administrata e re me qëllim që të kenë një hartë të qartë të shërbimeve duke përfshirë të gjithë zonën, përfshirë edhe zonat informale.

**Rekomandime për shërbimin e Ujësjellës Kanalizime**

- **Riorganizimi:** Sipas disa treguesve dhe deklaratave të ministrisë së linjës po mendohet që prodhimi dhe trajtimi i ujit të kalojë funksion i pushtetit qendror. Nëse ndodh një gjë e tillë atëherë i takon ndërmarrjes shtetërore për të bërë planifikimin dhe përmirësimin e shërbimit.

- **Menaxhimi:** Nëse një gjë e tillë nuk ndodh atëherë do ishte me shumë rëndësi një mundësi e përfshirjes së ujësjellësve komunalë në ndërmarrjen sh.a. ekzistuese të Kukësit. Kjo do të mundësonte një menaxhim më të mirë të gjithë ujësjellësve dhe rrjedhimisht një shërbim më të mirë dhe efikas banorëve.

- **Kontrolli sanitar:** për shkak të strukturave menaxheriale të ujësjellësve në komuna, kontrolli dhe testet e ujit që shpërndahet nuk bëhet, megjithëse cilësia e ujit në komuna është e mirë dhe nuk janë raportuar raste sëmundjesh për shkak të ujit. Gjithsesi rekomandojmë që të bëhet një grafik për kontrollin dhe testimin e ujit. Gjithashtu rekomandojmë edhe krijimin e sistemit të nevojshëm për klorifikim dhe diszinfektim të ujit sipas standarteve.

- **Faturimi:** Problematike mbetet vjelja e faturave në komuna për arësye të gjendjes ekonomike të komunave, mentalitetit dhe edukatës së pagesës së shërbimeve. Të bëhet një studim për të gjetur mënyrën më efikase për vjeljen e faturave duke parë mundësitë e bashkëpunimit me institucione të tjerë që të funksionojnë si agjentë tatimorë (OSHEE për shembull).

- **Investime:** Në ato fshatra ku nuk ka unjësjellës rekomandohet që të kryhen investime. Sic del edhe nga analiza pothuaj të gjitha komunat përvec Kolsh i kanë ujësjellësat me renie të lirë. Rekomandojmë që të bëhet një studim fizibiliteti për mundësitë e mbulimit me shërbimin e ujësjellës të banorëve të komunave sipas objektivave të përgjithshëm të strategjisë kombëtare që synon mbulimin me 85% të popullsisë deri në 2017.

- **Kanalizimet:** Rekomandohet një studim i vështirësive dhe pengesave për ofrim të gjerë, me kanalizime të ujërave të zeza për të arritur synimin e vendosur në strategjinë kombëtare të ujit me 45% në 2017.

- **Zonat informale:** Rekomandohet një vlerësim sa më i saktë i të gjitha aplikimeve pranë zyrave të ALUIZNI-t dhe të verifikohen nëse janë të përfshirë në listat e sh.a. të familjeve dhe banorëve që marrin shërbimin. Kjo vlen kryesisht për Bashkinë aktuale të Kukësit, por rekomadohet të bëhet një studim më i detajuar i nevojave, mbulimit dhe i shoqeruar me një plan afatmesem-afatgjate të investimeve.

- **Të drejtat e pronësisë:** Rekomandohet një vlerësim dhe studim i pronësisë së kanalizimeve dhe tubacioneve, nëse janë të regjistruara si asete të NjQV-së apo jo. Ky është një proces që duhet ndërmarrë në mënyrë që të ketë edhe një inventar të aseteve të NjQV-së.

# 6. Organizimi strukturor i Bashkisë së re në përputhje me konceptin e Zonës Funksionale Kukës

Duke u bazuar ne organigramen ekzistuese te Bashkise se Kukesit, por gjithashtu edhe duke u bazuar ne analizate ekonomiko-sociale dhe shërbimeve publike te zonës funksionale rekomandohet që stafi i ZF të zgjerohet dhe të mund organizohet si më poshtë:

Duke qenë se ZF ka një numër të konsiderueshëm më të madh banorësh se bashkia aktuale, ndryshimet në strukturën e Njësisë janë të domosdoshme. Megjithëse ligji aktual 8652 e lë në diskrecion të Kryetarit zgjedhjen dhe emërimin e nënkryetarëve, praktika e zakonshme ka qenë që bashkitë të kenë një ose dy kryetarë. Nisur edhe nga analizat e bëra, rekomandohet që ZF të ketë dy nënkryetarë. Meqenëse ZF korrespondon 100% me Bashkinë e re të Kukësit sipas ligjit, kjo mundëson që rekomandimet të bëhen edhe duke respektuar gjithë dispozitat ligjore në fuqi, sidomos për njësitë administrative (ish-komunat).

Sipas rekomandimit me dy nënkryetarë, rekomandojmë që edhe Drejtoritë të ndahen nga aspekti i supervizimit si më poshtë:

Nënkryetar 1 - Drejtoria e Burimeve Njerezore, Drejtoria e Sherbimeve Sociale, Kulturore dhe Arsimit, Drejtoria e te Ardhurave, Drejtoria e Zhvillimit dhe One Stop Shop, Drejtoria e Marredhenieve me Jashte dhe e Koordinimit te NjA dhe Drejtoria e Sherbimeve te Brendshme.

Nënkryetar 2 - Drejtor i Drejtorise se Sherbimeve Publike, Drejtoria e Finances, Drejtoria Juridike, Prokurimit dhe Aseteve, Drejtoria e Planifikimit dhe Menaxhimit te Territorit

Sipas rekomandimeve të dhëna në studimin për shërbimet publike, shërbimi i pastrimit dhe menaxhimit të mbetjeve duhet të kalojë në shërbim të kryer me operatorë ekonomikë privatë. Duke konsideruar këtë fakt atëherë rekomandojmë që në strukturën e bashkisë të parashikohet një supervisor. Në ketë rast zyra e shërbimeve publike do të zvogëlohet dukshëm, por kjo niset nga arësyetimet ekonomike. Të njëjtin koncept rekomandojmë edhe për shërbimet e tjera si gjelbërimi dhe ndricimi, megjithëse do ngelet për t'u vendosur nga këshilli bashkiak se deri në cfarë niveli do shtrihen këto dy shërbime të fundit.

Duke qenë se Kukësi është bashki kufitare dhe gjatë viteve të fundit ka patur mjaft asistencë nga donatorët, por edhe përmes projekteve cross-border, rekomandojmë që të krijohen dy zyra me kompetenca më të gjera: a). Drejtoria e Zhvillimit dhe One Stop Shop dhe b). Drejtoria e Marredhënieve me jashtë dhe me Njesitë Administrative.

Duke qenë se do të ketë 14 Njësi Administrative në varësi të Bashkisë Kukës rekomandojmë se është e rëndësishme që të ketë një drejtori që të merret me problemet e këtyre njësive. Varësia e Njësive Administrative ngelet në diskrecion të Kryetarit, pasi edhe vetë amendimet e ligjit 8652, përkatësisht ligji 30/2015, parashikojnë që Administratorët e Njësive emërohen nga kryetari i Bashkisë, por gjithsesi menaxhimi i punës dhe procedurave që ata do të kryejnë dhe zbatojnë rekomandojmë që të bëhet përmes një drejtorie të vecantë përmes sektorit të koordinimit të Njësive Administrative.

Sipas analizës së bërë për shërbimet edhe shërbimi i mirëmbajtjes së rrugëve rekomandohet të bëhet përmes operatorëve ekonomikë private. Në këtë rast rekomandojmë që projektet dhe planet hartohen nga specialisti/tët e investimeve dhe infrastrukturës dhe pastaj përmes procedurave të prokurimeve të ofrohen nga operatorë private.

Në lidhje me strukturën e Njësisë Administrative në ish komuna duke konsideruar studimet edhe të ministrisë për Reformën Administrativo – Territoriale, është e qartë se nuk ka nevojë për staf back-office, por më tepër staf për të ofruar shërbimet bazë ndaj qytetarëve. Për këtë rekomandohet pozicioni i specialistit të zyrës me një ndalesë. Numri i këtyre specialistëve është në varësi të numrit të popullsisë në juridiksionin e NjA dhe sidomos edhe të nevojës që një njësi e caktuar ka për një shërbim të caktuar. Sipas studimeve nga organizatat ndërkombëtare, numri i shërbimeve që do ofrohen në nivel Njësie Administrative do rritet, pasi do ofrohen edhe shërbime që nuk janë ofruar më parë.

Rekomandohet që të ketë një inspektor tatim – taksash, pasi sipas strategjisë së Decentralizimit mundësia e rritjes së financave publike vjen edhe përmes shfrytëzimit dhe vjeljes së disa taksave që nuk janë vjelur deri tani, përfshi këtu edhe tarifa për shërbime të caktuara që nuk janë ofruar deri tani në komuna.

Rekomandojmë edhe një specialist për shërbimet publike, i cili në bashkëpunim të ngushtë edhe me Drejtorinë e Shërbimeve Publike, do të sigurojë që shërbimet publike ofrohen në zonë dhe raporton për probleme të mundshme që mund të dalin në ofrimin e shërbimeve.

Duke patur parasysh që njësitë administrative do ofrojnë edhe shërbime në vend dhe që mund të jenë shërbime online, rekomandojmë që në njësinë e re të ZF të krijohet edhe një sektor më vete për menaxhimin e teknologjisë informatike, qoftë të brendshme, qoftë edhe për praninë online. Gjithashtu ky sektor do të shërbejë edhe për lehtësimin e qeverisjes elektronike që mund të bëhet pjesë e shërbimeve të detyrueshme në një të ardhme.

Sipas ligjit 30/2015 njësitë administrative janë përgjegjëse edhe për administrimin e parqeve dhe zonave të gjelbëruara si dhe këndeve të lojrave, terrenet sportive bibliotekat etj. Për këtë arësye rekomandojmë edhe inspektor terreni që merret me evidentimin dhe raportimin në lidhje me problemet në terren për kompetencat sipas ligjit.

Derisa të zgjidhen cështjet ligjore për ujësjellësat sipas rekomandimeve të bëra, rekomandojmë që të ketë një punonjës mirëmbajtjeje ujësjellësi, i cili do të sigurojë mirëmbajtjen e rrjetit të ujësjellësve (sidomos avaritë emergjente për të mos ndërprerë për një kohë të gjatë shërbimin) në NjA, por edhe shërbime të tjera ujësjellësi, si klorifikim dhe marrje e dërgim kampjonesh për analiza.

Megjithëse shërbimi i mirëmbajtjes së rrugëve rekomandohet të bëhet me operatorë ekonomik privatë, rekomandohet që NjA të kenë punonjës mirëmbajtjeje rrugësh për mirëmbajtje rutinë, mbushje gropash dhe pastrime të ndryshme të rrugëve, sidomos ato rurale dhe brenda fsahtrave.

Më poshtë paraqitet në mënyrë skematike rekomandimi për strukturën e bashkisë (ZF) Kukës duke dhënë edhe ide të varësisë.

Figura 5 Skema Organizative e Propozuar per Bashkine e ZFK



# 7. VIZIONI I ZHVILLIMIT

Programi për Zhvillimin e Zonës Funksionale udhëhiqet nga një vizion i përbashkët ndryshimi dhe zhvillimi të metejshëm ***që në qëndër të tij ka përmirësimin mirëqenies, jetës së banorëve të zonës dhe zhvillimin e qëndrueshëm.***

***Vizioni afatgjatë***




Ky vizion mbeshtetet në tre shtylla kryesore te zhvillimit ekonomik : **Zhvillimin e Bujqsisë**, **Zhvillimin e Turizmit** dhe fuqizimin e mëtejshëm të **Industrisë Minerare**. Të tre këta sektorë do të mund të zhvillohen e fuqizohen më tej, nëpërmjet zhvillimit të **Infrastrukturës**, **Kapaciteteve të Tregut të Punës** dhe kapitalit njërëzor. I gjithë ky zhvillim do të mbaj parasysh dhe realizohet duke siguruar mbrojtjen e mjedisit dhe kontributin e mëtejshëm në zhvillimin e harmonizuar e të balancuar

Vizioni mund të realizohet përmes objektivave strategjikë të mëposhtëm dhe zbatimit të një plani të harmonizuar zhvillimi , i cili do të zbatohet nga aplikimi i instrumentave të shumtë financiarë si dhe përdorimi optimal dhe sa më eficent i burimeve financiare dhe humane.

## 7.1 Objektivat kryesore strategjike të zhvillimit të Zonës Funksionale

**OS1 – Rritja e kapacitetit prodhuese të ekonomisë së zonës funksionale, në mënyrë të vecantë në fushat me potenciale të mëdha për gjenerimin e të ardhurave dhe punësimin e popullsisë: Bujësi dhe Turizëm**

**OS2 – Zhvillimi i infrastrukturës së transportit brenda zonës funksionale për të siguruar lehtësi në mobilitetin e qytetarëve dhe mallrave, dhe akses më të madh në ZF.**

**OS3 – Përmirësimi i mëtejshëm i mjedisit natyror , duke ruajtur origjinalitetin e tij si zonë malore alpine dhe zhvillimi i tij i metejshëm për të rritur atraktivitetit e këtij mjedisi në funksion të zhvillimit të turizmit malor e liqenor**

**OS4 - Ristrukturimi institucional i Njësisë së Re, bazuar në parimet dhe kërkesat e reformës së re administrative, duke adoptuar një strukturë institucionale optimale dhe funksionale, që mundëson administrimin e duhur të shërbimeve dhe aktivitetit social të ZF.**

**OS5 – Zhvillimi i kapaciteteve dhe kapitalit human me qëllim sigurimin e kushteve të përshtatshme të zhvillimit të tregut të punës, përfshirjes sociale, dhe duke përmirësim mirëqenien e popullsisë në përgjithësi.**

Relaizimi i objektivave strategjike të mesiperme, do te materializohet nga zbatimi i Planit te Zhvillimit të Programit të ZFK i cili do të operacionalizohet nëpërmjet zhvillimit të programeve dhe projekteve të ndryshme të investimeve

# 8. Projekt – propozimet

Realizimi i Vizionit dhe objktivave strategjike do të realizohet nëpërmjet një plan fillestar veprimi që do të hartohet në bashkëpunim më administratën e re bashkiake.

Ky plan veprimi do të perfaqësoje dhe **Axhendën e Re për Ndryshim dhe Zhvillim** të mëtejshëm të Zonës Funksionale në aspektin afat-shkurter = afat-mesem.

Dokumenti i programit identifikon disa projekte të cilat grupohen në katër grupe kryesore:

- Zhvillimi Infrastruktures dhe Zhvillimit Urban
- Mbrojtja dhe Zhvillimi i Ambjentit
- Zhvillimi i Turizmit dhe Ekonomise Lokale
- Mbështetje sociale të grupeve në nevoje
- Ofrimi i shërbimeve dhe përmirësimi i aksesit në shërbimeve bashkiake e informim

## 1.1 Projekte ne fushen e Infrastruktures dhe Zhvillimit Urban

| 1. Titulli I projektit | Zbatimi i Programit për Zhvillimin e Infrastrukturës Rrugore dhe Transportit Urban |
|---|---|
| **Lloji I projektit** | *Infrastrukturore* |
| **Vendododhja e projektit** | *Zona Funksionale Kukes* |
| **Vlera e Buxhetit ne total** | *67,000 Euro (faza e pare)* |

### *1.* Sfondi dhe analizimi I projektit

Zona Funksionale e Kukësit ka në përberjen e saj 122.5 km rrugë rajonale, 181 km rrugë kombëtare, ndërkohë që mungon një inventar i saktë dhe kategorizim i rrugëve rurale. Cilësia e infrastrukturës rrugore lë shumë për të dëshiruar ku shume pak nga rrugët lokale janë të asfaltuara dhe pjesa tjetër është e pashtruar. Zonat më të largëta nga pikëpamja e udhëtimit janë: Arren, Ujmisht, Bushtrice, Gryke Cajë, Kalis ku koha e udhëtimit nga qendrat e këtyre komunave në Kukës është rreth 2.5 – 3 orë. Ndërsa mesatarja e pjesës tjetër të komunave me Kukësin është rreth 45 – 60 minuta.

ZF Kukës është një zonë me tipare të forta koncentrike ku në përgjithësi ndërveprimet janë mes komunave aktuale dhe Kukësit si qendër e ZF dhe shumë pak mes komunave me njëra-tjetrën. Transporti i udhëtarëve bëhet në mënyrë jo të rregullt. Lëvizja e qytetarëve bëhet kryesisht nga komunat në Kukës kjo për faktin se Kukësi është Qendër Qarkut dhe ku janë përqendruar institucionet kryesore shtetërore. Mjetet kryesore të transportit janë minibusët dhe taksi, pasi transporti urban është shumë i kufizuar, pothuaj inekzitent. Këto për lëvizjet brenda zonës i.e. mes komunave ose mes komunave dhe Bashkisë Kukës. Transporti urban është inekzistent në komuna dhe në Bashkinë e Kukësit, kjo edhe për faktin së janë njësi me sipërfaqe të vogla. Nuk ka linja të dedikuara për shërbimin e transportit të qytetarëve nga komunat drejt Kukësit si qendër. Transporti në komuna të largëta dhe të thella është më i rrallë dhe kryhet nga Komuna drejt Kukësi në mëngjes dhe në drekë është kthimi nga Kukësi në Komuna.

### 2. Objektivi kryesor i projektit

***Zhvillimi i një sistemi të intëgruar të infrastrukturës së transportit më qëllim lehtësimin e lëvizjes së qytetarëve nga Qendra e Zonës Funksionale drejt përiferive dhe anasjelltas.***

### 3. Objektivat specifike të projektit

**OS1:** Përmirësimi i infrastrukturës së rrugore dhe asaj të transportit
**OS2:** Sigurimi i një situate të qartë të kategorive të rrugëve në Zonën Funksionale

**OS3:** Përmirësimi i shërbimit të transportit urban nëpërmjet disiplinimit dhe krijimit të një sistemi lëvizjeje të mirëstudjuar

## 4. Rezultatet e pritura dhe treguesit e projektit

| | |
|---|---|
| R.1 | Inventari i rrugeve të ZF i ngritur |
| R.2 | Zhvillimi i infrastrukturës rrugore bazuar në një strategji të qartë ndërhyrjeje; |
| R.3 | Siguria rrugore e përmirësuar |
| R4. | Mobiliteti i lëvizjes së qytetarëve në të 15 NjQV i përmirësuar |
| R5: | Zhvillimi i infrastrukturës bazuar në sistem ekonomike eficente (kostoje) |

Përfitues të këtij programi janë gjithë NjQV dhe gjithë popullsia e ZF.

*Projekti mendohet te zgjase per nje periudhe 3 vjecare, pasi është konceptuar në formen e nje programi I cili do të mund të realizohet me dy faza. Faza e pare do fokusohet tek kryerja e studimeve dhe strategjise se ndërhyrjes dhe faza e dyte tek realizimi I ndërhyrjeve ne infrastrukturen rrugore dhe te transportit.*

*Kostoja e fazes së parë është përcaktuar më poshtë , kurse kostoja e fazes së dytë mund të përcaktohet vetëm pasi të kënë përfunduar studimet që do realizohen në fazën e parë.*

## 5. Aktivitetet e projektit

**Faza e Parë:**

1. Inventarizimi i menjëhershëm dhe kategorizimi i rrugëve duke marrë në konsideratë ristrukturimin e njësive të qeverisjes vendore.
2. Hartimi i strategjisë rrugore për zhvillimin e infrastruktures rrugore të ZF
3. Përllogaritje e kostos: Gjithashtu duhet të merret në konsideratë përllogaritja e kostove për mirëmbajtjen e rrugëve e studiuar dhe hartuar nga FShZh, e cila aktualisht nuk zë vend dhe nuk mund të përfshihet në asnjërën nga njësitë përbërëse të ZF. Kjo do të ndihmonte në maksimizimin e efikasitetit të financimeve, duke bërë të mundur një plan për mirëmbajtjen e rrugëve dhe jo thjesht financime kur situata bëhet alarmante.
4. Hartimi i studimit të ndërthurjeve të rrugëve dytësore me ato kryesore dhe sidomos autostradën Milot – Morinë. Në vende të ndryshme hyrjet dhe daljet nuk janë sipas standarteve gjë që përbën rrezik për jetën e qytetarëve.
5. Hartimi i një studim më i hollësishëm në lidhje me mobilitetin e banorëve, por edhe me nevojat e tyre për transport dhe hartëzimi i pikë ndalesave të mjeteve që transportojnë banorët.

**Faza e Dyte**

6. Vendosja e linjës së transportit urban për qytetin e Kukësit, por edhe me komunat e afërta Bicaj, Shtiqen dhe Kolsh.
7. Realizimi i ndërhyrjeve për përmirësimin dhe ndërtimin e infrastrukturës rrugore
8. Ngritja e Stacioneve të Ndalimit të Udhëtareve në Zonat Urbane dhe Ndërurbane;

Projekti mendohet te zbatohet per nje periudhe 3 vjecare

## 6. Maturimi I projektit

Mungojne  studimet e kesaj natyre ne zone.

## 7. Burimet e financimit dhe partneret e implementimit

Financuesit e projektit:

- Për t'u identifikuar

*Projekti do te zbatohet nga:*

- Bashkia Kukes
- Këshilli I Qarkut Kukës

## 8. Kostot e projektit ( ne Euro)

| *Nr.* | *Aktivitetet* | *Buxheti per aktivitet* |
|---|---|---|
| *1* | Inventarizimi i menjëhershëm dhe kategorizimi i rrugëve | 10,000 |
| *2* | Hartimi i strategjisë rrugore për zhvillimin e infrastruktures rrugore të ZF | 25,000 |
| *3* | Përllogaritja e kostove për mirëmbajtjen e rrugëve | 2,000 |
| *4* | Hartimi i studimit të ndërthurjeve të rrugëve dytësore | 10,000 |
| *5* | Hartimi i një studim më i hollësishëm në lidhje me mobilitetin e banorëve, por edhe me nevojat e tyre për transport. | **20,000** |
| *6* | **TOTALI** | **67,000** |

| 2. Titulli I projektit | Ndërtimi i Rruges turistike Topojan-Kroi i Kuq-Tërshenë-Bicaj |
|---|---|
| **Lloji I projektit** | *Infrastrukturore-Turistike* |
| **Vendododhja e projektit** | *Komuna Topojan dhe Bicaj* |
| **Vlera e Buxhetit ne total** | *200.000 Euro* |

### 1. Sfondi dhe analizimi I projektit

Turizmi është prioriteti kryesor i Strategjise Rajonale të Zhvillimit të Rajonit Kukës dhe zona e Gjallices është zona e dytë prioritare për zhvillimin e turizmit pas Shishtavecit. Me anë të projekteve të aplikuara deri tani, janë prekur pothuajse të gjitha zonat turistike të rajonit. Një ndër to janë edhe bjeshkët e Gjallices të cilat nuk kane akses infrastrukture të zhvilluar për ti eksploruar këto zona.

Kjo zonë gjatë gjithë stinës së verës frekuentohet shumë nga banoret e komunave përreth për të shfrytezuar këtë zonë mjaft të pasur bimore dhe kurative. Gjithashtu është rritur mjaft edhe numri i turisteve aventuresk në këto zona ende të pashfrytezuara. Domosdoshmeria e nje rruge ka lindur për të gjithë këto faktore edhe për faktin se edhe zona e Bicajve edhe zona e Topojanit kane të njejtat vlera të cilat jane mjaft larg në distance nga njera tjetra. Ngritja e infrastuktures dhe lidhja e këtyre dy zonave ndihmon në shfrytezimin e një kurore të larmishme në një kohë shumë më të shkurtër se ekzistuesja.

### 2. Objektivi(at) specifik te projektit

**OS1:** Shkurtimi i distancës dhe arritshmëri me e madhe e vendeve turistike
**OS2:** Ndërveprim dhe bashkëpunim nderkomunal
**OS3:** Rritja e numrit turistave vendas dhe te huaj dhe nxitja për investime në këto zona

### 3. Rezultatet e pritura dhe treguesit e projektit (maks 5-6 rreshta)

R.1 Infrastuktukture turistike te ngritur ne zonen e Gjallices.
R.2 Shkurton distancen dhe ul koston e transportit per zonat perreth
R.3 Shfrytezim racional te pasurive natyrore
R4. Rritje te numrit te turisteve vendas dhe te huaj

*Projekti mendohet te zgjase per nje periudhe 2 vjecare*

### 4. Aktivitetet e projektit

1. Hartimi i projektit teknik për ndërtimin e rrugës
2. Ndërtimi i rrugës (vepra arti, sinjalistike rrugore, turistike etj)

Projekti mendohet te zbatohet per nje periudhe 2 vjecare

### 5. Maturimi I projektit

Mungon nje studim i zones dhe eshte e domosdoshme te kryhet nje studim I tille per llojin e nderhyrjes perfshi percaktimin e shtigjeve turistike dhe sinjalistikes se nevojshme.

### 6. Burimet e financimit dhe partneret e implementimit

Financuesit e projektit:

- Nuk ka ende burime te percaktura

*Projekti do te zbatohet nga:*

- Agjencia e Zhvillimit Rajonal Kukes.
- Keshilli I Qarkut Kukes
- Bashkia Kukes

### 1. Kostot e projektit ( ne Euro)

| *Nr.* | *Aktivitetet* | *Buxheti per aktivitet* |
|---|---|---|
| *1* | Disenjimi i projektit për rrugën | 10.000 |
| *2* | Ndërtimi i rrugës (vepra arti, sinjalistike rrugore, turistike etj) | 175.000 |
| *3* | Trajnim stafit te dy komunave per promovimin e vlerave turistike | 5000 |
| *4* | Promovimi i vlerave natyrore te zones me ane te flete palosjeve, guida, dokumentare, aktivitete etj. | 10.000 |
| *6* | **TOTALI** | **200.000** |

| 3. Titulli I projektit | Zbatimi i Programit për Zhvillimin e Sistemit të Menaxhimit të Mbetjeve Urbane |
|---|---|
| **Lloji I projektit** | *Infrastrukturore - Mjedisore* |
| **Vendododhja e projektit** | *Zona Funksionale Kukes* |
| **Vlera e Buxhetit ne total** | *67,000 Euro (faza e pare)* |

### *1.* Sfondi dhe analizimi I projektit

Në ZF të Kukësit shërbimi i menaxhimit të mbetjeve është shumë i kufizuar dhe lë shumë për të dëshiruar. Komunat në përgjithësi nuk e kanë këtë shërbim dhe kufizohet kryesisht në mbledhje të mbeturinave sipas një grafiku i cili nuk është i rregullt por sipas nevojave. Mungesa e kapaciteteve financiare për të ofruar shërbimin dhe mungesë të ndërgjegjësimit të banorëve, shoqërohet edhe me mungesën e mjeteve dhe të pikave të grumbullimit të mbetjeve në lagjet ose fshatrat e komunës. Në komunat ku ky shërbim ofrohet i cunguar (Shishtavec, Terthore) grumbullimi i mbeturinave bëhet me punonjës të komunës dhe me mjete të vogla, por jo mjete teknollogjike. Komuna Shishtavec shpenzon një shumë modeste për gjithë shërbimin e pastrimit 200 000 Leke/vit. Komunat kanë venddepozitime për mbetjet. Këto venddepozitime janë thjesht të miratuara nga këshillat e njësive përkatëse, por realisht nuk kanë standarte ose nuk mund te konsiderohen venddepozitime te mirëfillta.

Problematikë vazhdon të mbetet ndërgjegjesimi i banorëve të komunave në lidhje me mbetjet plastike dhe amballazhet. Shpesh nëse nuk groposen (që në vetvete paraqet problemet e veta) ato hidhen në lumej ose përrenj ose në vende të hapura.

### *2.* Objektivi kryesor i projektit

**Përmirësimi i ambjentit dhe shëndetit të popullsië nëpëmjet pëmirësimit të menaxhimit dhe përpunimit të mbetjeve urbane**

### *3.* Objektivat specifike të projektit

**OS1:** Përmirësimi i skemës së menaxhimit të mbetjev urbanë
**OS2:** Promovimi i një sistemi të qëndrueshëm dhe ekonomikisht të përballueshëm i tarifimit të shërbimeve
**OS3:** Përmirësimi i infrastrukturës të grumbullimit dhe menaxhimit të mbetjeve urbanë,

### *4.* Rezultatet e pritura dhe treguesit e projektit

R.1 Skema e grumbullimit dhe menaxhimit të mbetjeve urbane e zhvilluar
R.2 Sistem tarifor ekonomikisht i qëndrueshëm i zhvilluar;
R.3 Infrastruktura e grumbullimit dhe menaxhimit të mbetjeve urbane e zhvilluar

Përfitues të këtij programi janë gjithë NjQV dhe gjithë popullsia e ZF.

*Projekti mendohet te zgjase per nje periudhe me shumë se 3 vjecare, pasi është konceptuar në formen e nje programi I cili do të mund të realizohet me dy faza. Faza e pare do fokusohet tek kryerja e studimeve dhe strategjise se ndërhyrjes dhe faza e dyte tek zhvillimi i sistemit te grumbullimit e menaxhimit te mbetjeve urbane*

*Kostoja e fazes së parë është përcaktuar më poshtë , kurse kostoja e fazes së dytë mund të përcaktohet vetëm pasi të kënë përfunduar studimet që do realizohen në fazën e parë.*

## 2. Aktivitetet e projektit

### Faza e Pare

Hartimi studimit për menaxhimin e mbetjeve dhe ndërgjegjësimin e popullsisë, duke përfhirë dhe studimin për kostimin e shërbimit të pastrimit në të gjithë elementët e tij dhe një diferencim i tarifës së këtij shërbimi për zonën urbane dhe atë rurale në varësi të ofrimit të shërbimit.

### Faza e Dyte

- Zbatimi i planit te grumbullimit dhe menaxhimit të mbetjeve urbane
- Investime ne infrastrukturën e grumbullimit dhe përpunimit të mbetejeve urbane

## 3. Maturimi i projektit

Ekziston nje studim paraprak i hartuar nga projekti SELEA qe ka bere një analizë të mënaxhimt të mbetjeve në rajonin e Kukësit.

## 4. Burimet e financimit dhe partneret e implementimit

Financuesit e projektit:

- Për t'u identifikuar

*Projekti do te zbatohet nga:*

- Bashkia Kukes
- Këshilli I Qarkut Kukës

## 5. Kostot e projektit ( ne Euro)

| *Nr.* | *Aktivitetet* | *Buxheti per aktivitet* |
|---|---|---|
| *1* | Hartimi i studimit të menaxhimit dhe tarifimit të mbetjeve urbane | 30,000 |
| *2* | Hartimi i studimit të tarifimit të mbetjeve urbane. | 15,000 |
| | | |
| *6* | **TOTALI** | **45,000** |

## 1.2 Projekt – propozime ne Fushen e Mbrojtjes se Ambjentit

| 4. Titulli I projektit | Pastrimi i Liqenit te Fierzes dhe Zones Perreth tij |
|---|---|
| **Lloji I projektit** | Mjedisor- Turistik |
| **Vendododhja e projektit** | Zona Funksionale Kukes |
| **Vlera e Buxhetit ne total** | 150.000 |

1. **Sfondi dhe analizimi I projektit**

